



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

**RAPORTI VJETOR I PUNËS
DHE I PERFORMANCES SË
AKADEMISË SË DREJTËSISË
PËR VITIN 2023**

Prishtinë, 2024

Fjala hyrëse	7
1. Përmbledhje ekzekutive	9
2. Mandati i Akademisë së Drejtësisë.....	10
2.1 Korniza ligjore dhe fuqizimi i Akademisë së Drejtësisë.....	11
2.2 Zhvillimi i bazës ligjore në periudhën raportuese.....	11
2.3 Vështirësitë ligjore që ka hasur Akademia e Drejtësisë në përmbushjen e misionit të saj	12
2.4 Funkcionet dhe kompetencat e Akademisë së Drejtësisë.....	12
3. Organet e Akademisë së Drejtësisë.....	13
3.1 Këshilli Drejtues -Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra.....	13
Aktivitetet e Këshillit Drejtues	14
3.2 Këshilli Programor - Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra	15
Aktivitetet e Këshillit Programor	15
3.3 Organizimi i brendshëm dhe udhëheqja e Akademisë së Drejtësisë.....	16
3.3.1 Drejtori Ekzekutiv – Mandati dhe aktivitetet e ndërmarra.....	17
Aktivitetet e Drejtorit Ekzekutiv.....	17
3.3.2 Departamentet e AD-së.....	18
4. PËRMBUSHJA E PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS SI DHE PROGRAMIT TRAJNUES 2023.....	19
4.1 Sfidat në zbatimin e programeve trajnuese gjatë vitit 2023	20
4.2 Detyrimet e AD-së në mbështetje të mekanizmave integruar për BE	20
4.3. Arritjet në zbatimin e Programit Trajnues 2023	23
4.4 Krahasimi i punës së Akademisë në tri vitet e fundit	25
4.5 Ngritja e cilësisë së trajnimeve dhe avancimi i metodologjisë trajnuese në programet e Akademisë së Drejtësisë	27
5.1 AFTËSIMI I GJYQTARËVE/PROKURORËVE TË SAPO EMËRUAR DHE PËRGATITJA PROFESIONALE PËRSHTATSHMËRISHT ME ROLIN DHE DETYRAT E FUNKSIONIT PËRKATËS (PROGRAMI I TRAJNIMIT FILLESTAR)	28
5.1.1 Të arriturat dhe sfidat sipas objektivave të parapara në Planin e Punës dhe të performancës për vitin 2023 për Programin e Trajnimit Fillestar	29
5.1.2 Aktivitetet trajnuese për gjeneratën e IX (45 gjyqtarë dhe 4 prokurorë) në Trajnimin Fillestar..	30
5.1.3 Aktivitetet trajnuese për gjeneratën e X (29 gjyqtarë dhe 21 prokurorë) në Trajnimin Fillestar ...	33
5.1.4 Vizitë studimore e gjyqtarëve (gjeneratës së VIII në PTF) në Trier dhe Koblenz të Gjermanisë.	
36	
5.1.5 Trajnimi për gjyqtarë porot fillestar.....	36

5.2 AVANCIMI I VAZHUESHËM I NJOHURIVE PROFESIONALE TË GJYQTARËVE, PROKURORËVE, STAFIT ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL SI DHE PROFESIONSTËVE TJERË LIGJOR NË SHKATHTËSITË	37
DHE KOMPETENCAT PROFESIONALE DHE INTERDISIPLINARE (PROGRAMI I TRAJNIMIT TË VAZHUESHËM)	37
5.2.1 Objektivat e Programit për Trajnim të Vazhdueshëm për vitin 2023	37
5.2.2 Arritjet dhe sfidat gjatë zbatimit të trajnimeve të vazhdueshme	37
5.2.3 Bashkëpunimi dhe mbështetja e donatorëve në ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme	40
5.2.4 Aktivitetet sipas fushave	41
5.2.5 Zbatimi i trajnimeve të specializuara në drejtësinë penale	42
5.2.6 Zbatimi i trajnimeve sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve	44
5.2.7 Trajnimet e vazhdueshme nga lëmia penale (materiale dhe procedurale)	45
5.2.8 Trajnimet e vazhdueshme nga lëmia civile (materiale dhe procedurale).....	45
5.2.9 Trajnimet nga fusha Komerciale.....	46
5.2.10 Trajnimet nga E Drejta Kushtetuese	46
5.2.11 Trajnimet nga fusha e kundërvajtjeve	47
5.2.12 Trajnimet për mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhunës ndaj Grave (aspekti penal dhe civil)	47
5.2.13 Trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe BE-së	47
5.2.14 Trajnimet nga fusha e ndërmjetësimit.....	48
5.2.15 Tryezat dhe trajnimet nga Drejtësia për fëmijë – aspekti civil dhe penal	48
5.2.16 Trajnimet dhe tryezat nga fusha Administrative	49
5.2.17 Zbatimi i trajnimeve interdisiplinare për gjyqtarë dhe prokurorë	49
5.2.18 Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes trajnimeve dhe tryezave në fushën penale	49
5.2.19 Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme për Risitë e Kodit të Procedurës Penale dhe sipas vlerësimit të performancës.....	50
5.2.20 Trajnimi i anëtarëve të Komisioneve për vlerësimin e performances së gjyqtarëve dhe prokurorëve	50
5.2.21 Trajnuesit e angazhuar për zbatim të PTV-së gjatë vitit 2023	51
5.2.22 Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorë profesional dhe stafin administrativ	51
gjjyqësor dhe prokurorial	51
Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional.....	51
Trajnimet për stafin tjetër administrativ të gjykatave dhe prokurorive.....	52
5.2.23 Ngritja e kapaciteteve profesionale të profesioneve të lira	53

5.2.24 Avancimi i metodologjisë trajnuese sipas standardeve dhe metodave bashkëkohore-trajnimet për trajnues.....	54
5.2.25. Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë	56
6. RRRITJA E CILËSISË SË PROGRAMEVE TRAJNUESE, KAPACITETEVE ANALITIKE DHE HULUMTUESE SI DHE VEPRIMTARISË BOTUESE -PROGRAMI PËR HULUMTIME DHE PUBLIKIME.....	56
6.1. Analiza e nevojave trajnuese për përcaktimin e kurrikulës trajnuese dhe Planit të Punës dhe të Performancës së AD-së për vitin 2024	57
6.2 Zhvillimi i veprimtarisë botuese	58
6.3 Pasurimi i mëtejshëm i bibliotekës elektronike, analiza e bazës së të dhënave dhe ofrimi i burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së	59
6.4 Përditësimi i statistikave dhe data bazës së të dhëna me aktivitetet e realizuara gjatë vitit në kuadër të programeve trajnuese të AD-së.....	60
7. AVANCIMI DHE ZGJERIMI I BASHKËPUNIMIT DHE KOORDINIMIT ME PARTNERËT VENDOR, PARTNERËT NDËRKOMBËTARË, DONATORËT DHE INSTITUCIONET RELEVANTE TRAJNUESE NDËRKOMBËTARE.....	61
7.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës 61	
7.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë	61
7.3 Zbatimi i trajnimeve me donatorë.....	62
Aktivitetet e realizuara me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-së OPDAT dhe Ambasadën Amerikane.....	62
Aktivitetet e realizuara me Ambasadën Franceze.....	62
Aktivitetet e realizuara me Projektin për Drejtësi Kormeciale të mbështetura nga USAID.....	62
Aktivitetet e realizuara me zyrën e Bashkimit Evropian dhe projektet e saj	62
Aktivitetet e realizuara me zyrën e Këshillit të Evropës dhe projektet e saj.....	63
Aktivitetet e realizuara me Iniciativën e Chemonics për Sundim të Ligjit në Ballkanin Perëndimor (WBROLI), financuar nga Mbretëria e Bashkuar.....	63
Aktivitetet e realizuara me OSBE-në.....	63
Aktivitetet e realizuara me GIZ	64
Aktivitetet e realizuara me UNDP/SAEK.....	64
Aktivitetet e realizuara me UNCHR-Zyra e Misionit në Kosovë	64
Aktivitetet e realizuara me Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë.....	64
Aktivitetet e realizuara me EULEX.....	65
Aktivitetet e realizuara me CEELI Institut	65
Aktivitetet e realizuara me Humanitarian Law Center	65

Aktivitetet e realizuara me CLARD –Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional	65
Programet praktike dhe shkëmbimi i përvojave me vendet ne rajon	65
Programi praktik për kandidatet e Shkollës së Magjistraturës së Francës në institucionet gjyqësore në Kosovë	65
Programi praktik i gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Kosovës në Bon	66
Aktivitetet me Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN)	66
8. TRANSPARENCË DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN	67
9. NGRITJA E CILËSISË SË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE DHE NË FINANCA.....	67
9.1 Shërbimet e përgjithshme.....	67
9.2 Rishikimi i akteve nënligjore	67
9.3 Zhvillimi, menaxhimi dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore	68
9.4 Të punësuarit dhe nevojat për punëtorë të rinj.....	68
9.5 Trajnimet e stafit	69
9.6 Avancimi i teknologjisë informative.....	69
9.7 Prokurimi	70
9.8 Financat.....	71
Mbështetja financiare nga donatorët	75
9.10 Asetet	76
9.10.1 Asetet e Akademisë.....	76
9.10.2 Planifikimi për asete të reja dhe ndërtesën e Akademisë	76
9.11 Auditimi nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.....	77
10. Sfidat dhe rekomandimet	77
11. Tabela me indikatorët dhe performancën e AD-së për vitin 2023	79
Anekset	83

Akronimet

ABEK - Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës

AD – Akademia e Drejtësisë

AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit

ANJF - Agjencioni për Ndhmë Juridike Falas

DAF – Departamenti i Administratës dhe Financave

DHPGJS-Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

EIFL - Electronic Information for Libraries

EJTN – European Judicial Training Network (Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor)

ENM – L'École Nationale de la Magistrature

GIZ - Deutsche Gesellschaft fuer Internationale Zusammenarbeit

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

IGJK – Instituti Gjyqësor i Kosovës

ILIAS – Integriertes Lern – Informations - und Arbeitskooperations-System

KDM – Kodi i Drejtësisë për të Mitur

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

KPMSHCK – Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

KPPK – Kodi i Procedurës Penale i Kosovës

LMD – Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

OPP - Oda e Përmbauesve Privat

PHP – Programi për Hulumtime dhe Publikime

PTF – Programi i Trajnimit Fillestar

PTV – Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm

SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës

SQEPK-Sistemi qendror i evidencës Penale të Kosovës

TI – Teknologjia Informative

USAID - The United States Agency for International Development

UNDP-Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

UNHCR-Zyra e Misionit në Kosovë

ZKA – Zyra e Kombëtare e Auditimit

Fjala hyrëse

Raporti i punës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2023 ofron informacion të përgjithshëm për punën e Akademisë së Drejtësisë dhe aktivitetet e saj në funksion të zhvillimit profesional të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve tjerë ligjor.

Ndër prioritet e AD-së përgjatë vitit 2023 ka qenë edhe zbatimi i Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënese të agjencive të pavarura, respektivisht zbatimin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr. 05/1-095 për Akademinë e Drejtësisë , harmonizimin e rregullimit dhe organizimit të brendshëm të AD-së me Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si dhe Ligjin për zyrtarët publik dhe aktet rregullative të aplikueshme në organizmin , klasifikimin dhe sistematizimin e të punësuarve në AD .

Pjese e rëndësishme e aktiviteteve të AD-së ishte ngritja e cilësisë së metodologjise trajnuese, ku në këtë aspekt është zhvilluar dhe miratuar Doracaku për Trajnues, janë realizuar Trajnime të Trajnuesve, si dhe me sukses është realizuar rekrutimi i trajnuesve të përkohshëm.

Aktivitet trajnuese të AD gjate vitit 2023 jane realizuar konform programeve trajnuese si të zhvilluara dhe miratura nga organet e AD dhe të përmbledhura në kete raport . Andaj raporti në detaje ofron aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimeve fillestare për gjyqtarë dhe prokurorë të sapo emëruar, përkatësisht aktivitetet në funksion të aftësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj përshtatshmërisht me funksionet përkatëse si dhe aktivitetet tjera trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë në detyrë, duke përfshirë edhe profesionistë tjerë ligjor në funksion të avancimit të kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare.

Në kuadrin e trajnimeve fillestare është vazhduar zbatimi i trajnimit fillestar për 45 gjyqtarët dhe 5 prokurorët e sapo emëruar, gjenerata e IX të cilët trajnimin e kanë filluar në muajin korrik 2022. Përveç kësaj gjenerate, nga muaji prill i vitit 2023 ka filluar trajnimi fillestar edhe për gjeneratën e X të gjyqtarëve dhe prokurorëve (29 gjyqtarë dhe 21 prokurorë) meqë të dy këshillat kanë rekrutuar grupe të reja të gjyqtarëve dhe prokurorëve pa përfunduar gjenerata paraprake trajnimin fillestarë.

Në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme janë realizuar trajnime dedikuar departamenteve të gjykatave dhe prokurorive përshtatshmërisht me nevojat trajnuese. Janë realizuar tryeza për unifikim të praktikës gjyqësore në fushën penale, civile dhe administrative, programet e specializuara për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, trajnimet për të drejtat e njeriut, trajnimet për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave, drejtësinë për fëmijë, trajnimet në fushën e ndërmjetësisimit, krimit kibernetik në të cilat kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë si dhe profesionistë tjerë ligjor. Përveq kësaj janë realizuar edhe aktivitete shitesë si rezultat i kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve për risitë ligjore të Kodit të Procedurës penale.

E veçantë e këtij viti ishin trajnimet bazike për 87 gjyqtarët porotë si rezultat i emërimit të tyre në këtë pozitë dhe përgatitja e tyre për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit porotë.

Edhe këtë vit është vazhduar me trajnimet dedikuar bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor nga modulet e trajnimit bazik në fushë penale dhe civile-aspekti material dhe procedural, ndërkaq për stafin tjetër administrativ të gjykatave dhe prokurorive janë realizuar aktivitete trajnuese të cilat kanë qenë përshtatshmërisht me funksionin dhe detyrat e punës.

Janë realizuar edhe aktivitetet trajnuese për profesionistët tjerë ligjor, veçanërisht për ndërmjetësuesit, ndërkaq përmbaruesit, mbrojtësit e viktimave, zyrtarët e ndihmës juridike falas dhe profesionistë tjerë ligjor, pa përjashtuar edhe bashkëpunëtorët profesional kanë përfituar edhe nga trajnimet e përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë.

Në kuadrin e hulumtimeve dhe publikimeve janë realizuar aktivitete në dobi të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe hartimit të programeve trajnuese si dhe aktivitete tjera në fushën e publikimeve.

Në raport në detaje janë aktivitetet të cilat janë realizuar me buxhetin e AD-së dhe një pjesë e konsiderueshme me mbështetjen financiare të donatorëve, miqve dhe bashkëpunëtorëve të AD-së.

Në vazhdim raporti vjetor i punës përmban edhe të dhëna për shpenzimet buxhetore dhe aktivitetet e prokurimit në kuadër të Departamentit për Administratë dhe Financa.

Në fund shfrytëzoj rastin të falënderoj të gjithë duke filluar nga Keshilli Drejtues, Keshilli Programor, trajnuesit, stafin, miqtë dhe bashkëpunëtorët e Akademisë për përkushtimin dhe angazhimin maksimal në zbatimin e gjithë këtyre aktiviteteve që janë në funksion të rritjes së kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Sinqerisht,
Vaton Durguti
Kryetar i Këshillit Drejtues

1. Përmbledhje ekzekutive

Akademia e Drejtësisë është angazhuar në rritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial duke përfshirë edhe disa nga profesionet e lira. Këtë e ka realizuar përmes hartimit dhe zbatimit të programeve trajnuese përshtatshëmrisht me nevojat trajnuese, prioritetive dhe koordinimit maksimal të KGJK-së dhe KPK-së, si dhe zbatimit të masave sipas Strategjisë për sundimin e ligjit dhe strategjitë tjera me impakt në punën e gjyqësorit. Gjithashtu edhe përmes krijimit dhe zhvillimit të burimeve të reja juridike, përkatësisht përmbledhjeve të praktikës gjyqësore dhe formave tjera të publikimeve si udhërrëfyes në bërjen e drejtësisë më të mirë dhe njëkohësisht si mjete shtesë për zhvillimin profesional të tyre.

Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së IX dhe X ka përfshirë 6 module trajnuese në kuadër të cilave janë trajtuar gjitha kompetencat e punës së gjyqtarit në departamentin e përgjithshëm duke përfshirë aspektin material dhe procedural si dhe legjislacionin sa i përket të drejtave të njeriut dhe BE-së dhe shkathtësisht plotësuese. Për prokurorët e gjeneratës së IX dhe X, programi ka përfshirë 5 module trajnuese në kuadër të cilave janë trajtuar gjitha kompetencat e punës së prokurorit në departamentin e përgjithshëm, legjislacionin sa i përket të drejtave të njeriut dhe BE-së si dhe shkathtësitë tjera plotësuese. Trajnimi fillestarë për gjyqtarë me kërkesën e KGJK-së është zbatuar intenzivisht 5 ditë të javës me sesionet e trajnimit teorik dhe më pas me sesionet e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse të emërimit. Ndryshe nga gjyqtarët, trajnimi fillestar për prokuror është zbatuar paralelisht sesionet e trajnimit teorik 2 ditë në javë ndërkaq 3 ditë tjera të javës me sesionet e trajnimit praktik në prokuroritë përkatëse të emërimit.

Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm ka përfshirë juridiksionin e të gjitha departamenteve të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve me fokus te çështjet ligjore që janë më të ndjeshme si: dhuna në familje, aspekti i të drejtave të njeriut, krimi i organizuar dhe korrupsionin si dhe veprat tjera të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, pasi është vazhduar edhe më tej përfshirja e tyre në program nga proceset integruese dhe dokumentet strategjike. Po ashtu një vend të rëndësishëm kanë pasur edhe trajnimet për risitë e Kodit të Procedurës Penale, tryezat për unifikimin e praktikës gjyqësore në fushën penale, civile administrative të cilat janë konsideruar më efektive për shkak të paneleve në përbërje të gjyqtarëve të instancave më të larta dhe dakordimit për zgjidhjet ligjore të çështjeve që ishin sfiduese të praktikës gjyqësore. Në trajnimet e vazhdueshme kanë marrë pjesë gjyqtarë prokuror dhe sipas tematikës edhe profesionistë tjerë ligjor si zyrtarë policor, zyrtarë doganor, nga njësia e inteligjencës financiare, avokatë etj.

Në periudhën raportuese janë zbatuar edhe trajnimet për grupet e radhës së bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të cilit nuk janë përfshirë në vitin paraprak. Bashkëpunëtorët profesional poashtu kanë vijuar trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë. Gjatë periudhës raportuese AD ka organizuar trajnime edhe për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive duke iu dedikuar profileve të caktuara si administratorëve, ndihmës administratorëve, shefave të zyrës për menaxhimin e lëndëve, intepretëve gjyqësor etj. Raporti përfshinë edhe aktivitetet tjera dedikuar profesionistëve tjerë duke përfshirë përmblyesit privat, zyrtarëve të ANJF, avokatet shtetëror, mbrojtësve të viktimave etj.

Për zbatimin e trajnimeve janë angazhuar trajnues nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor me përvojë dhe gjithashtu edhe ekspert ndërkombëtarë të cilët kanë

ofruar praktikat më të mira gjyqësore në çështjet penale, civile, administrative, drejtësia për fëmijë etj. Raporti në detaje ofron trajnimet që janë realizuar për secilën kategori duke përfshirë edhe numrin e pjesëmarrëve, përkatësisht të trajnuave.

Ne raport janë paraqitur edhe aktivitetet për rritjen e kapaciteteve të trajnuesve për fushën e korrupsionit publik, arsyetimit të vendimeve gjyqësore, krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe për metodologjinë e Platformës HELP.

Burimet ligjore kanë vazhduar të jenë në shërbim të përfituesve të AD-së, veçanërisht formatet elektronike dhe burime ligjore ndërkombëtare përmes ABEK.

Akademia përmes përfaqësuesve të saj ka marrë pjesë në konferenca e takime regjionale e ndërkombëtare, ndërkaq gjyqtarëve dhe përfituesve tjerë sipas ligjit i'u ka mundësuar pjesëmarrjen në trajnime në institucione të ndryshme të trajnimit gjyqësor në nivel rajonal dhe ndërkombëtar të cilat për qëllim kishin zhvillimin profesional të tyre.

Si çdo vit edhe gjatë vitit 2023 nuk ka munguar mbështetja nga donatorë dhe partnerë tjerë të cilët kanë asistuar në vlerësimin e nevojave trajnuese, në hartimin e programeve dhe zbatimin e tyre. Përmes ekspertizës së tyre ndërkombëtare kanë promovuar praktikat më të mira në trajtimin e çështjeve të ndryshme ligjore si nga ana e gjykatës ashtu edhe nga ana e prokurorisë.

Raporti përmbanë edhe aktivitetet në menaxhimin dhe ekzekutimin adekuat të buxhetit të Akademisë së Drejtësisë për zbatimin e drejtë të veprimtarisë së saj me ligj dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në drejtim të zhvillimit dhe aftësimin profesional të gjyqtarëve, prokurorëve dhe komunitetit tjetër ligjor që janë përfitues sipas ligjit të AD-së.

2. Mandati i Akademisë së Drejtësisë

Akademia e Drejtësisë është institucion publik, i pavarur cili është në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe sipas kërkesave dhe mundësive edhe për profesionet e lira. Akademia e Drejtësisë këtë funksion e realizon përmes zhvillimit dhe zbatimit të programeve trajnuese dhe burimeve ligjore në përputhje me nevojat adekuate për trajnime të cilat identifikohen nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese. Akademia e Drejtësisë kryen edhe analiza, hulumtime si dhe kryen veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të lira.

- **Misioni**

Të ofrojë trajnim cilësor gjyqësor për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet më të mira të njohura ndërkombëtarisht.

- **Vizioni**

Të shërbejë si institucion modern i të mësuarit, i përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, kontribues kryesor për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që gëzon besimin e publikut.

2.1 Korniza ligjore dhe fuqizimi i Akademisë së Drejtësisë

Akademia e Drejtësisë veprimtarinë e saj e ushtron duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-095 për ADNë, si dhe Ligjit nr. 08/L-063, kapitulli IV për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe aktet nënligjore të cilat deri në nëntor 2023 kanë në fuqi si në vijim:

- Rregullore Nr. 01/2017, për Procedurën e Emërimit dhe Shkarkimit të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 02/2017, për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 03/2017, për Trajnimin Fillestar;
- Rregullore Nr. 04/2017, për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 05/2017, për Tarifat e Trajnimeve për Avokat Shtetëror, Avokatë dhe Profesionet e Tjera të Lira;
- Rregullore Nr. 06/2017, për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr. 08/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
- Rregullorja Nr.01/2018, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë.
- Rregullorja Nr. 02/2019 - për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë
- Rregullorja Nr. 01/2019 - për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Akademinë e Drejtësisë;
- Rregullore Nr. 01/2020, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar.

2.2 Zhvillimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Zbatimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, respektivisht zbatimin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, ka konsistuar në harmonizimin e rregullimit dhe organizimit të brendshëm të AD-së me Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si dhe Ligjin për zyrtarët publik dhe aktet normative të aplikueshme në organizimin, klasifikimin dhe sistematizimin e të punësuarve në AD. Në këtë kuadër AD ka ndërmarr të gjitha veprimet në harmonizimin dhe zhvillimin e akteve normative si të kërkuara nga legjislacioni i ri në fuqi për reformën e administratës publike. Si rrjedhojë AD ka rishikuar aktet nënligjore në fuqi dhe janë zhvilluar dhe nxjerrë aktet e tjera në harmoni me legjislacionin si të elaboruar më lart , dhe në përputhje me këtë AD ka nxjerrë aktet e reja nënligjore dhe ka plotësuar dhe ndryshuar aktet si në vijim:

- Rregullorja Nr. 05/2023 - Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë
- Rregullorja Nr. 04/2023 - Për Pranimin dhe Emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë
- Rregullorja Nr. 03/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë

- Rregullorja Nr. 02/2023 - për Plotësim dhe Ndryshmin e Rregullores Nr 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë
- Rregullorja Nr. 01/2023 - për Plotësim dhe Ndryshmin e Rregullores Nr 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.

2.3 Vështirësitë ligjore që ka hasur Akademia e Drejtësisë në përmbushjen e misionit të saj

Edhe në periudhën raportuese vazhdojnë vështirësitë e theksuara në përmbushjen e Programit të Trajnimit Fillestar veçanërisht për gjyqtarët e sapo emëruar konform Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë. Neni 19 i këtij ligji përfshirë edhe neni 31 i Ligjit nr. 06/L - 054 për Gjykatat, që i dedikohen trajnimit fillestar përcaktojnë si të obligueshme trajnimet fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar me kohëzgjatje 12 muaj që përfshinë pjesën teorike dhe praktike. Për kundër kësaj, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke vlerësuar ngarkesën me lëndë nëpër gjykata ka vendosur që edhe gjyqtarët e sapo emëruar të vendosin një sasi të konsiderueshme të lëndëve të lehta dhe jo komplekse.

Ende vazhdon të mebetet në pritje zbatimi i koncept dokumentin të Ministrisë së Drejtësisë për Ligjin për Akademinë e Drejtësisë i cili tashmë është miratuar nga qeveria në të cilin janë ofruar çështjet ligjore që duhet të adresohen dhe të përfshihen në Ligjin e ri. Gjate vitit 2023 si rezultat i letrës së zotimeve ndërmjet KGJK , KPK dhe MD është themeluar grupi punues për rishikimin e pakos së ligjeve për gjyqësorin ku janë të përfaqësuar të gjitha institucionet relevante si KGJK, KPK, MD, Shoqeria Civile si dhe ekspertet ndërkombetare nga EUKOJUST dhe OPDAT dhe ne kete grup eshte ftuar edhe AD sa i perket fushes se trajnimeve

Kujtojmë se bazuar në Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, Akademia është institucion publik që për punën e saj i raporton Këshillit Drejtues të AD-së. Përderisa me këtë ligj vazhdon të ketë statusin e institucionit publik dhe të pavarur, pritjet e Akademisë së Drejtësisë janë të adresohen edhe pengesat ligjore që ka pasur dhe në plotni të ushtrij veprimtarinë e saj.

2.4 Funkcionet dhe kompetencat e Akademisë së Drejtësisë


Bazuar në kompetencat që përcakton ligji, Akademia e Drejtësisë kryen funksionet e parapara si në vijim:

- a. harton programet e trajnimit dhe organizon trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- b. zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime përmes mekanizmave të përcaktuara nga Akademia, dhe në bazë të kërkesave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tej: KGJK), Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej: KPK).
- c. organizon trajnime për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, pas koordinimit paraprak të nevojave për trajnime me KGJK-në dhe KPK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- d. mund të organizojë trajnime të vazhdueshme profesionale për avokat shtetëror, avokat, noter, përmbarues privat, ndërmjetësues, administratorët falimentues, si dhe profesione tjera në bazë të vlerësimeve të Akademisë, sipas kërkesave të institucioneve kompetente;

- e. zhvillon dhe realizon programet e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në, Odat e profesioneve të lira apo institucionet përkatëse;
- f. mbanë të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në Akademi në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- g. vendosë dhe mbanë bashkëpunim me institucionet vendore dhe institucionet e huaja të ngjashme lidhur me punët të cilat i kryen, duke përfshirë praktikat profesionale dhe programet e shkëmbimit;
- h. kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore;
- i. kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira;
- j. kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

3. Organet e Akademisë së Drejtësisë

Kompetencat dhe funksionin e saj AD i kryen përmes organeve kryesore të saj si Këshilli Drejtues, Këshilli Programor dhe Drejtori Ekzekutiv.



Grafikoni nr. 1: Strukturimi i AD-së me organet dhe stafin gjatë vitit 2023

3.1 Këshilli Drejtues -Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra

Këshilli Drejtues i Akademisë përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy (2) janë anëtarë ex officio, ndërsa shtatë (7) anëtarë nga institucionet e mëposhtme:

Anëtarë ex officio janë Kryetari i Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurori i Shtetit. Anëtarët tjerë janë:

- a. 3 (tre) anëtar të emëruar nga KGJK dhe atë, një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore, një (1) nga Gjykata e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KGJK-së;

- b. 3 (tre) anëtar të emëruar nga KPK dhe atë, një (1) prokuror nga Prokuroria Themelore, një (1) nga Prokuroria e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KPK-së;
- c. 1 (një) anëtarë i emëruar nga Ministria e Drejtësisë;

Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen në kohëzgjatje prej katër (4) vite, pa mundësi rizgjedhje edhe për një mandat.

Sipas ligjit, Këshilli Drejtues i Akademisë ka kompetencë për:

- a. Miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj;
- b. Miratimin e projektbuxhetit të Akademisë;
- c. Miratimin e strategjisë zhvillimore, planit të punës së Akademisë dhe programit të trajnimeve;
- d. Miratimin e listës së trajnerëve dhe mentorëve;
- e. Mbikëqyrjen e punës së Akademisë;
- f. Përcaktimin e prioriteteve në ofrimin e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- g. Zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv;
- h. Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Programor;
- i. Kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore;

Aktivitetet e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues gjatë vitit 2023 ka mbajtur tetë (8) takime në kuadër të cilave ka nxjerrë një numër të konsiderueshëm të vendimeve të cilat kanë avancuar edhe më tej punën e AD-së. Ka shqyrtuar dhe ka aprovuar programet trajnuese, raportet dhe planin e punës së AD-së, listën e re të trajnuesve të perkoheshem, aktet nënligjore dhe çështje të ndryshme që janë pjesë e punës dhe aktiviteteve të AD-së.

Për më hollësisht në vijim janë çështjet më kryesore për të cilat ka vendosur gjatë vitit:

1. Mentorët për gjyqtarë me mandat fillestar të cilët do të ushtrojnë funksionin e tyre në Gjykatën Komercilae dhe Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës, në pjesën praktike;
2. Programin Trajnues për prokurorët e sapoemëruar – gjenerata e X;
3. Programin Trajnues për gjyqtarët e sapoemëruar – gjenerata e X;
4. Për dorëheqjen e njërit nga anëtarët e KP
5. Protokolin për trajnime të detyrueshme për prokurorët me performancë të dobët;
6. Raportin Vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2022;
7. Fillimin e Programit Fillestar për 21 prokurorët me mandat fillestar dhe mentorët që do të angazhohen për të mentoruar prokurorët e sapo emëruar;
8. Fillimin e Programit Fillestar për 29 gjyqtarë me mandat fillestar dhe mentorët që do të angazhohen për të mentoruar gjyqtarët e sapo emëruar;
9. Për Kërkesën buxhetore 2024-2026 e Akademisë së Drejtësisë
10. Për Rregulloren nr. 01/2023 për Plotësimin e rregullores nr. 02/2019 për trajnuesit dhe mentorët e AD-së;

11. Për Rregulloren nr. 03/2023 për Plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 04/2017 për punën e Këshillit Programor të AD-së
12. Për Rregulloren nr. 04/2023 për Pranimin dhe Emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të AD-së
13. Për Rregulloren nr. 01/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e rregullores nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar;
14. Për listën e trajnuesve të përkohshëm sipas Shpalljes Publike të datës 27.11.2023 për zgjedhjen e trajnuesve të përkohshëm në Akademinë e Drejtësisë
15. Programin Trajnues për vitin 2024;
16. Miratimin e Planit të Punës dhe Performancës për vitin 2024;
17. Planin e Integritetit të AD-së për vitin 2024-2026

3.2 Këshilli Programor - Përbërja, kompetencat dhe aktivitetet e ndërmarra

Këshilli Programor është organ ndihmës profesional i cili angazhohet për hartimin e Programit të Trajnimeve dhe për të siguruar cilësi për trajnimet e ofruara nga Akademia e Drejtësisë. Funkcionet kryesore të Këshillit Programor janë:

- Hartimi i propozim programit të trajnimeve të Akademisë në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- Përcjellja e realizimit të programeve dhe sukseseve të tyre;
- Të jap orientime për avancimin e metodave dhe teknikave trajnuese, pavarësisht dhe në bashkëpunim me trajnuesit dhe mentorët;
- Të jap mendim për listën e trajnuesve dhe mentorëve;
- Të jap këshilla propozime dhe sygjerrime, organeve të Akademisë për përmirësimin e kualitetit të trajnimeve;
- Kryejnë edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe akte nënligjore të Akademisë.

Këshilli Programor sipas ligjit përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, të cilët i emëron Këshilli Drejtues, nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe ekspertëve tjerë. Mandati i anëtarëve të Këshillit Programor, me përjashtim të Drejtorit Ekzekutiv, është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Kryesuesi i Këshillit Programor është ex officio Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.

Në periudhën raportuese një nga anëtarët e Këshillit Programor ka dhënë dorëheqje. Akademia e Drejtësisë ka qenë e angazhuar në rishikimin e Rregullores nr. 04/2017 të punës së Këshillit Programor si parakusht për të vazhduar në vijim procesin e konkursit që do të kontribuonte në plotësimin e përbërjes aktuale. Për të përmbushur kompetencat dhe detyrat e punës së këtij organi, dhe për më tepër fushat të cilat ky organ nuk i ka mbulluar ka angazhuar trajnues nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve veçanërisht për hartimin e programeve trajnuese.

Aktivitetet e Këshillit Programor

Këshilli Programor gjatë vitit 2023 ka mbajtur tri (3) takime, përkatësisht në datat 13-14 nëntor, si dhe 1 dhe 21 dhjetor 2023. Në këto takime është angazhuar intenzivisht në përcaktimin e kurriklës trajnuese të AD-së qoftë të PTF-së ashtu edhe PTV-së duke pas në konsideratë gjetjet nga procesi

i vlerësimit të nevojave trajnuese dhe kërkesat nga dokumentet strategjike të vendit. Në koordinim me kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive, përfshirë edhe grupin e trajnuesve të përcaktuar nga Këshilli Drejtues ka ushtruar me sukses funksionin e tij në hartimin e Programit trajnues për vitin 2024. Po ashtu Këshilli Programor ka dhënë rekomandime edhe për listën e trajnuesve të cilët e kanë kaluar procesin e rekrutimit sipas konkursit të hapur dhe publik nga Akademia e Drejtësisë.

3.3 Organizimi i brendshëm dhe udhëheqja e Akademisë së Drejtësisë

Në kuadrin e Akademisë së Drejtësisë janë të punësuar 25 zyrtarë duke përfshirë edhe Drejtorin Ekzekutiv ndërkaq janë të lejuara gjithësejt 32 pozita. Në periudhën raportuese nuk është zhvilluar asnjë procedurë e rekrutimit për pozitat e lira për shkak të ndryshimeve legjislative përkatësisht Ligji për zyrtarët publik por edhe nismat për ndryshimin e Ligjit për AD-në.

Organizimi i brendshëm deri në fund¹ vit ka qenë i rregulluar me Rregulloren Nr.01/2018, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë, ku sipas kësaj rregulloreje, Akademia e Drejtësisë është e ndarë në katër departamente dhe zyrën e programeve trajnuese.

Bazuar në aktin për organizimin e brendshëm² që ka qenë në zbatim, Akademia e Drejtësisë ka funksionuar dhe është e organizuar me këtë strukturë:

- Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;
- Departamenti për Trajnim Fillestar,
- Departamenti për Trajnim të Vazhdueshëm,
- Departamenti për Hulumtime dhe Publikime si dhe
- Departamenti për Administratë dhe Financa

Gjate vitit 2023 është iniciuar harmonizimi dhe rregullimi i organizimit të brendshëm të AD me Ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si dhe Ligjin për zyrtarët publik dhe aktet normative të aplikueshme në organizimin, klasifikimin dhe sistematizimin e të punësuarve në AD. Në fundvit të vitit 2023 respektivisht pas miratimit të rregullores së re mbi organizimin e mbrendshëm të AD-së dhe me miratim të Këshillit Drejtues të AD-së, organizimi dhe sistematizimi i mbrendshëm ka identifikur si të nevojshme 36 pozita, ku 4 pozita janë identifikuar shtese nga 32 sa janë të miratuar me ligjin për buxhetin. Organizimi i mbrendshëm sipas rregullores se re është strukturuar në 2 Departamente dhe 8 divizione me gjithësejt 36 pozita.

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv
2. Departamentin e Trajnimeve – duke përfshi 4 divizione
3. Departamentin për Ceshtje ligjore dhe shërbime të përgjithëshme- duke përfshi 3 Divizione
4. Divizionin për Buxhet dhe Financa

¹ Me 3 nëntor 2023 është miratuar Rregullorja nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë.

² Rregullorja nr. 01/2018 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Akademi të Drejtësisë.

3.3.1 Drejtori Ekzekutiv – Mandati dhe aktivitetet e ndërmarra

Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë, Drejtori Ekzekutiv bën pjesë në kategorinë e Zyrtarëve të Lartë Drejtues. Gjatë vitit 2023 është fokusuar në realizimin e aktiviteteve si në vijim:

- a. Përfaqësimin e Akademisë para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare;
- b. Menaxhimin, administrimin e përgjithshëm dhe ligjshmërinë e punës së Akademisë;
- c. Zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;
- d. Propozimin e projektbudgetit vjetor të Akademisë;
- e. Propozimin e Planit të Punës dhe Performancës për vitin 2024 dhe Programin e Trajnimeve për vitin 2024;
- f. Propozimin e listës së trajnuesve për miratim nga Këshilli Drejtues;
- g. Menaxhimin me mjetet financiare dhe pronën e Akademisë;
- h. Përgatitjen e raporteve të rregullta vjetore dhe raporteve tjera sipas kërkesave të Këshillit Drejtues.

Aktivitetet e Drejtorit Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë është angazhuar në funksionimin më të mirë të punës së AD-së përmes, përfaqësimit të rregullte, menaxhimit dhe administrimit të përgjithshëm, përfshirë edhe ligjshmërinë e punës së AD-së. Aktivitetet e Drejtorit Ekzekutiv në masë të madhe janë fokusuar në zbatimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, respektivisht zbatimin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr. 05/1-095 për Akademinë e Drejtësisë. Gjithashtu plotësim ndryshimi i ligjit të AD-së ka krijuar mundësinë e zbatimit të Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si dhe Ligjin për zyrtarët publik dhe aktet normative të aplikueshme në organizmin, klasifikimin dhe sistematizimin e të punësuarve në AD. Andaj në përputhje me kornizën ligjore të aplikueshme, zyra drejtorit ka organizuar dhe udhëhequr draftimin e akteve normative si të listura më poshtë, dhe të njëjtat i ka prezantuar Këshillit Drejtues për Miratim.

- Draft Rregullorja Nr. 05/2023 - Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë
- Draft Rregullorja Nr. 04/2023 - Për Pranimin dhe Emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë
- Draft Rregullorja Nr. 03/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë
- Draft Rregullorja Nr. 02/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë
- Draft Rregullorja Nr. 01/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.

Gjithashtu, bazuar në kalendarin e aktiviteteve të zyrës së drejtorit janë realizuar aktivitete të ndryshme në funksion të avancimit të programeve trajnuese, koordinimit dhe bashkëpunimit me sistemin gjyqësor dhe prokurorial dhe me institucione tjera të sistemit të drejtësisë. Pjesë e aktiviteteve të drejtorit ishin edhe takimet me miqtë dhe partnerët strategjik të AD-së qoftë vendor ashtu edhe ndërkombëtarë. Pjesë e konsiderueshme e angazhimit janë edhe takimet për raportim

para komisioneve të ndryshme të kuvendit për punën e AD-së. Ka marrë pjesë në punëtori dhe konferenca të ndryshme në nivel rajonal dhe ndërkombëtarë. Është angazhuar në punën e përbashkët me Këshillin Programor si dhe është kujdesur për zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues dhe në planifikimin vjetor qoftë për programet trajnuese ashtu edhe për buxhetin dhe menaxhimin me mjetet financiare.

Në periudhën raportuese ka arritur Marreveshje të Bashkëpunimit me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, Odën e Ndërmjetësuesve, me Institutin CEELI, o.p.s., Pragë dhe Shollën e Magjistraturës Italiane. Në kuadrin e aktiviteteve të Drejtorit ishin edhe takimet kordinuese me përfaqësues të shumicës së Ambasadave në Kosovë, Zyrës së BE-së në Kosovë, Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë, si dhe me projektet e shumta që mbështesin Akademinë e Drejtësisë në ofrimin e trajnimeve. Në këtë kuadër janë zhvilluar takimet e rregullta me zyrën e OPDAT pranë Ambasadës së SHBA-së në Kosovë, me projektet e USAID-it sikurse Projekti për Drejtësi Komerciale dhe Projekti për Drejtësinë në Kosovë, me Ambasadën Britanike, respektivisht me projektin “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosove”, me përfaqësues të projektit të BE / EUKOJUST, me projektet e KE “JUFREX “ projektin “ Parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave” me projektin “Programi Evropian për Arsimimin e Profesionistëve Ligjor për të drejtat e Njeriut (HELP)”, projektet e tjera të mbështetura nga OSBE, UNDP, GIZ, IRZ, me organizatat joqeveritare të ashtëquajturat Miqtë e AD-së, me odat e profesioneve të lira në Kosovë dhe partnerë tjerë. Në këto takime janë diskutuar nevojat dhe sfidat e AD-së në përmbushjen e mandatit ligjor, mundësitë e mbështetjes së projekteve, aktivitetet e realizuara dhe aktivitetet në proces si dhe çështje tjera të përbashkëta.

3.3.2 Departamentet e AD-së

Bazuar në Rregulloren Nr.01/2018, për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë kanë funksionuar Departamenti i PTV-së, PTF-së, PHP-së si dhe Departamenti për Administratë dhe Financa. Përgjegjësitë kryesore të departamenteve janë si në vijim:

- Hartimi i programeve trajnuese, mbikëqyrja e zbatimit dhe vlerësimi i i nevojave trajnuese;
- Koordinimi i hartimit të politikave, strategjive, objektivave dhe planeve për trajnime;
- Koordinimi i punës së departamenteve në funksion të zbatimit të trajnimeve.

Secili departament i programit udhëhiqet nga një udhëheqës të cilët po ashtu bëjnë pjesë në kategorinë e nivelit drejtues. Në kuadër të secilit program ka edhe nënkategori tjera të aktiviteteve të cilat janë në përshtatshmëri me funksionet themelore të secilit nga këto programe.

Departamenti për Administratë dhe Financave udhëhiqet nga Drejtori për Administratë dhe Financa, i cili po ashtu është nivel drejtues dhe përfshinë sektorë të cilët janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të përgjithshme si: financiare, të prokurimit, teknologjisë informative, personelit dhe logjistikës, në funksion të realizimit të objektivave programore të Akademisë.

4. PËRMBUSHJA E PLANIT TË PUNËS DHE TË PERFORMANCËS SI DHE PROGRAMIT TRAJNUES 2023

Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2023 është përmbushur në tërësi për këtë vit për të gjitha programet. Komponentet kryesore të Planit të Punës dhe të performancës ishin:

- Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar - PTF;
- Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve të tjerë ligjor;
- Zhvillimi i programeve trajnuese përmes analizave, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese;
- Avancimi i metodologjisë trajnuese;
- Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendor, partnerët ndërkombëtarë, donatorët dhe institucionet relevante trajnuese ndërkombëtare;
- Transparenca dhe marrëdhënia me publikun;
- Rishikimi i akteve nënligjore dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve administrative dhe financa.

Programi Trajnues 2023, ka ofruar trajnimet nga fushat kryesore duke përfshirë aspektin material dhe procedural të punës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Pra, Programi trajnues ka ofruar këtë përmbajtje:

- Trajnimet nga lëmia penale
- Programet e specializuara;
- Trajnimet nga lëmia civile;
- Trajnimet nga lëmia e drejtësisë për fëmijë, aspekti civil dhe penal;
- Trajnimet nga lëmia ekonomike;
- Trajnimet nga lëmia administrative;
- Fusha e kundërvajtjeve;
- Trajnimet për DHPGJS
- Trajnimet nga drejtësia kushtetuese;
- Trajnimet për KEDNJ, të Drejtën e BE-së dhe e drejta ndërkombëtare;
- Kompetenca interdisciplinare;
- Trajnimet kundërdiskriminimit;
- Programi i Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e IX dhe X;
- Programi i Trajnimit Fillestar për prokurorët e sapo emëruar, gjenerata e IX dhe X;
- Programi për Hulumtime dhe Publikime;
- Trajnimi i stafit administrativ të gjykatave dhe prokurorive;
- Trajnimet për profesionet e lira
- Trajnimet e Trajnuesve;
- Trajnimet nga distanca;
- Trajnimet me donatorë.

4.1 Sfidat në zbatimin e programeve trajnuese gjatë vitit 2023

Në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara sipas programeve trajnuese ka pasur vështirësi të theksuara në radhë të parë për shkak të buxhetit jo të mjaftueshëm. Kjo ka bërë që mjetet buxhetore të orientohen në trajnimin fillestar që është obligativ sipas ligjit ndërkaq trajnimet e vazhdueshme një pjesë e konsiderueshme mandatore sipas kërkesave nga dokumentet strategjike të gjinden alternativa tjera siq është me donatorë. Në kuadrin e trajnimeve janë zbatuar trajnime për dy gjeneratat të gjyqtarëve dhe prokurorëve pothuajse paralelisht. Kjo për shkak se KGJK dhe KPK ende pa përfunduar gjenerata e IX-të trajnimin fillestar ka realizuar procesin e ri të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj që shënojnë gjeneratën e X për AD-në. Krahas këtyre vështirësive, Akademia e Drejtësisë për herë të parë është përballë edhe me zbatimin e trajnimit të detyrueshëm pas kërkesës së KPK-së për një nga prokurorët si rezultat i vlerësimit të performancës. Për këtë lloj trajnimi është zbatuar protokollin i përbashkët për trajnime të detyrueshme me KPK-në duke zbatuar me përpikëri programin, testin dhe proceset tjera që kërkon ky protokoll. Gjithashtu ka pasur mungesë të ekspertizës, vështirësi në koordinimin e programeve dhe trajnuesve për zbatimin e trajnimeve.

Përveq sfidave të lartpërmendura AD është përballë edhe me sfidat si në vijim:

- Buxheti jo i mjaftueshëm për inventarin dhe funksionalizmin e plote te objektit të ri të AD-së;
- Stafi i pamjaftueshëm për zbatimin e aktiviteteve hulumtuese dhe kërkimore, komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun;
- Kërkesat e shumta të projekteve me donatorë për trajnime ad-hoc që nuk janë të planifikuara në Programin Trajnues;
- Sigurimi i pjesëmarrësve në trajnimet ad-hoc;
- Ndërtimi i sistemit të monitorimit të trajnimeve dhe efektit të tyre në punë;
- Mungesa e stafit profesional të nevojshëm dhe të domsdoshëm;
- Hapsira të mjaftueshme për trajnime por jo të kompletuara me pajisjet e domosdoshme.

Pavarësisht sfidave të lartpërmendura, Akademia e Drejtësisë është angazhuar për ti adresuar dhe tejkaluar ato duke përmbytur me sukses aktivitetet e përcaktuara me planin e punës dhe jo vetëm por edhe aktivitete tjera të cilat kanë hyrë në program si rezultat i kërkesave nga partnerët ndërkombëtarë.


Për vitin 2024, aktivitetet e Akademisë që do të realizohen janë të përcaktuara në Programin Trajnues 2024 si dhe në Planin e Punës dhe të performancës për vitin 2024. Këto aktivitete synojnë aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj si dhe avancimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë duke përfshirë edhe profesionistët e tjerë ligjor përmes moduleve trajnuese dhe trajtimit të praktikës gjyqësore në të gjitha lëmitë me fokus në çështjet më sfiduese të praktikës gjyqësore.

4.2 Detyrimet e AD-së në mbështetje të mekanizmave integruar për BE

Akademia e Drejtësisë në periudhën raportuese ka qenë e angazhuar në zbatimin e masave dhe kërkesave nga dokumentet strategjike me theks nga Strategjia për sundimin e Ligjit, Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje, Programi Kombëtar për të Drejtat e njeriut dhe dokumente tjera


strategjike për sistemin gjyqësor dhe prokurorial të cilat janë si rrjedhojë e MSA-së dhe raportit të BE-së për Kosovën. Kërkesat nga këto mekanizma dhe jo vetëm, kanë ndikuar në volumin e trajnimeve dhe aktiviteteve tjera të AD-së të cilat në masë të madhe janë realizuar me donatorët për shkak të buxhetit shumë të vogël të Akademisë së Drejtësisë.

Strategjia për sundimin e ligjit parashehë katërdhjetë e dy (42) masa për AD-në. Një pjesë e konsiderueshme aktivitete trajnuese në fusha specifike si drejtësinë komerciale, korrupsionin, konfiskimin e pasurisë, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, mbi 10 kurrikula trajnuese të hartuara dhe të miratuara për kategori të ndryshme për Komisionin për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, për Kryetarët e Gjykatave dhe Kryeprokurorët e Prokurorive, për Stafin mbështetës të Gjykatave dhe Prokurorive, Kurrikula të përbashkëta me profesione të lira, Memorandume të bashkëpunimit, Burime online të pasuruara dhe aktivitete tjera brenda vitit. Në pajtim me masat e kësaj strategjie janë realizuar një mori aktivitete trajnuese, janë zhvilluar programet trajnuese, doracakut për trajnues i cili i hap rrugë mekanizmit për matjen efektit të trajnimeve që po ashtu është një nga masat e kësaj strategjie si dhe aktivitete tjera. Për ilustrim shih grafikoni si në vijim:



Grafikoni nr. 2


Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave e bënë Akademinë e Drejtësisë përgjegjëse në pesë (5) masa përmes të cilave kërkohet rritje e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajtimin e drejtë dhe meritore të rasteve të dhunës në familje sipas standardeve të Konventës së Stambollit. Në zbatim të këtyre masave janë realizuar rreth 30 aktivitete trajnuese duke përfshirë aspektin penal dhe aspektin civil të dhunës në familje. Për ilustrim shih grafikoni si në vijim:



Grafikoni nr. 3


Programi Kombëtar për të Drejtat e Njeriut e bënë përgjegjëse Akademinë e Drejtësisë në shtatë (7) masa që kërkojnë zhvillimin e kurrikulave trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në pajtim me standardet evropiane. Masat nga ky program kërkojnë ofrimin e trajnimeve veçanërisht me theks të veçantë për praktikën dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në trajtimin e barabartë dhe pa diskriminim të kryesve me ç'rregullime mendore, për lirinë e shprehjes, gjuhën e urrejtjes, lirinë e medias dhe për sinjalizimin e gazetarëve, për dhunën në familje, dhunën seksuale, ngacmimin seksual veçanërisht pas ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit Penal.

Meqenëse disa nga masat janë shumë të përfarta me masat nga Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunën ndaj grave si ilustrim në grafikoni do të shfaqen vetëm trajnimet sa i përket drejtave të njeriut sipas KEDNJ-së.



Grafikoni nr. 4

Krahas Strategjive edhe PKZMSA dhe Agjenda Evropiane (ERA) kërkojnë rritje të kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e hetimit financiar dhe pastrimit të parave, prandaj për këtë fushë janë realizuar 9 aktivitete trajnuese në të cilat kanë përfituar gjyqtarë e prokurorë dhe jo vetëm. Për ilustrim shih grafikoni si në vijim:



Grafikoni nr. 5

Për këto aktivitete janë hartuar raporte në baza të rregullta për institucionet dhe mekanizmat përkatës me ç'rast është vendos Akademia e Drejtësisë në institucionet më të përgjegjshme si në zbatim ashtu edhe në raportimin e masave. Lidhur me këtë janë raportet e organizatave që e monitorojnë zbatimin e planit të veprimit për zbatimin e këtyre strategjive me theks raporti i Ministrisë së Drejtësisë, raporti i IKD-së i publikuar në gjysmën e dytë të vitit 2023 të cilat vendosin Akademinë e Drejtësisë si njërin prej institucioneve që ka realizuar më së shumti aktivitete përkundër buxhetit më të vogël në raport me institucionet tjera.

Përveç mekanizmave euro integruar, Akademia e Drejtësisë në vazhdimësi ka bashkëpunuar me KGJK dhe KPK dhe njësitë për shqyrtimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që veprojnë në kuadër të dy këshillave duke i ofruar të dhëna mbi vijueshmërinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnime. Gjithashtu për nevoja të raportimit ose edhe të prezantimit institucional në konferenca, takime dhe forma tjera janë nxjerrë të dhëna statistikore për aktivitetet trajnuese dhe detajet tjera që tregojnë angazhimin e Akademisë në ngritje të kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë sipas ligjit.

4.3. Arritjet në zbatimin e Programit Trajnues 2023

Pavarësisht sfidave me të cilat është përballë Akademia e Drejtësisë ka pasur edhe arritje meqë me sukses ka përmbushur gjitha programet dhe aktivitetet e saj sipas programit trajnues 2023.

Në kuadrin e trajnimeve fillestare përveq gjeneratës së IX të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët kanë vijuar trajnimin fillestar deri në korrik të vitit 2023, nga muaji prill filloj trajnimi fillestar edhe për 29 gjyqtarë dhe 21 prokurorë të sapa emëruar të cilët për Akademinë e Drejtësisë përbëjnë gjeneratën e X. Që nga nga kjo periudhë janë zhvilluar sesionet trajnuese konform programeve trajnuese për këto gjenerata. Programi për gjyqtarët ka qenë i dizjuanuar që të zbatohet fillimisht me sesionet e trajnimit teorik dhe kështu ka vazhduar edhe për gjeneratën e X i cili sipas kalendarit do të vazhdojë deri në prill të vitit 2024.

Në kuadrin e trajnimeve të vazhdueshme janë realizuar 140 aktivitete trajnuese për gjyqtarë, dhe prokurorë. Shtuar kësaj dhe trajnimet e realizuara për stafin administrativ dhe profesionet e lira, përfshirë këtu edhe Trajnimet e trajnuesve si dhe mësimi në distancë janë realizuar mbi 200 aktivitete trajnuese. Vëmendje të veçantë në trajnimet e vazhdueshme kanë pasur trajnimet për risitë

ligjore të Kodit të Procedurës Penale, trajnimet në formë të tryezave për unifikim të praktikës në të gjitha fushat, programet e specializuara për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, trajnimet për të drejtat e njeriut, drejtësinë për fëmijë, dhunën në familje, trajnimet nga aspekti interdisiplinar si dhe trajnimet në fushën e ndërmjetësimit, krimit kibernetik të cilat i janë dedikuar gjyqtarëve dhe prokurorëve nga departamentet përkatëse.

Përveç zbatimit të trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë janë zbatuar edhe një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve trajnuese sipas kurrikulës trajnuese për bashkëpunëtorët profesional si dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive. Gjatë këtij viti janë realizuar aktivitetet trajnuese për grupet e bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor që nuk janë përfshirë më parë në modul-in-aspekti penal material dhe procedural si dhe civil material dhe procedural. Gjithashtu edhe aktivitetet trajnuese sipas planifikimit për stafin tjetër administrativ të gjykatave dhe prokurorive si dhe për profesionistët tjerë ligjor përkatësisht për përmbauesit, mbrojtësit e viktimave, ndërmjetësuesit, si dhe për zyrtarët e ndihmës juridike falas.

Programi për Trajnim Fillestar 2023								
Përfituesit Gjyqtarë/prokurorë të sapo emëruar	Nr. i përgjith.	Të trajnuar	Sesionet e trajnimit		Ditë trajnimi	Nr. i orëve	Trajnuesit	Mentorët
			teorik	praktik				
Gjyqtarët-gjen IX	48	45	33	251	185	198	19	83
Prokurorët-gjen IX	6	4	46	91	137	276	17	4
Gjyqtarët-gjen X	29	29	116	41	157	696	32	29
Prokurorët-gjen X	22	22	63	92	155	378	24	22
Totali	105	100	258	476	734	1548	92	138
Programi për Trajnim të Vazhdueshëm 2023								
Përfituesit	Nr./aktiv	Të trajnuar	Pjesëmarrja në trajnime		Numri i trajnimeve	Nr. i trajnimeve në ditë		
Gjyqtar	404 ³	335	1474		140	225		
Prokuror	181 ⁴	144	497					
Bashkëpunorë profesional/zyrtarë	në trajnime me gjyqtarë dhe prokurorë	156 39	227 54					

³ Gjyqtarë në gjykata sipas raportit vjetor të statistikave https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114_RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf

⁴ Numri i përgjithshëm i prokurorëve sipas raportit vjetor të punës së vitit 2022 <chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/RAPORTI%20VJETOR%20I%20PROKURORIT%20TE%20SHTETIT%202022.pdf>

ligjor të gjykatave dhe prokurorive	në Modulin Penale& civile dhe trajnime përkatëse			51	
	Trajnime tjera për bashkëp. profesional dhe zyrtarë ligjor	1169	276	4	63
Stafi administ. gjyqësor/prokurorial	/	122	124	6	7
Gjyqtarët porot fillestar	/	87	87	1	4
Profesione të lira dhe profesionistë tjerë ligjor	në trajnime me gjyqtarë dhe prokurorë		688 ⁵		
	Veçanërisht për ndërmjetësuesit	11	28	4	4
	Avokat	27	27	4	4
TIT	/	72	97	7	12
Mësimi në distancë					
Platformat	Progresi/Kurset e zhvilluara				Pjesëmarrës
HELP	Trajnimi i trajnuesve për metodologjinë HELP				19
Moodle	Trajnimi për hetimet financiare dhe rikuprimin e asetëve ⁶				32
Zoom	Aspektet më të rëndësishme të Sekuestrimit\Konfiskimit të pasurive, sipas sistemit ligjor në Shqipëri dhe Kosovë				4

Tabela nr.1: Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023

4.4 Krahasimi i punës së Akademisë në tri vitet e fundit

Viteve të fundit sistemi gjyqësor dhe prokurorial ka pasur zhvillime të reja, veçanërisht rekrutime të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj, bashkëpunëtorëve profesional, lëvizje të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga një nivel në nivelin tjetër, ndryshime legjislative etj. Prandaj, këto edhe kërkesat e dokumenteve strategjike të vendit të cilat kërkojnë përmirësimin e cilësisë së punës në Gjykata dhe Prokurori kanë pasur impakt edhe në planet dhe programet e trajnimit të Akademisë.

Zhvillimet e Akademisë në raport me vitet paraprake janë të prezantuara më poshtë në formë tabelare.

⁵ Avokatë shtetëror, Zyrtarë të ndihmës juridike falas, Përmbarues, Ndërmjetësues, Zyrtarë nga sherbimi korrektues, Zyrtarë nga qendra për punë sociale, Zyrtarë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, Zyrtarë nga Njësia e Intelegjencës Financiare, Mbrojtës të viktimave etj.

⁶ Trajnimi me pjesëmarrje fizike ndërkaq platform aka shërbyer për materialet dhe ushtrimet praktike

Krahasimi i punës së AD-së për tri vitet e fundit			
Aktivitetet	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Trajnime fillestare	Për 24 gjyqtarët e sapo emëruar, gjen. VIII janë realizuar 197 aktivitete trajnuese	Për 48 gjyqtarët e sapo emëruar, gjen. IX janë realizuar 204 aktivitete trajnuese Ndërsa për 6 prokurorët e sapo emëruar, gjen. IX 113 aktivitete	Vazhdimi dhe përfundimi i trajnimit fillestar për gjeneratën e IX të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar Fillimi dhe zbatimi I trajnimit fillestar për gjeneratën e X (29 gjyqtarë dhe 21 prokurorë)
Tranime të vazhdueshme	128	143	140
Trajnime për stafin administrative gjyqësor dhe prokurorial	9 sesione trajnuese me 10 ditë trajnimi	23 trajnime për bashkëpunëtorë profesional 10 trajnime për stafin tjetër me 13 ditë trajnimi	55 trajnime për bashkëpunëtorë profesional me 63 ditë trajnimi dhe 6 trajnime për stafin tjetër administrativ gjyqësor dhe prokurorial me 7 ditë trajnimi
Trajnime për profesionet e lira	2 sesione për përmbuesit privat dhe 1 sesion trajnues për zyrtarët e ndihmës juridike falas	10 trajnime (5 për zyrtarët e ndihmës juridike falas, 3 për mbrojtësit e viktimave dhe 2 për përmbuesit privat	4 trajnime për ndërmjetësues
Aktivitete tjera⁷	122	324	Mbi 300
Pjesëmarrja gjyqtarë/prokurorë në trajnime të vazhdueshme	2992 ⁸ gjyqtarë, 723 ⁹ prokuror,	2005 gjyqtarë dhe 626 prokurorë	1479 gjyqtarë 479 prokurorë
Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar	24 gjyqtarë	48 gjyqtarë 6 prokurorë	45 gjyqtarë, gjen.IX 29 gjyqtarë, gjen.X 5 prokurorë, gjen IX 21 prokurorë, gjen.X
Numri i pjesëmarrësve nga stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial	49 bashkëp.prof dhe zyrtarë ligjor, 3 referentë, 1 mbrojtës i viktimave në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë, në trajnime veçanërisht për stafin administrativ 185 gjithësejt	2984 pjesëmarrës që janë përfshirë qoftë në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë ashtu edhe në trajnimet dedikuar veq profileve përkatëse	1517 pjesëmarrës qoftë në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë ashtu edhe në trajnimet dedikuar veq profileve përkatëse
Numri i personelit të AD-së	26	25	25

Tabela nr.2: Krahasimi i punës së Akademisë në tri vitet e fundit

⁷ Përjashtim nga aktivitetet trajnuese janë përfshirë takimet e punës me KD, KP, trajnues, krerë të gjykatave dhe prokurorive, të KGJK-së dhe KPK-së, vizita të ndërsjella në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtarë, punëtori të ndryshme, takime koordinuese etj.

⁸ Gjyqtarë që kanë marrë pjesë në më shumë trajnime se njëherë.

⁹ Prokurorë që kanë marrë pjesë në më shumë se njëherë në trajnime.

4.5 Ngritja e cilësisë së trajnimeve dhe avancimi i metodologjisë trajnuese në programet e Akademisë së Drejtësisë

Edhe në periudhën raportuese AD është përkushtuar në ngritjen e cilësisë së trajnimeve dhe avancimin e metodologjisë trajnuese. Kjo çështje është adresuar fillimisht përmes rishikimit të Rregullores për trajnues, përkatësisht kriterëve për trajnues. Përveq kësaj është e angazhuar edhe në zhvillimin e Doracakut për trajnues i cili është miratuar nga Këshilli Drejtues gjatë këtij viti. Ky doracak me metodologjinë më të avancuar të mësimdhënies në fushën e mësimin për të rritur pritjet të zbatohet në praktikë nga trajnuesit dhe stafi i AD-së përmes të cilit synohet një rol më aktiv i trajnuesit si në vlerësimin e trajnimit ashtu edhe në përgatitjet dhe zbatimin e tij sipas nevojave trajnuese.

Sa i përket trajnimeve të zbatuara gjatë vitit është vazhduar metodologjia përmes tryezave, punës në grupe si dhe trajnimeve përmes rasteve studimore. Kjo metodologji është vlerësuar më atraktive, efektive meqenëse ka prodhuar interaktivitet qoftë nga pjesëmarrësit ashtu edhe nga trajnuesit. Për këto aktivitete trajnuese bazuar në vlerësimet për trajnues dhe në koordinim me organet kompetente drejtuese mbrenda AD-së janë angazhuar trajnues me përvojë dhe shkathtësi në mësim dhënie e gjithashtu ka rrit kapacitetet trajnuese përmes trajnimit të trajnuesve për disa fusha specifike. Për cilësi në trajnime gjithashtu AD në mbështetje të projekteve të ndryshme ka angazhuar ekspertizë ndërkombëtare veçanërisht për gjykimin e rasteve të korrupsionit, shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe në sfera tjera. Me rastin e hartimit dhe zbatimit të trajnimeve ka bashkëpunuar ngushtë me KGJK dhe KPK duke përfshirë edhe gjyqtarë, prokurorë si dhe trajnues me përvojë me qëllim të zbatimit të praktikave më të mira të trajnimit gjyqësor.

4.6 Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese dhe hartimit të Programit Trajnues për vitin 2024

Vlerësimi i nevojave trajnuese për përfituesit e AD-së sipas ligjit është esenciale meqë i paraprinë hartimit të programit trajnues përshtatshmërisht me nevojat trajnuese dhe është mandant që buron nga Ligji për AD-në, përkatësisht neni 6, pika 1.1, 1.2 dhe 1.5 e këtij ligji.

Edhe këtë vit, stafi përgjegjës nga PHP dhe PTV janë angazhuar në zbatimin e mekanizmave për vlerësim të nevojave trajnuese me qëllim identifikimin e vështirësive praktike dhe sfidave me të cilat përballen gjyqtarët dhe prokurorët në procesin e bërjes së drejtësisë në rastet e ndryshme ligjore. Në procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese janë zbatuar mekanizmat të cilët janë në pajtim me standardet që kanë në qendër vlerësimin gjatë fazës së planifikimit, hartimit dhe zbatimit të programit dhe ishin si në vijim:

- Strategjitë dhe dokumentet e miratuara nga institucionet për gjyqësorin dhe sundimin e ligjit;
- Anketat vlerësuese: Formularët e vlerësimit pas secilit sesion trajnues dhe Pyetësorët për gjyqtarë dhe për prokurorë njëherë brenda vitit;
- Shkresat drejtuar KGJK-së dhe KPK-së dhe observimeve nga Zyra për Vlerësim të Përfomancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve

- Takimet me gjyqtarë dhe prokurorë, kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorë të prokurorive;
- Takimet dhe diskutimet me trajnuesit të AD-së-së dhe veçanërisht konkluzionet e tyre pas trajnimeve
- Punëtoritë për vlerësim të nevojave trajnuese
- Përfshirja e shoqërisë civile përmes takimeve dhe
- Monitorimi i mediave të shkruara dhe elektronike

Të gjitha këto burime janë konfirmuar në punëtorinë për vlerësimin e nevojave trajnuese e realizuar nga AD me 27 korrik 2023 dhe në punëtorinë e KGJK-së me 5 dhe 6 tetor 2023 me ç ‘rast janë bërë të ditura politikat rreth trajnimeve për gjyqtarë dhe stafin mbështetës të gjykatave.

4.7 Punëtori për hartimin e Programit trajnues për vitin 2023

Në periudhën raportuese AD ka realizuar tri (3) punëtori për hartimin e programit trajnues, një me 27 korrik 2023 si dhe një me 13 dhe 14 nëntor 2023 si dhe një me 21 dhjetor 2023.

Qëllimi i këtyre punëtorive ishte përcaktimi i Kurrikulës Trajnuese për vitin 2024, qoftë në PTV ashtu edhe për PTF, përkatësisht për gjeneratën e XI të gjyqtarëve të sapo emëruar.

Në tri punëtoritë e realizuara për hartim të programit trajnues kanë marrë pjesë përfaqësues nga KGJK dhe KPK, kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive nga të gjitha instancat e gjykatave dhe prokurorive duke përfshirë edhe gjyqtarë dhe prokurorë tjerë, Këshilli Programor dhe pjestarë edhe nga Këshilli Drejtues për të parë më afër procesin dhe punën gjatë hartimit të programit.

Këshilli Programor ka qenë pjesë aktive në hartimin e programeve trajnuese. Për trajnimet e vazhdueshme Këshilli Programor ka bashkëpunuar ngushtë me kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive si dhe ka pasur në konsideratë gjetjet nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese për PTV dhe PTF.

5. AKTIVITETET TRAJNUESE DHE AKTIVITETET E TJERA TË REALIZUARA SIPAS PROGRAMEVE TË AD-SË

Raporti në vijim përmban aktivitetet sipas programeve dhe objektivave si në vijim:

5.1 AFTËSIMI I GJYQTARËVE/PROKURORËVE TË SAPO EMËRUAR DHE PËRGATITJA PROFESIONALE PËRSHTATSHMËRISHT ME ROLIN DHE DETYRAT E FUNKSIONIT PËRKATËS (PROGRAMI I TRAJNIMIT FILLESTAR)

Akademia e Drejtësisë është përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve fillestare për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar. Ky mandat buron nga Ligji për Akademinë e Drejtësisë dhe

legjislacioni në fuqi për sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Tajnimi fillestar zgjatë 12 muaj dhe zbatohet sipas modelit të kombinuar duke përfshirë aspektin teorik dhe praktik.

Në trajnimet teorike përfshihen të gjitha degët e së drejtës dhe ligjeve vendore, Konventa Evropiane për të Drejta e Njeriut dhe akte të tjera ndërkombëtare përmes gjashtë (6) moduleve trajnuese bazë nga gjithsejtë 49 nën-module për gjyqtar të sapo emëruar dhe pesë (5) module nga gjithësejt 35 nën module për prokuror të sapo emëruar. Modulet trajnuese janë të karakterit profesional që përfshijnë trajtimin e legjislacionit në fuqi për të gjitha fushat e së drejtës dhe interdisiplinare dhe aftësish praktike që do t'iu nevoiten atyre si hartimi i vendimeve procedurale, aftësi për të bërë pyetje, kryesimi i seancave dhe veprime tjera të nevojshme gjatë procedimit të rasteve.

Trajnimi praktik realizohet në gjykata/prokurori në të cilat janë emëruar dhe nën mbikëqyrjen e mentorit. Ky trajnim përfshinë aspektet praktike të punës së gjyqtarit/prokurorit, ndërkaq AD e monitoron këtë proces përmes koordinimit dhe punës së përbashkët me mentorë.

Pjesë përbërëse e programi trajnues janë edhe vizitat/trajnimet në institucione jo gjyqësore të cilat kanë për qëllim të ofrojnë njohuri gjyqtarëve/prokurove të shtetit të sapo emëruar me legjislacionin dhe praktikën që zbatojnë institucionet shtetërore gjatë punës së tyre, si dhe aktivitete që kryejnë këto institucionet, të ndërlidhura me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

Për çdo modul trajnues në fund realizohet testi përfundimtar dhe raporti i vlerësimit për gjyqtarë dërgohet në KGJK, respektivisht Komisionin për Vlerësimin e Performancës si dhe për prokurorë në KPK, përkatësisht në Komisionin për Vlerësimin e Performancës brenda afatit të paraparë

5.1.1 Të arriturat dhe sfidat sipas objektivave të parapara në Planin e Punës dhe të performancës për vitin 2023 për Programin e Trajnimit Fillestar

Në periudhën raportuese janë realizuar trajnimet fillestare për dy gjenerata, IX dhe X e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar. Nga dy gjeneratat për dy profilet janë 100 pjesëmarrës, prej tyre 74 gjyqtarë dhe 26 prokurorë të sapo emëruar.

Viti 2023 ka qenë mjaft sfidues për AD meqë KGJK dhe KPK ende pa përfunduar gjenerata e IX-të trajnimin fillestar ka realizuar procesin e ri të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj. Si rrjedhojë AD në faza të caktuara është përballë me zbatimin e programit fillestar paralelisht me dy gjeneratat dhe me nga katër klasa trajnimi për shkak se programi është i ndarë për gjyqtarë dhe prokurorë e njëkohësisht për secilën gjeneratë për shkak të periudhave të ndryshme kohore të fillimit dhe zbatimit të trajnimit.

Vështirësitë kanë qenë të theksuara në koordinimin e programeve dhe trajnuesve, hapsirave të pamjaftueshme për akomodim duke qenë se nevoja për trajnime ishte edhe nga gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë duke përfshirë edhe e përfituesve tjerë sipas ligjit, mungesës së resurseve njerëzore e financiare. Përkundër këtyre vështirësive është zbatuar trajnimi konform kalendarit dhe programit trajnues për gjyqtarët dhe prokurorët si në vijim:

- Gjenerata IX e gjyqtarëve të sapo emëruar (45)
- Gjeneratat e IX e prokurorëve të sapo emëruar (4)

- Gjenerata X e prokurorëve të sapo emëruar (22)
- Gjenerata X e gjyqtarëve të sapo emëruar (29)

5.1.2 Aktivitetet trajnuese për gjeneratën e IX (45 gjyqtarë dhe 4 prokurorë) në Trajnimin Fillestar

Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e IX

Në gjeneratën e IX fillimisht ishin 48 gjyqtarë të cilët trajnimin e kanë filluar me 15 korrik 2022. Pas zhvillimeve në veri, 3 gjyqtarë nga minoriteti serb janë dorëhequr nga funksioni dhe rrjedhimisht kanë munguar edhe në trajnimin fillestar. Në periudhën raportuese është vazhduar zbatimi i tranimeve fillestare për 45 gjyqtarë deri me 31 korrik 2023, datë kjo e cila shënon përfundimin e programit për këtë gjeneratë.

Gjyqtarët edhe gjatë vitit 2023 kanë vazhduar sesionet e trajnimit teorik në dy grupe intenzivisht në 5 ditë të javës deri në muajin shkurt me ç’rast është përmbushur trajnimi teorik në modulet e fundit sipas programit trajnues si në vijim:

Për grupin e I-rë të gjyqtarëve janë realizuar gjithsej 34 sesione apo 102 orë trajnimi nga nën modulet:

- Moduli: **E drejta civile administrative ekonomike:** 26 sesione apo 78 orë trajnim nga nën modulet: Procedura jokontestimore, e drejta familjare, e drejta e punës, procedura kontestimore-pjesa e dytë, procedura kontestimore-pjesa e parë, e drejta detyrimeve dhe e drejta e përafërt dhe të drejtat tjera sendore”.
- Moduli: **Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale:** 8 sesione apo 24 orë trajnim dhe janë trajtuar arsyetimi i vendimeve në lëmine civile dhe penale.

Për grupin e II-të të gjyqtarëve janë realizuar gjithsej 32 sesione apo 96 orë trajnimi nga nën modulet si më poshtë:


- Moduli: **Kodi i Procedurës penale:** 16 sesione apo 48 orë trajnim dhe janë trajtuar nën modulet: Provat në procedurën penale, roli i gjyqtarit në procedurën parapake, prokurori i shtetit, i pandehuri dhe i dëmtuari, shqyrtimi gjyqësor, procedurat alternative, procedurat e veçanta sipas KPPK, dhe e drejta e përafërt dhe të drejtat tjera sendore.
- Moduli: **Shkathtësitë personale dhe ndërpersonale:** 5 sesione apo 15 orë trajnimi dhe janë trajtuar nën moduli: Arsyetimi i vendimeve në lëmin penale dhe ngritja e shkathtësive sociale të gjyqtarëve.
- Moduli: **Kodi Penal i Republikës së Kosovës:** 2 sesione apo 6 orë trajnim dhe është trajtuar nën moduli përgjegjësia e personave juridik.
- Moduli: **Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese:** 9 sesione apo 27 orë trajnim dhe janë trajtuar nën modulet: Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore.

Për zbatimin e trajnimit teorik për dy grupet e gjyqtarëve të kësaj gjenerate janë angazhuar 19 trajnues. Prej tyre, 5 nga radha e gjyqtarëve të Gjykatës Supremes, 9 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit,

2 prokuror nga Zyra e Prokurorit të Shtetit, 1 prokuror nga niveli themelore, 1 gjyqtarë nga niveli themelor dhe 1 profesorëve universitar.

Nga muaji shkurt është vazhduar me trajnimin praktik në gjykatat përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit me ç'rast janë realizuar 126 ditë të trajnimit praktik duke përfshirë edhe vizitat në institucionet jo gjyqësore. Në kuadër të këtij trajnimi praktik, gjyqtarët nën mbikëqyrjen e gjyqtarit mentorë kanë asistuar në të gjitha aktivitetet gjyqësore që kanë qenë sipas planit të punës.

Për zbatimin e trajnimit praktik kanë qenë të angazhuar 83 gjyqtarë mentorë të cilët janë koordinuar me Akademinë e Drejtësisë dhe në baza periodike kanë njoftuar për ecurinë dhe mbarëvajtjen e trajnimit praktik.



Grafikoni nr. 6

Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, gjenerata e IX

Në gjeneratën e IX të prokurorëve të cilët trajnimin e kanë filluar me 04 korrik 2023 fillimisht ishin 6 prokurorë. Në periudhën raportuese është vazhduar zbatimi i trajnimeve fillestare për 4 prokurorë meqë dy prokurorë nuk e kanë vazhduar trajnimin fillestar për shkak të pushimit të lehonisë. Trajnimi fillestar është zbatuar në çdo javë, 2 ditë trajnimi teorik në AD dhe 3 ditë tjera trajnimin praktik në prokurori me ç'rast janë realizuar 46 ditë të trajnimit teorik dhe 91 ditë të trajnimit praktik deri me 24 korrik 2023, datë kjo e cila shënon përfundimin e programit për këtë gjeneratë.


Në kuadër të trajnimit teorik sipas Programit trajnues fillestar për prokurorë janë realizuar pesë (5) module trajnuese si në vijim:

- **Kodi Penal i Republikës së Kosovës:** 12 sesione trajnuese apo 36 orë trajnimi dhe janë trajtuar nën modulet: Kodi Penal-pjesa e veçantë, krimi kibernetikë, politika ndëshkimore dhe përgjegjësia e personave juridik.
- **Kodi i Procedurës Penale:** 57 sesione trajnuese apo 171 orë trajnimi dhe janë trajtuar nën modulet si në vijim: Dëshmitarët dhe të dëmtuari, I pandehuri në procedurën penale, provat gjatë hetimit, procesverbale, administrimi i procedurës penale, procedurat alternative,

aktakuza procedura e shqyrtimit, roli i prokurorit në shqyrtim gjyqësor, shqyrtimi fillestar dhe i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor, procedurat e veçanta sipas KPPK, ushtrimi i mjeteve juridike dhe shpenzimet e procedurës dhe kërkesa pasurore juridike.

- **Shkathtësitë personale dhe interdisciplinare:** 4 sesione trajnues apo 12 orë trajnimi dhe është trajtuar arsyetimi i akteve akuzuese.
- **Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar:** 13 sesione trajnues apo 39 orë trajnim dhe janë trajtuar nën modulet: E drejta e Bashkimit Evropian, Konventa Evropiane për Liritë dhe te Drejtat e Njeriut, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në lëmin civile dhe penale.
- **Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese:** 6 sesione apo 18 orë trajnues dhe janë trajtuar nën modulet: Kodi i Drejtësisë për të Mitur dhe zhvillimi i shkathtësive gjyqësore.

Për zbatimin e trajnimit teorik për prokurorët e kësaj gjenerate janë angazhuar 17 trajnues ndërkaq për zbatimin e trajnimit praktik kanë qenë të angazhuar 4 prokurorë mentorë. Trajnuesit ishin 3 nga Gjykata Supreme, 5 nga Gjykata e Apelit, 1 nga Gjykata Themelore, 1 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, 3 nga Prokuroria Speciale, 1 nga Prokuroria Themelore, 2 nga Prokuroria e Apelit dhe 1 profesor universitar.



Grafikoni nr. 7

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe bashkërisht për dy profilet gjyqtarët dhe prokurorët e gjenerate janë realizuar vizitat/trajnimet në 8 institucionet jo gjyqësore.

Bazuar në legjislacionin në fuqi për dy profilet është hartuar testi përfundimtar nga trajnuesit i cili ka përmbajtur pyetje nga modulet që i kanë ndjekur gjatë vitit dhe raste hipotetike në fushën penale dhe civile. Është realizuar testi përfundimtarë me 4, 5 dhe 6 korrik 2023 dhe është bërë vlerësimi përfundimtar nga trajnuesit. Në vijim janë përgatitur raportet përfundimtare për secilin gjyqtarë dhe prokurorë dhe janë dërguar në KGJK dhe KPK, respektivisht në Komisionet për Vlerësimin e Performancës që veprojnë në kuadër të këtyre institucioneve për gjyqtarë dhe prokurorë.

5.1.3 Aktivitetet trajnuese për gjenerata e X (29 gjyqtarë dhe 21 prokurorë) në Trajnimin Fillestar


Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata X

Si rezultat i rekrutimit dhe dekretimit të grupit të ri të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar, nga 24 prill 2023 është filluar së zbatuari trajnimi fillestar edhe për dy profilet që përbënë gjeneratën e X për AD-në (29 gjyqtarë dhe 21 prokurorë).

Gjyqtarët me kërkesën e KGJK-së kanë vijuar sesionet e trajnimit teorik intenzivisht në 5 ditë të javës në AD deri në fund të muajit tetor, përkatësisht 6 muaj. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar të gjitha trajnimet teorike që përfshijnë 6 module trajnuese, përkatësisht 116 ditë të trajnimit teorik apo 232 sesione trajnuese si në vijim:

- **Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare:** 22 sesione apo 66 orë trajnimi dhe janë trajtuar nën modulet: Rregullat e komunikimit, ngritja e shkathtësive sociale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, menaxhimi i rasteve, etikë profesionale dhe përgjegjësia disiplinore dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore në lëmine penale dhe civile.
- **Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar:** 19 sesione apo 57 orë trajnim dhe janë trajtuar nën modulet: E drejta kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial, Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, e drejta e Bashkimit Evropian dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje civile.
- **E drejta civile, administrative dhe ekonomike:** 87 sesione apo 261 orë trajnim dhe janë trajtuar nën modulet: E drejta Civile, procedura kontestimore - pjesa e parë, procedura kontestimore - pjesa e dytë, procedura jonkontestimore, procedura përmbartimore, e drejta administrative, e drejta e detyrimeve, e drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera të përafërta, e drejta e punës, e drejta familjare, e drejta ekonomike dhe e drejta trashëgimore”.
- **Kodi Penal i Republikës së Kosovës:** 37 sesione apo 111 orë trajnimi dhe janë trajtuar nën modulet: Kodi penal - pjesa e përgjithshme, Kodi penal - pjesa e veçantë, krimi kibernetik, udhëzuesi për politik ndëshkimore dhe përgjegjësia e personave juridik”.
- **Kodi i Procedurës Penale:** 51 sesione apo 153 orë trajnimi dhe janë trajtuar nën modulet: Procedura parapenale, roli i gjyqtarit në procedurën paraprake, aktgjykimi dhe llojet e tij, dëshmitarët dhe të dëmtuarit, masat e fshehta të hetimit dhe të vëzhgimit, masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë, parimet, kompetencat dhe përjashtimi i gjyqtarit nga procedura penale, procedura alternative, procedura penale e kryesve me çrregullime mendore, procedurat e veçanta sipas KPPK, procedurat e veçanta sipas mjeteve juridike, prokurori i shtetit, mbrojtësi, i dëmtuari dhe i pandehuri si palë në procedurën penale, provat në procedurën penale, shpenzimet e procedurës dhe kërkesat pasurore juridike, shqyrtimi fillestar dhe i dytë, dhe shqyrtimi gjyqësor.
- **Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese:** 16 sesione apo 48 orë trajnim dhe janë trajtuar nën modulet: Kodi i drejtësisë për të mitur, ligji për kundërvajtje, ndërmjetësimi dhe zhvillimi i shkathtësive gjyqësore”.

Në këtë gjeneratë për zbatimin e trajnimit teorik janë angazhuar 32 trajnues prej tyre: 5 gjyqtarë nga Gjykata Supreme, 16 nga Gjykata e Apelit, 2 nga Gjykata Themelore, 2 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, 1 nga Prokuroria Speciale, 1 nga Prokuroria Themelore, 1 Përmbaues privat, 3 Profesor Universitar, 1 trajnues i përhershëm nga Akademia e Drejtësisë.



Grafikoni nr. 8

Nga muaji nëntor është vazhduar intenzivisht me sesionet e trajnimit praktik nën mbikëqyrjen e gjyqtarit mentorë që gjithësejt të angazhuar ishin 29 gjyqtarë. Deri në fund vit janë realizuar 41 ditë të trajnimit praktik në gjykatat përkatëse të emërimit.

Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, gjenerata X


Prokurorët në koordinim dhe me kërkesë të KPK-së ngjashëm me gjeneratën paraprake kanë vijuar trajnimin fillestar paralelisht me 2 (dy) ditë të trajnimit teorik nga modulet e këtij programi në Akademi të Drejtësisë dhe 3 (tre) ditë tjera të javës trajnimi praktik në prokuroritë përkatëse të emërimit. Sesionet e trajnimit teorik ishin si në vijim:

- **Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare:** 17 sesione apo 51 orë trajnimi dhe janë trajtuar nën modulet: Rregullat e komunikimit, ngritja e shkathtësive sociale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, menaxhimi i rasteve, etikë profesionale dhe përgjegjësia disiplinore.
- **Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar:** 15 sesione apo 45 orë trajnimi dhe janë trajtuar nën modulet: E drejta kushtetuese në raport me sistemin gjyqësor dhe prokurorial, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje civile dhe Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut.
- **Kodi Penal i Republikës së Kosovës** 33 sesione apo 99 orë trajnimi dhe janë trajtuar nën modulet: Kodi penal - pjesa e përgjithshme, Kodi penal - pjesa e veçantë, krimi kibernetik dhe përgjegjësia e personave juridik.

- **Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese:** 3 sesione apo 9 orë trajnimi dhe janë trajtuar nën modulet: “Kodi i drejtësisë për të mitur” dhe “Ligji për Kundërvajtje”.
- **Kodi i Procedurës Penale:** 58 sesione apo 174 orë trajnimi dhe janë trajtuar nën modulet: Kallëzimi penal, fillimi i hetimit formal dhe procedura penale, ekspertiza dhe analizat, administrimi i procedurës penale, dëshmitarët dhe të dëmtuarit, i pandehuri në procedurën penale, kontrolli dhe konfiskimi, masat e fshehta të hetimit dhe të vëzhgimit, masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë, procedura alternative, procesverbalet, provat në procedurën penale, roli i prokurorit në shqyrtimin gjyqësor, shpenzimet e procedurës dhe kërkesat pasurore juridike dhe vendi i ngjarjes dhe forenzika”.

Në periudhën raportuese në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar 63 ditë trajnimi apo 126 sesione trajnuese dhe 92 ditë trajnim praktik në prokuroritë përkatëse ku janë emëruar. Grupit prej 21 prokurorëve nga muaji dhjetor i është bashkangjitur edhe një prokurorë e gjeneratës paraprake e cila ka lënë në gjysmë programin për shkak të pushimit të lehonisë.

Për zbatimin e trajnimit teorik janë angazhuar 26, trajnues prej tyre: 1 nga Këshilli Prokurorial, 2 gjyqtarë nga Gjykata Supreme, 6 nga Gjykata e Apelit, 2 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, 7 nga Prokuroria Speciale, 4 nga Prokuroria Themelore, 2 nga Prokuroria e Apelit, dhe 2 profesor universitar. Për zbatimin e trajnimit praktik në prokurori janë të angazhuar gjithsej 22 mentor.



Grafikoni nr. 9

Për numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar të trajnuar gjatë vitit 2023 shih tabelën si në vijim:

Gjyqtarë / prokurorë të sapoemëruar	Të trajnuar	Gjinia		Përkatësia Etnike			Totali i ditëve të trajnimit	Ditë trajnimi teorik	Ditë trajnimi praktik	Sesione Trajnuese	Orë Trajnimi	Trajnues të angazhuar	Mentor të angazhuar
		M	F	SHQ	SR	TJ							
Gr.I	45 ¹⁰	27	17	44	/	/							

¹⁰ Deri me dt. 08 nëntor 2022 trajnimin fillestar e kane ndjekur 48 gjyqtarë ndërkaq pas zhvillimeve të fundit në veri tre (3) gjyqtarë nga minoriteti serb kanë dhënë dorëheqje.

Gjenerata IX e gjyqtarëve		27	18	8	27	/	/	143	17	126	34	102	7	45
	Gr.II	18	9	9	17	/	1	142	16	126	32	96	12	38
Gjenerata X e gjyqtarëve		29	17	12	27	/	2	157	116	41	232	696	32	29
Gjenerata IX e prokurorëve		4 ¹¹	4	/	4	/		137	46	91	92	276	17	4
Gjenerata X e prokurorëve		22 ¹²	14	8	22	/		155	63	92	126	378	24	22
Totali		100	61	37	97	0	3	734	258	476	516	1548	92	138

Tabela nr. 3: Sesionet trajnuese për gjyqtarët/prokurorët e sapo emëruar, gjeneratën e IX dhe X në PTF

5.1.4 Vizitë studimore e gjyqtarëve (gjeneratës së VIII në PTF) në Trier dhe Koblenz të Gjermanisë.

Nga data 19-24 shkurt 2023, në mbështetje të IRZ-së për gjyqtarët e gjeneratës të cilët kanë përfunduar trajnimin fillestarë në vitin 2022 është realizuar një vizitë studimore në Akademinë Gjermane të Drejtësisë. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë mundësimi i vëzhgimit praktik i metodave të punës në gjykatat gjermane, si dhe shkëmbimi i përvojave dhe fuqizimi i kontakteve ndërmjet institucioneve të dy vendeve.

Në kuadër të kësaj vizite pjesëmarrësit patë mundësinë e njohjes me rregullimin e sistemit gjyqësor në Gjermani dhe veçanërisht për drejtësinë penale, civile, familjare, çështjet etike, çështjet tregtare si dhe për mundësinë e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve në Gjermani. Pjesëmarrës në këtë vizitë ishin 18 gjyqtarë si dhe 3 zyrtarë nga Akademia e Drejtësisë. Vizita studimore është mundësuar për gjyqtarët e gjeneratës së VIII që kanë përfunduar trajnimin fillestarë në Akademi të Drejtësisë gjatë vitit 2021-2022.

5.1.5 Trajnimi për gjyqtarë porot fillestar

Nga data 22 - 25 qershor 2023, Akademia e Drejtësisë, në koordinim edhe me Këshillin Gjyqësor të Kosovës ka realizuar trajnimin fillestar për Gjyqtarët e sapo emëruar porotë në të gjitha regjionet e Republikës së Kosovës. Në pajtim me vendimin e KGJK-së gjyqtarët porot kanë vijuar trajnimin teorik dhe praktik. Në trajnimin teorik programi është fokusuar tek parimet e procedurës kontestimore dhe jokontestimore, kompetencat e gjykatës në kontestet martesore, padinë për zgjidhjen e martesës, detyrat dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve porotë, procedura dhe masat disiplinore dhe në fund i janë nënshtruar testimit final.

Pas trajnimit teorik, gjyqtarët porotë kanë ndjekur edhe nga 2 ditë trajnim praktik në gjykatat përkatëse ku ata janë emëruar me ç ‘rast bazuar në vendimin e KGJK, AD ka përfunduar obligimet e saj për trajnimin e gjyqtarëve porotë të sapoemëruar. Këtë trajnim e kanë vijuar 85 gjyqtarë porotë.

¹¹ Gjatë vitit 2023 në gjeneratën e IX të prokurorëve dy prokurorë kanë ndërprerë trajnimin për shkak të pushimit të lehonisë

¹² Nga muaji dhjetor 2023, gjeneratës së dhjetë të prokurorëve kësaj gjenerate i është bashkuar prokuroria nga gjenerata e IX e cila ka përfunduar pushimin e lehonisë.

5.2 AVANCIMI I VAZHDUESHËM I NJOHURIVE PROFESIONALE TË GJYQTARËVE, PROKURORËVE, STAFIT ADMINISTRATIV GJYQËSOR DHE PROKURORIAL SI DHE PROFESIONISTËVE TJERË LIGJOR NË SHKATHTËSITË DHE KOMPETENCAT PROFESIONALE DHE INTERDISIPLINARE (PROGRAMI I TRAJNIMIT TË VAZHDUESHËM)

Trajnimet e vazhdueshme sipas Ligjit për AD-në i dedikohen gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë duke përfshirë edhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial dhe profesionistët tjerë ligjor. Pa marrë parasysh përvojën gjatë shërbimit, zhvillimi profesional në çdo fazë të karrierës është i domosdoshëm, prandaj një ndër mekanizmat që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë së punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve është zhvillimi i vazhdueshëm profesional.

Ky program trajnimi ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve etike, profesionale, dhe praktike për zbatimin e drejtë të legjislacionit në fuqi dhe njëherësh zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve gjyqësore. Nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme Akademia e Drejtësisë synon gjithashtu në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

5.2.1 Objektivat e Programit për Trajnim të Vazhdueshëm për vitin 2023

- Zbatimi i trajnimeve të specializuara;
- Zbatimi i trajnimeve sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Zbatimi i trajnimeve interdisiplinare për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes realizimit të tryezave në fushën penale dhe civile;
- Zbatimi i programeve trajnuese të veçanta dhe cilësore për nevojat e avancimit në profesional
- Zbatimi i trajnimeve për gjyqtarë porotë;
- Zbatimi i trajnimeve për Trajnues
- Zbatimi i trajnimeve për Bashkëpunëtor Profesional dhe Zyrtar Ligjor
- Zbatimi i trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

5.2.2 Arritjet dhe sfidat gjatë zbatimit të trajnimeve të vazhdueshme

Në periudhën raportuese janar-dhjetor 2023, në kuadër të PTV-së janë realizuar 218 aktivitete trajnuese me 326 ditë trajnimi. Në këtë numër të aktiviteteve hyjnë trajnimet për gjyqtarë, prokurorë, staf administrativ, gjyqtarë porotë dhe trajnime tjera. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në këto aktivitetet trajnuese ishte 4516 pjesëmarrës.

Përkundër hartimit të programit trajnues sipas nevojave trajnuese, përgatitjeve me kohë të AD-së sa i përket kalendarit trajnues dhe ftesave për pjesëmarrje sipas aplikimit, vazhdon të ketë mos pjesëmarrje në trajnimet që vet kanë aplikuar. Situatat e tilla pamundësojnë njohjen me kohë të numrit të pjesëmarrësve dhe përgatitjet tjera të rëndësishme të trajnimit si përkthimi, materialet, ushqimi të cilat si pasojë kanë mos vlerësimin real edhe shpenzimet e panevojshme dhe në disa situata edhe anulimin e trajnimit. Në periudhën raportuese janë anuluar 11 trajnime të cilat ishin

në fushën e të drejtave të njeriut, drejtësia komerciale, aspekti i korrupsionit etj., pothuajse mandatore në program për shkak se ishin kërkesë e vet atyre dhe nga dokumentet strategjike të vendit në fushën e gjyqësorit. Përveq kësaj mungesa e ekspertizës ose gatishmërisë për të trajtuar tema specifike siq është menaxhimi dhe udhëheqja me gjykata dhe prokurori të mos mund të realizohen fare edhe përkundër nevojës për shkathtësitë përkatëse.

Përkundër sfidave që u thanë janë realizuar trajnime për gjyqtarë, prokurorë dhe komunitetin tjetër ligjor të cilat kishin në fokus çështjet sfiduese të praktikës gjyqësore me të vetmin qëllim përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të punës në gjykata dhe prokurori.

Për më në detaje shih të dhënat në tabelat si në vijim:

Aktivitetet trajnuese të realizuara gjatë vitit 2023 në PTV																		
Aktivitete Trajnuese		Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve	Aktivitetet trajnuese për Gjyqtarë dhe prokurorë		Aktivitetet trajnuese për Bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjore		Aktivitetet trajnuese për Stafin Administrativ gjyqësor dhe prokurorial		Menaxhim dhe Lidership		Trajnime për Gjyqtarët Porotë		Trajnim për Trajnues		Profesionet e lira Avokat		Profesionet e lira Ndërmjetësues	
218	Ditë trajnime 326		140	225 ditë	55	63 ditë	6	7 ditë	1	2 ditë	1	4 ditë	7	17 ditë	4	4 ditë	4	4

Tabela nr. 4: Aktivitetet trajnuese në PTV

Gjyqtarët në trajnime gjatë 2023		
Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve në sistem	Numri i gjyqtarëve pjesëmarrës në trajnime	Numri i gjyqtarëve të trajnuar
404	1474	335

Prokurorët në trajnime gjatë 2023		
Numri i përgjithshëm i prokurorëve në sistem	Numri i prokurorëve pjesëmarrës në trajnime	Numri i prokurorëve të trajnuar
181	497	144

Tabela nr. 5 dhe 6: Gjyqtarët dhe prokurorët në trajnime

Pjesëmarrës tjerë në tranimet bashkë me gjyqtarë e prokurorë		
Kategoria përfituese	Nr. i pjesëmarrësve	Numri i të trajnuarve
Bashkëpunëtorë Profesional	227	156
Zyrtarë Ligjor	54	39
Staf administrativ nga Gjykata dhe Prokuroria	68	45
Mbrojtës të Viktimave	44	22
Avokat Shtetëror	22	6
KGJK-së	2	2
Zyrtar nga Banka Qendrore e Kosovës	2	2
Zyrtar nga Shërbimi Sprovues i Kosovës	7	7
Zyrtar Policor	243	196
Zyrtar nga Agjensioni për Ndihmë Juridike Falas	72	28
Zyrtar nga Agjencia për Parandalim të korrupsionit	1	1
Zyrtar nga Qendra për Punë Sociale	37	37

Ekspert nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë	3	2
Udhëheqës dhe Inspektor nga Inspektoriati Policor i Kosovës	4	2
Zyrtar nga Ministria e Drejtësisë	15	13
Zyrtar/Eksert/Infermier nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML)	8	8
Zyrtar nga Ministria e Punëve të Jashtme	1	1
Inspektor/Zyrtar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	14	10
Zyrtar nga Dogana e Kosovës	9	8
Zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme	12	12
Praktikant në Gjykatë	5	4
Zyrtar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës	3	3
Zyrtar nga Njësia e Inteligjencës Financiare	7	6
Zyrtar nga Administrata Tatimore e Kosovës	8	7
Praktikant në Prokurori	2	1
Avokat	45	44
Sekretar nga OAK	1	1
Përmbartues Privat	8	8
Ndërmjetësues	49	39
Drejtor nga Drejtoria për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale	1	1
OJQ "Terre des hommes"	1	1
Zyrtar i Lartë për Mbrojtjen e Fëmijës nga Komuna e Prishtinës	1	1
Udhëheqës i Divizionit për Punë Normative Juridike nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara	1	1
Gjyqtarë nga Shqipëria	9	9
Prokurorë nga Shqipëria	18	18
Totali	1004	741

Tabela nr. 7: Profesionistët e tjerë ligjor në trajnime bashkë me gjyqtarë dhe prokurorë

Bashkëpunëtorët Profesional dhe Zyrtarët Ligjor në trajnime gjatë 2023												
Numri i përgjithshëm i trajnimeve	Numri i pjesëmarrjes në trajnime	Numri i të trajnuarve	Numri i trajnimeve nga Moduli Bazik (civile dhe penale)		Numri i pjesëmarrjes në trajnime nga Moduli Bazik		Numri i trajnimeve tjera për Bashkëpunëtor profesional dhe Zyrtar Ligjor		Numri i pjesëmarrjes në trajnime tjera për Bashkëpunëtor profesional dhe Zyrtar Ligjor			
55	1169	276	51	55 ditë	1116	Bashkëpunëtor Profesional	622	4	8 ditë	53	Bashkëpunëtor Profesional	37
						Zyrtar Ligjor	443				Zyrtar Ligjor	10
						Staf administrativ i Gjykatave dhe Prokurorive	51				Staf administrativ i Gjykatave dhe Prokurorive	6

Tabela nr. 8: Trajnimet e bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor nga moduli bazik penal dhe civil

Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial në trajnime gjatë 2023			
Numri i përgjithshëm i trajnimeve	Numri i pjesëmarrjes në trajnime	Numri i të trajnuarve	Fusha
6	124	122	Penale
			Interdisciplinare

Tabela nr. 9: Trajnimet e stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Trajnimet për profesionet e lira gjatë 2023				
Numri i përgjithshëm i trajnimeve	Trajnime për avokat	Avokatë pjesëmarrës dhe të tranuar	Trajnime për ndërmjetësues	Ndërmejtësues pjesëmarrës dhe të trajnuar
8	4	27 pjesëm	4	28 pjesëm.
		27 të trajnuar		11 të trajnuar

Tabela nr. 10: Trajnimet për profesionet e lira

5.2.3 Bashkëpunimi dhe mbështetja e donatorëve në ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme

Në periudhën raportuese nuk ka munguar mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë. Veçanërisht në ofrimin e ekspertizës për trajnime specifike dhe në ngritjen e kapaciteteve të trajnuesve duke mos lenë asesi anash zhvillimin e metodologjisë bashkëkohore trajnuese.

Nga 218 aktivitete trajnuese vetëm 72 janë realizuar me buxhet të AD –se, ndërsa 146 aktivitete trajnuese janë financuar dhe mbështetet nga donatorët e ndryshëm. Pra më shumë se 67% e aktiviteteve trajnuese në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme janë financuar nga donatorët dhe projektet e ndryshme ndërsa 33% nga buxheti i AD-së.

Në tabelën në vijim pasqyrohet nr. i aktiviteteve trajnuese të realizuara si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me partnerë dhe donatorë.

	Numri i Aktiviteteve Trajnuese	Financuara nga AD	Financuara nga Donatorët	Numri i pjesëmarrësve ne aktivitete trajnuese
Gjyqtarë dhe prokurorë	140	52	88	Gjyqtarë 1474 Prokurorë 497 1971
Bashkëpunëtor profesional, zyrtar ligjore dhe te tjerë	55	17	38	1169
Stafi Administrativ gjyqësor dhe prokurorial	6	2	4	124
Menaxhim dhe Lidërsip	1		1	3
Trajnime për Gjyqtarët Porotë	1	1		87
Trajnim për Trajnues	7		7	97
Avokat	4		4	33
Ndërmjetësues	4		4	28
Profesionistë tjerë				1004
Totali	218	72	146	4516

Tabela nr.11: Aktivitetet trajnuese sipas financimit gjatë vitit 2023

Trajnimet e financuara nga AD dhe Donatorët e saj	
Akademia e Drejtësisë	52
Ambasada Franceze	2
Bashkimi Evropian - EUKOJUST	3
EULEX	15
GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit)	8
Humanitarian Law Center Kosovo	2
IPROCEEDS	1
IRZ (German Foundation for International Legal Cooperation)	2
Këshilli i Evropës - “Forcimi i veprimeve anti-trafikingu”	3
Këshilli i Evropës - CEPEJ (Komisioni Evropian për Efikasitet të Drejtësisë)	1
Këshilli i Evropës - PECK III	1
Këshilli i Evropës - PRO-FREX (Protecting Freedom of Expression and of the Media)	1
OSBE	4
OSBE & OPDAT	6
Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian	1
UNDP	2
UNDP/SAEK	4
UNHCR	3
USAID / Drejtësia Komerciale	7
US-DOJ/OPDAT	20
Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI)	2
Total	140

Tabela nr. 12: Numri i trajnimeve në bazë të financuesit

5.2.4 Aktivitetet sipas fushave

Në periudhën raportuese janë realizuar trajnime nga të gjitha fushat e së drejtës përfshirë atë civile, penale, drejtësinë për fëmijë (penale dhe civile), ekonomike-komerciale, administrative, kundërvajtje, KEDNJ, BE dhe ndërkombëtare, e drejta kushtetuese si dhe nga kompetenca nderdiciplinare.

Trajnimet sipas fushës-2023	Gjithsej trajnime	Gjithsej pjesëmarrës
Penale	64	1364
Civile	23	720
Drejtësia për Fëmijë - Civile	2	79
Drejtësia për Fëmijë - Penale	15	234
E drejtë e BE-së	1	22
Ekonomike	8	106
Interdiciplinare	5	82
KEDNJ	9	182
Kundërvajtje	4	55
Kushtetuese	2	25
Administrative	7	106
Totali	140	2975

Tabela nr.13:Trajnimet sipas fushave dhe pjesëmarrja

5.2.5 Zbatimi i trajnimeve të specializuara në drejtësinë penale

Trajnimet e specializuara kanë qenë pjesë integrale e programit trajnues dhe janë specifike meqë kanë trajtuar forma të veçanta të krimit të cilat ekskluzivisht janë kompetencë e departamentit special të Gjykatës dhe Prokurorisë Speciale ose edhe janë bërë si fenomen në shoqëri dhe luftimi i tyre është prioritet për drejtësinë kosovare. Gjithashtu janë programe që trajtojnë aspektet ligjore si dhe teknikat e zbatimit praktik nga procesi i identifikimit dhe hetimit deri te vendimet përfundimtare . Këto programe trajnuese përveq asaj që u theksua më lartë kanë adresuar edhe vështirësitë dhe problemet praktike të cilat janë identifikuar me rastin e vlerësimit të nevojave trajnuese dhe kanë qenë mandatorë në program edhe për shkak të kërkesave nga dokumentet strategjike të vendit.

Në kuadër të Programeve të Specializuara janë trajtuar temat si Krimi i organizuar dhe korrupsioni Pastrimi i parave dhe hetimi financiar, Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, Prokurimi publik, Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi, Krimi Kibernetik dhe kriptovalutat, Dhuna në familje dhe Hartimi i akteve akuzuese nga prokuroria Speciale dhe Krimet e Luftës.

Qëllimi i trajnimeve të specializuara ishte ngritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore lidhur me hetimin dhe gjykimin si dhe zgjidhjen meritore të rasteve në gjykata sa i përket veprave penale përkatëse.

Pjesëmarrja në trajnimet e specializuara

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2023, janë realizuar 9 trajnime të specializuara, me 18 sesione trajnimi, dhe me 39 dite trajnimi. Numri i pjesëmarrësve në këto trajnime ishte 351. Prej tyre 128 gjyqtarë, 128 prokuror, 30 Bashkëpunëtor Profesional, 8 Zyrtarë Ligjor, 41 Zyrtarë nga Policia e Kosovës, 1 Ekspert nga PSRK, 3 Zyrtarë të Shërbimit Sprovues, 4 nga Njësi për Inteligjencë Financiare, 3 Zyrtarë të Shërbimit Korrektues, 3 Zyrtarë nga Dogana, 1 nga Qendra për Punën Sociale dhe 1 Zyrtar i lartë për mbrojtje të fëmijëve.

Në vijim, detajet për trajnimet e specializuara duke përfshirë, numrin e trajnimeve, sesionet dhe përfituesit.

Program i Specializuar Trajnimi - Krimi i organizuar				
Pjesëmarrësit	Sesioni I	Sesioni II	Sesioni III	Totali
Gjyqtarë	8	4	15	27
Prokurorë	9	10	4	23
Bashkëpunëtor profesional	/	/	2	2
Zyrtar Ligjor	/	/	1	2
Totali				54

Program i Specializuar Trajnimi - Pastrimi i parave dhe hetimi financiar				
Pjesëmarrësit	Sesioni I	Sesioni II	Sesioni III	Totali
Gjyqtarë	7	4	13	24
Prokurorë	4	9	14	27
Policia e Kosovës	8	3	3	14

NIF ¹³	2	/	/	2
Bashkëpunëtor profesional	/	3	/	3
Totali				70

Program i Specializuar Trajnimi - Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare				
Pjesëmarrësit	Sesioni I	Sesioni II	Sesioni III	Totali
Gjyqtarë	17	14	2	33
Prokurorë	22	9	5	36
Bashkëpunëtor profesional	/	1	3	4
Policia e Kosovës	6	/	/	6
Totali				79

Program i Specializuar Trajnimi - Prokurimi publik		
Pjesëmarrësit	Sesioni I	Totali
Gjyqtarë	2	2
Prokurorë	10	10
Policia e Kosovës	11	11
Totali		23

Program i Specializuar Trajnimi - Ekstremizmi, radikalizmi dhe terrorizmi			
Pjesëmarrësit	Sesioni I	Sesioni II	Totali
Gjyqtarë	2	2	4
Prokurorë	1	/	1
Bashkëpunëtor profesional	/	4	4
Zyrtar Ligjor	/	1	1
Shërbimi Korrektues	3	/	3
Shërbimi Sprovues	3	/	3
Policia e Kosovës	/	5	5
NIF	/	2	2
Dogana	/	3	3
Totali			26

Program i Specializuar Trajnimi - Krimi kibernetik dhe kriptovaluta			
Pjesëmarrësit	Sesioni I	Sesioni III	Totali
Gjyqtarë	3	7	10
Prokurorë	2	3	5
Bashkëpunëtor profesional	/	3	3
Zyrtar Ligjor	/	1	1
Ekspert të PRSK	/	1	1
Totali			20

Program i Specializuar Trajnimi - Dhuna në familje		
Pjesëmarrësit	Sesioni I	Totali
Gjyqtarë	11	11
Prokurorë	7	7
Qendra për pune sociale	1	1
Zyrtar i larte për mbrojtje të fëmijëve	1	1
Totali		20

¹³ Njësia për Inteligjencë Financiare


Program i Specializuar Trajnimi - Hartimi i akteve akuzuese nga PSRK		
Pjesëmarrësit	Sesioni I	Totali
Gjyqtarë	5	5
Prokurorë	12	12
Totali		17

Program i Specializuar Trajnimi - Krimet e Luftës			
Pjesëmarrësit	Sesioni I	Sesioni II	Totali
Gjyqtarë	5	7	12
Prokurorë	3	4	7
Bashkëpunëtor profesional	5	9	14
Zyrtar Ligjor	2	2	4
Policia e Kosovës	5	/	5
Totali			42


Tabelat nr. 14: Trajnimet e specializuara dhe pjesëmarrja

5.2.6 Zbatimi i trajnime sipas kompetencës dhe kërkesave të gjyqtarëve dhe prokurorëve


Programi Trajnues i Akademisë së Drejtësisë ka ofruar trajnime dhe aktivitete tjera trajnuese për të gjitha kompetencat punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilat janë identifikuar si nevojë për unifikim dhe praktikë gjyqësore më të mirë si në aspektin procedural ashtu edhe material nga të gjitha fishat si dhe nga kompetenca interdisciplinare. Grafikonet në vijim përfshinë aktivitetet e realizuara sipas fushave, trajnimet e realizuara në baza mujore, numrit të pjesëmarrjes dhe kohëzgjatjes së trajnimeve.



Grafikoni nr. 10: Numri i trajnimeve të realizuara në PTV sipas fushave në vitin 2023



Grafikoni nr. 11: Numri i trajnimeve të realizuara në baza mujore



Grafikoni nr. 12: Trajnimet sipas kohëzgjatjes në PTV

5.2.7 Trajnimet e vazhdueshme nga lëmia penale (materiale dhe procedurale)

Drejtësia penale vazhdon të përballet me sfida në luftimin e formave të reja dhe të sofistikuara të kriminalitetit që kërkojnë përmirësim të legjislacionit, dhe njëherësh rritjen e kapaciteteve profesionale. Përveq trajnimeve të specializuara që janë theksuar në këtë raport janë realizuar edhe trajnime për risitë e Kodit të Procedurës penale si dhe trajnime tjera që kanë përfshirë praktikën gjyqësore në fushën penale të cilat janë realizuar në formë të trajnimeve, punëtorive dhe të tryezave. Janë gjithësejt 64 aktivitete trajnuese nga lëmia penale materiale dhe procedurale me 1364 pjesëmarrës.

5.2.8 Trajnimet e vazhdueshme nga lëmia civile (materiale dhe procedurale)

Në fushën civile janë realizuar 15 aktivitete trajnuese me gjithsej 519 pjesëmarrës. Trajnimet kanë qenë kryesisht për për praktikën gjyqësore, veçanërisht çështje nga e drejta pronësore, familjare, çështje nga drejta e detyrimeve, përmbartimore, kontestimore dhe jokontestimore. Temat e trajtuara gjatë periudhës raportuese ishin: Dëmshpërblimi, llojet e tij dhe praktika gjyqësore, Kontratat dhe anulimi i tyre, Procedura sipas lëndës në rivendosje, Bashkëndërgjyqësia, Sigurimi i kërkesëpadisë, Trajnim për praktikën gjyqësore në çështje familjare, në çështje pronësore, në çështje nga Procedura Përmbartimore, Trajnim për praktikën gjyqësore për mbrojtjen gjyqësore në kontestet e punës, sipas Ligjit të Punës, Trajnim për praktikën gjyqësore në çështje nga Procedura

Kontestimore dhe Jokontestimore, Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në fushën civile, Trajnim për praktikën gjyqësore për mbrojtjen gjyqësore në rastet e pengim posedimit dhe servituteve dhe Pasurimi pa bazë.

Disa nga trajnimet në fushën civile janë realizuar në formë të tryezave në ambient interaktiv të diskutimeve dhe ushtrimeve praktike dhe si të tilla shërbyen për ofrimin e praktikave më të mira, si të veprohet në të ardhmen për përmirësimin dhe kualitet të vendimmarrjes.

Qëllim i realizimit të aktiviteteve trajnuese ishte rritja edhe më tej e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve në zbatimin e drejtë të dispozitave lidhur me përcaktimin e kërkesave të dëmit material dhe jo material, nxerrjen e provave relevante lidhur me vërtetimin e bazës juridike, identifikimin e kushteve ligjore të cilat duhet plotësuar për t'u konsideruar një kontratë nule dhe e rrëzueshme, vlerësimin e roleve dhe efektet e veprimeve të bashkëndërgjyqësve në procedurë, dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore lidhur me pjesëmarrjen e personave të tretë në procedurë dhe adresimin e sfidave tjera të praktikës gjyqësore nga procedura kontestimore, jokontestimore dhe përmbarrimore.

5.2.9 Trajnimet nga fusha Komerciale

Në kuadër të drejtësisë komerciale janë realizuar nëntë (9) trajnime në të cilat kanë marrë pjesë 106 pjesëmarrës. Në këto trajnime janë trajtuar çështjet si në vijim: Implikimet në praktikë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Procedura përmbarrimore-lejimi i përmbarrimit, Arbitrazhi, Kuptimi i industrisë bankare, sigurimeve dhe institucioneve financiare, Njohuritë financiare, Zbatimi dhe specifikat e instrumenteve ndërkombëtare, Direktivave dhe Rregulloreve të UE-së mbi çështjet komerciale dhe doganore Kontrata për ndërtimin dhe Përmbledhje e specifikave të industrisë së TIK-ut licencimit dhe të drejtave të pronësisë.

Përmes trajnimeve në këtë fushë është synuar rritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale lidhur me çështjet ligjore që hyjnë në juridiksionin e kësaj gjykate dhe vendosjen drejtë dhe në mënyrë meritore të rasteve përkatëse.

5.2.10 Trajnimet nga E Drejta Kushtetuese

Në periudhën raportuese janë realizuar dy (2) trajnime nga lëmia e së drejtës kushtetuese me temë: Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave në lëmin civile dhe Praktika aktuale e Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave-ankesave në lëmin penale. Qëllimi i trajnimeve ishte ngritja e aftësisë profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve rreth procedurës së lejueshmërisë së kërkesave, raportit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me gjykatat e rregullta në kontekst të dispozitave kushtetuese, njohjes me praktiken aktuale të Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave-ankesave në lëmin penale dhe civile, si dhe të kuptojnë rolin e kontrollit incidental të kushtetutshmërisë.

5.2.11 Trajnimet nga fusha e kundërvajtjeve

Për rritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve të divizionit të kundërvajtjes janë realizuar katër (4) trajnime, ndërkaq kanë marrë pjesë 55 pjesëmarrës. Kurikula trajnuese në fushën e kundërvajtjes ishte e fokusuar kryesisht në zbatimin e akteve normative të cilat rregullojnë vepra të ndryshme kundërvajtëse me theks nga Ligji për pyjet, Ligji për mbrojtjen e natyrës dhe ambijentit, në shkathtësitë sa i përket hartimit dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore në procedurën e kundërvajtjes si dhe për aksidentet në trafik dhe personat juridik si kryes të kundërvajtjes.

5.2.12 Trajnimet për mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhunës ndaj Grave (aspekti penal dhe civil)

Vit 2023 karakterizohet me aktivitete të shumta në fushën e dhunës në familje. Përtej katër (4) aktiviteteve sipas programit trajnues me mbështetjen e partnerëve strategjik të Akademisë (ODAT, Këshilli i Evropës, EKOJUST, UNDP, EULEX) janë zhvilluar dhe realizuar vetëm për aspektin penal gjithësejt katërmëdhjetë (14) aktivitete trajnuese me temë: Program i Specializuar i Trajnimit Dhuna në familje, Akuzimi dhe dënimi i rasteve të dhunës në familje, Vlerësimi i Rrezikshmërisë në Rastet e Dhunës në Familje, Protokollin për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, Trajnim i avancuar për parandalimin e dhunës në familje-Konventa e Stambollit dhe për Viktimat e dhunës seksuale. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre trajnimeve kanë qenë regjionale dhe janë përsëritur me të vetmin qëllim që të përfshihen gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet duke përfshirë edhe profesionistë tjerë ligjor.

Aspekti civil i dhunës në familje është përfshirë në trajnimin: Program i Specializuar i Trajnimit për Dhunën në familje (shih kolonën paraprake) meqë ka qenë bashkëdyzim i aspektit penal dhe atij civil me theks te shkelja e urdhrin mbrojtës dhe dispozitat ligjore përkatëse, Konventa e Stambollit dhe Roli i Qendrës për punë sociale si dhe aspekte tjera me rëndësi në procedurën civile. Përveq kësaj janë realizuar edhe dy trajnime tjera një (1) trajnim i cili vazhdimisht vlerësohet i nevojshëm për gjyqtarët me temë: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje e cila ka trajtuar çështjet ligjore relevante dhe praktikën gjyqësore në këtë fushë përmes interpretimit të dispozitave ligjore dhe legjislacionit në fuqi si dhe një (1) trajnim për praktikën gjyqësore në çështje familjare.

5.2.13 Trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe BE-së

Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2023 ka realizuar nëntë (9) trajnime në të cilat kanë marrë pjesë 182 pjesëmarrës.. Këto aktivitete kishin qëllim avancimin e njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor për Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe efektet e saj në sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë trajtuar temat si: E drejta në privatësi dhe e drejta në jetë familjare,– neni 8 KEDNJ-së, dy trajnime për Mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve, E drejta në gëzimin paqësor të pronës- Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr 1. I KEDNJ,

E drejta për liri dhe siguri-zbatimi i nenit 5 të KEDNJ-së dhe roli i Gjykatës Supreme të Kosovës, Aspekti material dhe procedural i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe sfidat në zbatimin e tij, E drejta për një proces të rregullt gjyqësor-KEDNJ dhe praktika gjyqësore-Aspekti penalo juridik, KEDNJ-së si dhe korniza ligjore nacionale në rastet e diskriminimit dhe raporti me ligjet e tjera me theks në Ligjin e Punës dhe Ligjin e Procedurës Kontestimore dhe Zbatimi i Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike.

Në periudhën raportuese janë realizuar 2 trajnime për të drejtën e BE-së të cilat janë në fushën komerciale dhe të culat janë paraqitur më lartë por që trajtohen edhe nga perspektiva e BE-së. Trajnimi i parë ishte me theks te “Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore dhe atyre të arbitrazhit” si dhe trajnimi tjetër si “Zbatimi dhe specifikat e instrumenteve ndërkombëtare, Direktivave dhe Rregulloreve të UE-së mbi çështjet komerciale dhe doganore” Këto trajnime i vijuan 27 pjesëmarrës, kryesisht gjyqtarë dhe bashkëpunëtorë profesional nga Gjykata Komerciale.

5.2.14 Trajnimet nga fusha e ndërmjetësimit

Në periudhën raportuese janë realizuar gjashtë (6) trajnime për ndërmjetësimin të cilat kanë qenë regjionale. Trajnimet i janë dedkuar gjyqtarëve dhe prokurorëve nga të gjitha regjionet në të cilat kanë marrë pjesë 164 pjesëmarrës duke përfshirë edhe ndërmjetësues.

Qëllimi I këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive për procedurën e ndërmjetësimit që nga momenti i referimit të lëndës në ndërmjetësim, procedurën e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit si dhe sqarimi lidhur me ndërmjetësimin e detyrueshëm.

5.2.15 Tryezat dhe trajnimet nga Drejtësia për fëmijë – aspekti civil dhe penal

Në fushën e drejtësisë për fëmijë janë realizuar shtatëmbëdhjetë (17) trajnime me gjithësejt 313 pjesëmarrës.

Në aspektin civil janë trajtuar tema si: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre dhe Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e shkurorëzimit dhe në rastet e dhunës në familje.

Në aspektin penal janë trajtuar tema si Harmonizimi i ndryshimeve të reja të Kodit të Procedurës Penale me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, Aplikimi i masave të diversitetit, sfidat dhe pengesat në implementim, Vërejtja policore, procedura dhe shabllonet, trajtimi i rasteve nga Policia, Veprat penale kundër integritetit seksual të fëmijëve, Masat dhe dënimet që shqiptohen ndaj të miturve, Sfidat në identifikim/hetim të trafikimit me njerëz në mesin e fëmijëve në situatë e rruge, Hetimi i trafikimit të fëmijëve me fokus te fëmijët në situatë rrugë, Marrja në pyetje e viktimës së mitur si dhe trajnimet Qasje multi-institucionale ndaj Dhunës Gjinore, me theks të veçantë në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve - Regjioni i Prishtinës, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjiilan, Gjakovë, Ferizaj.

Qëllim i këtyre aktiviteteve trajnuese ishte ngritja e aftësive dhe shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për zbatimin e drejtë të legjislacionit ë fuqi dhe vendosjen meritorë të rasteve në gjykata.

5.2.16 Trajnimet dhe tryezat nga fusha Administrative

Në fushën administrative janë realizuar shtatë (7) aktivitete trajnuese për gjyqtarët e departamentit administrativ, në të cilat kanë marrë pjesë 106 pjesëmarrës. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë trajtuar aspekte të rëndësishme si: Procedura gjyqësore me rastin e gjykimit me merita në procedurën e konfliktit administrativ, Kontestet e punës lidhur me statusin e nëpunësve civil sipas Ligjit për zyrtarët publik, E Drejta e Azilit sipas legjislacionit vendor dhe atij ndërkombëtare, Trajnim për praktikën gjyqësore në çështje administrative, Legjislacioni vendor lidhur me statusin e të huajve dhe atij ndërkombëtarë, Shtetësia dhe statusi i personave pa shtetësi-sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtarë, Procedura dhe zbatimi i Ligjit për regjistrimin civil në Kosovë.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte rritja edhe më tej e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve në interpretimin dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore për procedurën administrative dhe procedurën e konfliktit administrativ; rëndësinë e Konventës për te drejtat e refugjateve dhe personave pa shtetësi si dhe për kategoritë e nëpunësve civil që gjykohen në procedurën e konfliktit administrativ dhe ata që gjykohen në procedurën kontestimore sipas Ligjit për zyrtarët publik.

5.2.17 Zbatimi i trajnimeve interdisciplinare për gjyqtarë dhe prokurorë

Në kuadër të kompetencës interdisciplinare janë realizuar pesë (5) trajnime me 82 pjesëmarrës. Në kuadër të këtyre trajnimeve janë trajtuar çështje me rëndësi nga arsyetimi gjyqësor dhe të drejtat e njeriut, shkathtësitë të përfaqësimit në gjykim, Kodi i Etikës dhe sjelljes profesionale të prokurorëve, shkathtësitë e komunikimit jo-verbal si dhe përmirësimi i efikasitetit të gjykatave në bazë të Instrumenteve dhe indikatorëve të CEPEJ-it për performancë duke i përdorur raportet statistikore të SMIL dhe tabelat.

Trajnimet kishin për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në drejtim të avancimit dhe zotërimit të shkathtësive në shkrim dhe argumentim të vendimeve gjyqësore, ngritjen e shkathtësive praktike rreth teknikave të përfaqësimit gjatë gjykimit, si dhe avancimin e shkathtësitë te komunikimit jo-verbal.

5.2.18 Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes trajnimeve dhe tryezave në fushën penale

Unifikimi i praktikës gjyqësore vazhdon të jetë prioriteti thelbësor i sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Këtë e kanë konfirmuar Kolegjiomet e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit dhe jo vetëm. Prandaj, Programi trajnues i AD-së ka mundur adresimin e praktikës gjyqësore jo unike përmes tryezave nga lëmia civile dhe ajo penale si forma më e duhur për diskutimin dhe gjetjen e praktikave më të

mira unifikuese. Tryezat kanë shërbyer si bazë e mirë e ofrimit të njohurive për gjyqtaret dhe prokurorët pjesëmarrës lidhur me praktikën e konsoliduar për çështje procedurale.

Gjatë vitit 2023, janë realizuar tri (3) aktivitete trajnuese në formë të tryezave, dy prej të cilave kanë qenë në çështje civile dhe një në penale. Në tryezat në çështje civile kanë marrë pjesë gjithësejt 37 gjyqtarë, ndërkaq në penale 13 gjyqtarë të cilat ishin kryesisht me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit. Nga këto tryeza kanë rezultuar konkluzionet për unifikim të praktikës gjyqësore në çështje penale dhe civile të clat tashmë janë publikuar në portalin e AD-së dhe Gjykatës së Apelit dhe si të tilla janë të qasshme për gjithë gjyqtarët dhe komunitetin tjetër ligjor.

5.2.19 Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme për Risitë e Kodit të Procedurës Penale dhe sipas vlerësimit të performancës

Në kuadër të Programit për trajnime të vazhdueshme janë realizuar gjashtë (6) trajnime, me kohëzgjatje 12 ditore për Risitë e Kodit të Procedurës Penale. Në këto trajnime kane marrë 166 pjesëmarrës prej tyre gjyqtarë, prokurorë dhe avokat dhe bashkëpunëtor profesional. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte përgatitja dhe avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në zbatim të Kodit të ri të Procedurës Penale.

Në kuadër të këtyre trajnimeve janë trajtuar: Masat e veçanta hetimore, Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, Marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake, Seanca për caktimin e dënimit, Mbrojtja e detyruar, mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimë, Hedhja e kallëzimit penal, e drejta për të apeluar aktvendimin, njohja e dëshmitareve, Hetimi, afati i hetimeve, pushimi dhe rihapja e hetimeve, Qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit, Shqyrtimi i dytë, aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor, Sekuestrimi dhe konfiskimi, Gjykimi në mungesë Standardi i rishikimit të ankesave (shkeljet substanciale, ndryshimi i aktgjykimit nga Gjykata e Apelit dhe rigjykimi). Këto trajnime janë realizuar nëpër regjione dhe janë mbështetë nga OPDAT.

Me kërkesën e KPK-së gjatë vitit 2023, është realizuar edhe një (1) trajnim i detyrueshëm për një prokuror të shtetit si rezultat i vlerësimit të performancës. Në pajtim me Protokollin për Trajnime të Detyrueshme për prokurorë me performacë jo të mirë dhe vendimit të KPK-së, Akademia ka realizuar trajnimin pesë (5) ditor për prokurorin përkatës në modulet: Etika dhe integriteti, Njohurit dhe arsyetimi ligjor, Menaxhimi i rasteve si dhe Komunikimi dhe avokimi. Metodologjia trajnuese dhe vlerësimi janë zbatuar në harmoni me Protokollin për trajnime të detyrueshme. Pas përfundimit të trajnimit të detyrueshëm është hartuar raport i përfundimtar me rezultatet për Këshillin Prokurorial të Kosovës, respektivisht, Komisionin për Vlerësimin e Performancës.

5.2.20 Trajnimi i anëtarëve të Komisioneve për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve

Në periudhën raportuese në bashkëpunim me Iniciativën e Chemonics për Sundim të Ligjit në Ballkanin Perëndimor (WBROLI), financuar nga Mbretëria e Bashkuar është realizuar trajnimi dy ditor për anëtarët e Komisioneve të KGJK-së dhe KPK-së të cilët kanë mandatin për vlerësimin e

performances së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjatë këtij trajnimi janë trajtuar aspekte të rëndësishme të punës së këtyre komisioneve duke përfshirë indikatorët matës dhe problemet praktike në zbatim të rregulloreve për vlerësim të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Trajnimi vuri në pah edhe nevojën për ndryshime legjislative të cilat do të mundësonin vlerësimin më efektiv dhe real të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Përveq anëtarëve të Komisioneve për vlerësimin e performancës, këtë trajnim e vijuan edhe Kryesuesi i KGJK-së dhe KPK-së, Kryetari i Gjykatës Supreme, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, Kryetarë të Gjykatave dhe Kryeprokurorë, Gjyqtarë nga Gjykata Supreme, Inspektorë të lartë Gjyqësorë, zyrtarë të statistikave, anëtarë të Komisioneve të përhershme në KPK, Udhëheqës të Departamenteve të Trajnimeve dhe të IT, si dhe zyrtarë ligjorë.

5.2.21 Trajnuesit e angazhuar për zbatim të PTV-së gjatë vitit 2023

Për zbatimin e aktiviteteve trajnuese të planifikuara sipas Programit Trajnues dhe atyre të përfshira Ad hoc në kalendarin trajnues, gjatë 2023 janë angazhuar një numër i konsiderueshëm i trajnuesve. Për detaje shih tabelën me poshtë:

Trajnuesit e angazhuar për zbatim të PTV gjatë 2023	
TRAJNUESIT NGA RADHËT E SISTEMI GJYQËSOR	
Gjykata Kushtetuese	1
Gjykata Supreme	7
KGJK	2
Gjykata e Apelit	15
Gjykata Komerciale	1
Gjykatat Themelore	6
TRAJNUESIT NGA RADHËT E SISTEMIT PROKURORIAL	
ZKPSH	4
KPK	1
Prokuroria e Apelit	3
PSRK	4
Prokuroria Themelore	7
TRAJNUES TË TJERË	
Profesor Universitar	6
Nga institucionet jo gjyqësore	19
Profesione te lira	6
Donatorë	63
TOTALI	145

Tabela nr.15: Trajnuesit e angazhuar për zbatim të PTV gjatë 2023

5.2.22 Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorë profesional dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional

Në pajtim me prioritetet e sistemit gjyqësor dhe prokurorial ngritja e kapaciteteve profesionale e bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive është vazhduar

edhe më tej. Në këtë kuadër janë realizuar 55 trajnime për këtë kategori me kohëzgjatje 63 ditë trajnimi. Prej tyre 51 nga moduli i trajnimit bazik-aspekti penal dhe aspekti civil material dhe procedural dhe 4 tjera poashtu nga fusha penale dhe komerciale. Këto trajnime i kanë vijuar përveq bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive edhe zyrtarë tjerë. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve ishte 1169. Numri i pjesëmarrjes në trajnimet nga Moduli bazik (penale dhe civile) ishte 1116, prej tyre 622 Bashkëpunëtorë Profesional, 443 Zyrtar Ligjor, 51 Staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Pjesëmarrja në trajnimet tjera të realizuar për Bashkëpunëtorë Profesional ishte 53 prej tyre 37 Bashkëpunëtorë Profesional, 10 Zyrtar Ligjor, 6 Staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Në vijim tabelat me detajet:

Trajnimet për Bashkëpunëtorë Profesional & Zyrtar Ligjor			
Moduli Bazik për Bashkëpunëtorë Profesional & Zyrtarë Ligjor		Trajnime tjera për Bashkëpunëtorë Profesional & Zyrtarë Ligjor	
Trajnime të realizuara	51	Trajnime të realizuara	4
Bashkëpunëtorë Profesional	622	Bashkëpunëtorë Profesional	37
Zyrtar Ligjor	443	Zyrtar Ligjor	10
Stafi administrativ i Gjykatave dhe Prokurorive	51	Staf administrativ i Gjykatave dhe Prokurorive	6
Total	1116	Total	53

Tabela nr. 16: Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional

Trajnimet e financuara nga donatorët	Totali	Gjithsej pjesëmarrës
Akademia e Drejtësisë	17	398
US-DOJ/OPDAT	1	29
SAEK/UNDP	33	689
Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI)	3	47
USAID/Drejtësia Komerciale	1	6
Totali	55	1169

Tabela nr. 17: Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe në bazë të financuesit

Trajnimet për stafin tjetër administrativ të gjykatave dhe prokurorive

Përveq trajnimeve për bashkëpunëtorë profesional, Akademia e Drejtësisë është angazhuar në zbatimin e trajnimeve edhe për stafin tjetër administrativ. Në periudhën raportuese janë realizuar gjithësejt gjashtë (6) trajnime me 7 ditë trajnimi përmes të cilave është synuar ngritja e vazhdueshme profesionale dhe rritja e efikasitetit të punës në gjykata dhe prokurori. Programi trajnues për këto kategori ka ofruar module trajnuese që ka adresuar aspekte të rëndësishme të punës së stafit duke filluar nga menaxhimi i punës dhe dosjeve, komunikimi, përdorimi i SMIL dhe aspekte tjera të punës sipas funksioneve përkatëse. Këto trajnime i kanë vijuar bashkëpunëtorët profesional, zyrtarë të lartë ligjor, referentë, administratorë, zyrtarë për informim dhe profile tjera.

Në vijim tabelat me detajet:

Përfituesit nga trajnimet për stafin administrativ	Pjesëmarrja në trajnime
--	-------------------------

Bashkëpunëtorë profesional	23
Zyrtar i lartë ligjor & Zyrtar ligjor	28
Referent i lartë & Referent	8
Administrator & Ndihmës Administrator	5
Mbrojtës të viktimave	1
Staf tjetër administrativ nga Gjykata dhe Prokuroria	59
Totali	124

Trajnimet sipas financuesit	Trajnime
Akademia e Drejtësisë	2
EKOJUST	2
EULEX	1
Këshilli i Evropës - CEPEJ (Komisioni Evropian për Efikasitet të Drejtësisë)	1
Totali	6

Tabela nr. 18: Trajnimet për stafin tjetër administrativ të gjykatave dhe prokurorive dhe në bazë të financuesit

5.2.23 Ngritja e kapaciteteve profesionale të profesioneve të lira

Në periudhën raportuese, profesionistët nga radhët e profesioneve të lira iu është mundësuar të marrin pjesë në trajnimet që janë me interes sipas programit të trajnimit të vazhdueshëm. Si rezultat i kësaj kanë marrë pjesë edhe në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë por edhe në trajnime të veçanta dedikuar kategorive përkatëse. Në këto trajnime kanë marrë pjesë avokatë shtetëror, përmbarues, ndërmjetësues, zyrtarë të ndihmës juridike falas, mbrojtës të viktimave dhe profesionistë tjerë ligjor varësisht prej çështjeve ligjore që ishin objekt i trajtimit dhe ndërlidhjes së punës së tyre me çështjet përkatëse.

Ndërkaq janë realizuar edhe trajnime dedikuar ekskluzivisht ndërmjetësuesve. Për këtë kategori janë realizuar 4 trajnime në të cilat është trajtuar ndërmjetësimi në fushën penale, pronesore, familjare dhe komerciale. Gjithashtu dy trajnime për trajnues¹⁴ në fushën e ndërmjetësimit të cilat kishin në fokus rritjen e kapaciteteve trajnuese në këtë fushë.

Përveq trajnimeve për ndërmjetësues janë realizuar edhe 4 trajnime për avokat me temë: Trajnim i avancuar për parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave sipas Konventës së Stambollit dhe KEDNJ-së me çrast kanë marrë pjesë dhe janë trajnuar 27 avokatë.

Në tabelën në vijim pasqyrohen detaje sa i përket pjesëmarrjes në trajnime nga profesionet e lira:

Pjesëmarrja e profesioneve të lira dhe profesionisteve tjerë ligjor në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë	
Avokatë shtetëror	22
Avokat	75

¹⁴ Detajet në vijim të këtij raporti me titull Avancimi i metodologjisë trajnuese sipas standardeve dhe metodave bashkëkohore-trajnimet për trajnues

Përmbaues privat	8
Ndërmjetësues	48
Zyrtarë të ndihmës juridike falas	74
Mbrojtësit e viktimave	45
Zyrtarë nga shërbimi Sprovues	7
Zyrtarë nga shërbimi Korrekues	3
Zyrtarë nga Qendra për punë Sociale	37
Zyrtarë nga Njësia e Intelegjencës Financiare	7
Zyrtarë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore	8
Zyrtarë policor	244
Profesionistë tjerë ¹⁵	109
Gjithsej pjesëmarrës	687

Tabela nr. 19: Profesioneve të lira dhe të tjerë në trajnime të përbashkëta me gjyqtare dhe prokurorë

Trajnimet për Ndërmjetësues	
Trajnime të realizuara	4
Ditë trajnimi	4
Gjithsej pjesëmarrës	28
Meshkuj	20
Femra	6
Shqiptarë	26

Tabela nr. 20: Ndërmjetësuesit në trajnimet e AD-së

Trajnimet për avokatë	
Trajnime të realizuara	4
Ditë trajnimi	4
Gjithsej pjesëmarrës	27
Meshkuj	
Femra	
Shqiptarë	

Tabela nr. 21: Avokatët në trajnimet e AD-së

5.2.24 Avancimi i metodologjisë trajnuese sipas standardeve dhe metodave bashkëkohore-trajnimet për trajnues

Edhe gjatë vitit 2023, AD është kujdesur për rritjen e shkathtësive dhe metodologjisë trajnuese për trajnuesit e saj si dhe për të interesuarit tjerë që dëshirojnë të shërbejnë si trajnues. Në programet për trajnim të trajnuesve i'u ka mundësuar të gjithë të interesuarve në kuadër të sistemit gjyqësorë dhe prokurorial përmes shpalljes dhe njoftimeve në të gjitha faqet zyrtare të AD-së dhe në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë.


Për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të trajnimit, të gjitha trajnimet e trajnuesve gjatë vitit 2023 janë zhvilluar në bashkëpunim me donatorët e AD-së të cilët përveç mbështetjes teknike, kanë

¹⁵ Zyrtarë nga Administrata tatimore, Agjencia për forenzike, Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Prandalim të Korrupsionit dhe institucione tjer relevante

ofruar edhe ekspert dhe trajnues ndërkombëtar, të cilët me përvojën dhe njohuritë e tyre ishin një aset i çmuar për trajnuesit vendorë të AD-së.

Në periudhën raportuese janë realizuar shtatë (7) trajnime të trajnuesve, shumica me sesione të vazhdueshme trajnimi si në vijim:

- Dy (2) Trajtime të Trajnuesve 3 ditore me temë: Gjykimi i rasteve të Korrupsionit publik. Ky trajnim ishte rezultat i bashkëpunimit me CEELI Institute dhe organizatën joqeveritare Lëvizja FOL. Përfitues të trajnimit ishin Gjyqtarë nga Gjykata e Apelit dhe Themelore, kryesisht nga Departamenti Special, me ç'rast ka rezultuar edhe me zhvillimin e metodologjisë dhe kurrikulës trajnuese nga gjithë pjesëmarrësit në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë.
- Një (1) Trajnim i Trajnuesve me një sesion 2 ditorë në fushën e Arsytimit dhe Shkrimit Ligjor sipas metodologjisë së Këshillit të Evropës. Ky trajnim ishte në bashkëpunim me projektin e Këshillit të Evropës, “Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve evropiane për të drejtat e njeriut”. Përfitues të trajnimit ishin Gjyqtarë dhe prokurorë nga niveli Themelor dhe i Apelit si dhe Gjyqtarë nga Gjykata Supreme. Gjithashtu përfitues të trajnimit ishin edhe avokatë të rekomanduar sipas Odës së Avokatëve.
- Një (1) Trajnim i Trajnuesve me një sesion 2 ditor rreth Metodologjisë HELP në bashkëpunim me projektin e Këshillit të Evropës, “Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe shpërndarjen e standardeve evropiane për të drejtat e njeriut”. Përfitues të trajnimit ishin Avokatë, Gjyqtarë, Prokurorë, Përmbaues të cilët patën rastin të zhvillojnë kapacitetet e tyre trajnuese rreth metodologjisë HELP dhe mënyrave të zhvillimit të kurseve online në këtë platformë.
- Dy (2) Trajtime të Trajnuesve me 2 sesione të ndryshme trajnimi (3 ditore dhe 2 ditore secila) në fushën e Ndërmjetësimit. Ky proces ka filluar që në Mars të vitit 2022, me rekrutimin e 15 ndërmjetësuesve të cilët janë pjesë e Programit për ToT, që AD është duke e zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Federal të Ndërmjetësimit dhe Pajtitimit (FMCS) të SHBA-së, të mbështetur dhe të financuar nga Zyra për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL) pranë Ambasadës së SHBA-së. Si rezultat i këtij procesi, përfundimisht në maj 2023 janë certifikuar 13 ndërmjetësues si trajnues.
- Një (1) Trajnim për certifikimin e Trajnuesve të Akademisë së Drejtësisë. Ky trajnim ishte në bashkëpunim dhe mbështetjen e Ambasadës Amerikane- programi i OPDAT. Përmes të këtij trajnimi pjesëmarrësit patën rastin të fuqizojnë njohuritë e tyre rreth teorive të mësimdhënies për të rritur, dizajnimin e trajnimeve si dhe aftësitë e tyre ligjëruese. Në fund të këtij trajnimi u certifikuan edhe 24 gjyqtarë, prokurorë të cilët përfunduan me sukses Trajnimin e Trajnuesve sipas Metodologjisë trajnuese të AD-së.



Grafikoni nr. 13: Trajnimet për Trajnues sipas temave dhe pjesëmarrjes

5.2.25. Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë

Mësimi në distancë është alternativë për marrjen e informacionit për çështjet ligjore që ofrojnë kurset përmes platformës online.

Në periudhën raportuese janë përkthyer në gjuhën shqipe 18 kurse trajnuese në platformën Help të cilat pritet të jenë aktive në vijim, ndërkaq në platformën MOODLE janë integruar materialet trajnuese për Hetimin financiar dhe rikuperimin e aseteve. Lidhur me këtë fushë në bashkëpunim me UNDP/SAEK dhe janë zhvilluar dy sesione trajnuese dhe Platforma MOODLE ka shërbyer si data bazë për pjesëmarrësit dhe trajnuesit në vendosjen e materialeve të trajnimit si dhe ushtrimet praktike.

Gjithashtu AD, me qëllim të zhvillimit të kuadrit të trajnuesve, gjatë vitit 2023 ka organizuar edhe një Trajnim të Trajnuesve rreth Metodologjisë HELP, e cila do ju shërbejë në zhvillimin e kurseve trajnuese në të ardhmen në platformën moodle.

6. RITJA E CILËSISË SË PROGRAMEVE TRAJNUESE, KAPACITETEVE ANALITIKE DHE HULUMTUESE SI DHE VEPRIMTARISË BOTUESE -PROGRAMI PËR HULUMTIME DHE PUBLIKIME

Programi për Hulumtime dhe Publikime ka për qëllim zhvillimin profesional të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial dhe profesionistëve tjerë ligjor përmes zhvillimit të programeve trajnuese përshtatshëmrisht me nevojat trajnuese si dhe krijimit dhe ofrimit të burimeve të nevojshme juridike përmes analizave, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese.

Në periudhën raportuese, aktivitetet e këtij programi kanë qenë të fokusuar në përgatitjen e raporteve të punës dhe dokumenteve tjera të rëndësishme gjatë vitit të cilat prezantojnë punën dhe

angazhimet e AD-së, në krijimin dhe zhvillimin e burimeve të reja juridike, përkatësisht doracakëve dhe praktikës gjyqësore, përditësimin e bibliotekës elektronike, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore në përgatitje të raporteve të ndryshme qoftë për KGJK dhe KPK ose edhe për institucione dhe për mekanizmat tjerë integrues.

Gjatë vitit 2022 në kuadër të PHP-së janë zhvilluar aktivitete në drejtim të:

- Analizimit të nevojave trajnuese për përcaktimin e kurrikulës trajnuese dhe Planit të Punës dhe të Performancës së AD-së për vitin 2024
- Veprimtarisë botuese për nevoja të zbatimit të programeve trajnuese si dhe për nevoja të sistemit gjyqësor dhe propkurorial;
- Ofrimit të burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së;
- Përgatitja e raporteve në zbatim të masave dhe politikave euro integruese;
- Hartimit dhe publikimit të buletinit informativ në baza mujore;
- Koordinimit me kompaninë kontraktuese për furnizimin me materialet e nevojshme për shtyp dhe shërbime të dizajnit për AD-në si dhe
- Përditësimi i të dhënave statistikore me aktivitetet e realizuara gjatë vitit në kuadër të programeve trajnuese të AD-së dhe zhvillimi i data bazës së re

6.1. Analiza e nevojave trajnuese për përcaktimin e kurrikulës trajnuese dhe Planit të Punës dhe të Performancës së AD-së për vitin 2024

Analiza e nevojave trajnuese është një proces me rëndësi tejet të veçantë për Akademinë e Drejtësisë meqë i paraprinë hartimit të programit trajnues vjetor. Edhe këtë vit të gjitha rezultatet nga mekanizmat për vlerësim të nevojave trajnuese janë përpunuar, krahasuar dhe janë konfirmuar me akterët kryesor të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Shqyrtimi i masave nga Strategjia për sundimin e Ligjit 2021-2026, Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave 2022-2026 si dhe nga Programi Kombëtarë për të Drejtat e Njeriut 2021-2025 dhe vendosja e prioriteteve sipas mundësive dhe kapaciteteve të AD-së ka qenë thelbësore në këtë proces meqë këto strategji janë obligative për të gjitha institucionet e vendit.

Me rëndësi të veçantë ishte edhe mbledhja e të dhënave nga anketat vlerësuese, propozimet nga vizitat dhe takimet në KGJK dhe KPK, gjykata dhe prokurori të mbajtura gjatë gjithë vitit, propozimet nga takimet e përditshme me trajnuesit me rastin e zbatimit të programeve trajnuese. Veçanërisht thelbësore kanë qenë rezultatet nga punëtorja për vlerësimin e nevojave trajnuese dhe raporti analizë i nevojave trajnuese i Komisionit për trajnime në KGJK. Rol të rëndësishëm në këtë proces kishte edhe perspektiva e shoqërisë civile dhe mediave të shkruara dhe elektronike për sistemin e drejtësisë.

Gjetjet nga të gjithë mekanizmat e lartpërmendur dhe përgatitja e draftit përmbledhës me raportin analizë të vlerësimit të nevojave trajnuese për Këshillin Programor të AD-së dhe më pas për Këshillin Drejtues ishte aktiviteti i fundit në këtë proces në kuadër të këtij programi.

6.2 Zhvillimi i veprimtarisë botuese

Komponentë e rëndësishme e PHP-së janë veprimtaria botuese dhe botimet e saj. Për fushën e botimeve është punuar ngushtë me kompanitë kontraktuese të AD-së për shtyp dhe dizajn dhe është monitoruar procesi deri në finalizimin e tyre.

Në periudhën raportuese deri në qershor ka qenë në zbatim kontrata me ARF me nr. të aktivitetit të prokurimit: UA/2016-22-1907-1-2-1. Vlera totale e kontratës ishte 19,488.80€. Një pjesë e konsiderueshme e mjeteve janë shpenzuar para vitit 2023 ndërkaq nga janari - qershor 2023 në përfundim të kësaj kontrate janë realizuar 6 botime, vlera e të cilave ishte 763.9€. Pas nënshkrimit të kontratës së re nga Autoriteti Kontraktues – AQP me 31.08.2023 që është operatori i njejtë, përkatësisht ARF SH.P.K dhe AD me numër të prokurimit: UA/2016-23-7230-1-2-1/C370, vlera e të cilit 22,666.00€ janë realizuar edhe tri botime, vlera e të cilave ishte 4,466.86€.

Në funksion të zbatimit të Programit të Trajnimit Fillestar për 29 gjyqtarët dhe 21 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së X, janë realizuar modulet si në vijim:

- Moduli: Kodi Penal;
- Moduli: Kodi i Procedurës Penale;
- Moduli: Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar;
- Moduli: Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese;
- Moduli: Shkathtësitë personale dhe ndër personale;
- Moduli: E drejta civile administrative dhe ekonomike;
- PTF për prokurorët e sapo emëruar.

Në funksion të përmirësimit dhe unifikimit të praktikës gjyqësore në bashkëpunim me Gjykatën Supreme të Kosovës janë krijuar dhe botuar dy përmbledhje të praktikës gjyqësore si në vijim:

- Përmbledhje nga Praktika e Gjykatës Supreme në çështje penale dhe civile si dhe
- Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme

Botimi - Përmbledhja nga Praktika e Gjykatës Supreme në çështje penale dhe civile është mbështetur nga projekti Western Balkans Rule of Law Initiative (WBROLI) Chemonics. Përmbajtja e këtij botimi është shumë e çmueshme për gjyqtarët dhe komunitetin tjetër ligjor meqë përmban praktikën gjyqësore të lëndëve të kthyer në rigjykim dhe të ndryshuara me udhëzimet se si të veprohet në situatat e ngjashme duke respektuar dhe aplikuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore dhe njëherit duke marrë për bazë edhe praktikën dhe standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Përmes këtij botimi synohet zvogëlimi i lëndëve që kthehen në rigjykim ose ndryshohen nga kjo gjykatë.

Botimi - Vendimet e përzgjedhura nga Gjykata Supreme sikurse në emërtim përmban vendimet të përzgjedhura në çështje penale dhe civile dhe shërben si një udhërrëfyes me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore në gjykatat e instancave më të ulëta.

Në kuadër të publikimeve është vazhduar edhe përgatitja dhe publikimi i Buletinit informativ të AD-së me qëllim të njoftimit të të gjitha aktiviteteve të realizuara në baza mujore.

Në fushën e publikimeve janë realizuar buletinet në baza mujore si dhe janë zhvilluar dhe publikuar konkluzionet për unifikim të praktikës gjyqësore të cilat janë rezultat i tryezave për praktikën gjyqësore në çështje penale dhe civile.

Për nevoja të funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së AD-së janë krijuar dhe zhvilluar dokumentet si në vijim:

- Raporti vjetor i AD-së për vitin 2022
- Programi i Trajnimit për vitin 2024
- Plani i punës dhe i performancës për vitin 2024 i AD-së
- Plani Strategjik i AD-së për vitin 2023-2025.

E veçantë e këtij viti si rezultat i kërkesës ligjore është hartuar edhe Plani i Integritetit të AD-së për periudhën 2024-2026 i cili është miratuar nga Këshilli Drejtues i AD-së me 29 dhjetor 2023.

Ndryshe nga dokumentet e lartëtheksuara në mbështetje të ekspertizës nga Departamenti Amerikan i Drejtësisë-Qendra Kombëtare e Avokimit, është zhvilluar Doracaku për trajnues i cili synon të adresoj teknikat e prezantimit, metodologjinë, strukturën dhe detajet tjera të rëndësishme duke përfshirë edhe rolin aktiv të trajnuesve në procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese në mënyrë që trajnuesit dhe njëherësh trajnimi të jetë efektiv, përmbajtësor dhe i suksesshëm.

6.3 Pasurimi i mëtejshëm i bibliotekës elektronike, analiza e bazës së të dhënave dhe ofrimi i burimeve ligjore sipas kërkesave të përfituesve të AD-së

Në periudhën raportuese janë ofruar shërbime për qasje të materialeve ligjore që gjenden në data bazën e bibliotekës elektronike të AD-së. Kërkesat për materiale ligjore edhe për vitin 2023 kanë qenë kryesisht në kategorinë e komentareve ligjor dhe doracakëve dhe kjo më tepër nga praktikantët, studentët dhe bashkëpunëtorët profesional e më pak nga gjyqtarët dhe prokurorët, meqenëse siq edhe është raportuar më parë ata janë pajisur me formatet fizike shumë kohë më parë. Një pjesë e konsiderueshme e materialeve ligjore elektronike janë të publikuara edhe në faqen e AD-së dhe qasja në këto dokumente është shumë e lehtë për përfituesit e AD-së.

Biblioteka ligjore e materialeve në kopje fizike ka vazhduar të mos jetë e kërkueshme edhe në periudhën raportuese prandaj për shkak të zhvendosjes së përkohësisht të AD-së në objektin e ri, kjo bibliotekë nuk është funksionalizuar.

Me qëllim që përfituesve të saj t’iu ofrohen edhe resurse dhe burime ligjore nga rrafshi ndërkombëtarë, AD ka vazhduar anëtarësimin në Asociacionin e Bibliotekave Elektronike që konzorciumi i EIFL-as i siguron për vendet në tranzicion. Në këtë mënyrë gjatë vitit 2023 ka mundësuar për përfituesit e saj sipas ligjit dhe komunitetin tjetër ligjor qasjen në data bazat e natyrës ligjore dhe të përgjithshme si në vijim:

- **IOP science** që ka mundësuar studiuesit të hyjnë në përmbajtje shkencore, teknike dhe mjekësore.
- **Autoritetet shkencore të Oksfordit për të drejtën ndërkombëtare** e cila ka përfshirë traktatet autoritative, të cilat vazhdojnë definimin e fushave të tyre të së drejtës, punimet referuese dhe

komentaret e Black-letter që ndihmojnë në përgjigjen ndaj disa pyetjeve praktike të së drejtës dhe publikime të cilat ofrojnë këndvështrime inovative për problemet aktuale ligjore.

- **Enciklopedia e Max Planck për të Drejtën Publike Ndërkombëtare** që ka ofruar artikuj enciklopedik lidhur me më shumë se 1600 çështje ligjore ndërkombëtare, koncepte dhe raste.
- **Publikimet Edward Elgar** që ka ofruar e-libra dhe revista të publikuara mbi ligjin, biznesin, ekonominë dhe shkencat sociale.
- **Revistat online të Cambridge** që ka ofruar qasje në koleksionin multi-diciplinor mbi 330 revista të cilat mbulojnë temat mbi shkencën, teknologjinë, mjekësinë, humanizmin dhe shkencat sociale.
- OECD-iLibrary e integruar për libra, revista, punime dhe statistika
- **eBiblioteka e Fondit Monetar Ndërkombëtar** – që ka siguruar qasje të fuqishme dhe të përshtatshme në internet për mbledhjen e plotë të përmbajtjes autoritative ekonomike globale të publikuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Me më shumë se 11,000 botime të tekstit dhe qasje të plotë tek bazat e të dhënave statistikore të FMN-së.
- **Baza Evropiane e të Dhënave të Jurisprudencës së të Drejtave të Njeriut për vendet e Evropës Juglindore.** Kjo data bazë ka ofruar vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përmbledhje të çështjeve të rëndësishme për rajonin në gjuhët lokale si dhe botime tjera si manuale dhe udhëzues të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

6.4 Përditësimi i statistikave dhe data bazës së të dhëna me aktivitetet e realizuara gjatë vitit në kuadër të programeve trajnuese të AD-së

Në kuadër të PHP-së funksionon edhe njësi e statistikës e cila është komponentë e rëndësishme e institucionit të AD-së. Kjo njësi pas çdo trajnimit të realizuar në kuadër të programeve trajnuese të AD-së ka integruar të dhënat për të ftuarit dhe pjesëmarrësit në trajnime si dhe të dhënat nga formularët e vlerësimit nga pjesëmarrësit, trajnuesit dhe përgjegjësit e trajnimeve. Si rezultat i kësaj, data baza dhe statistikat kanë vazhduar të jenë burimi kryesor i informatave për KGJK dhe KPK, për përfituesit e saj sipas ligjit si dhe grupet e tjera të interesit përkatësisht OJQ-ve në rast të kërkesave për çështje specifike për të cilat edhe këto organizata funksionojnë.

Kjo data bazë ka qenë në shërbim dhe në funksion të hartimit të raporteve për vijueshmërinë në trajnime dhe njoftimit për kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorë të prokurorive në baza javore, në rastet e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve në KGJK dhe KPK, për raportim në mekanizmat integruar në BE dhe në ofrimin e të dhënave për përfaqësimin institucional në konferenca dhe takime të përbashkëta me institucione tjera të sistemit të drejtësisë.

Në periudhën raportuese, më saktë në fund të vitit 2023 Akademia e Drejtësisë ka qenë e angazhuar edhe në zhvillimin e data bazës së re SMAT e cila siq është dizajnuar do të shmang një varg veprimesh të cilat deri më tani kanë qenë manualisht dhe do të jetë më efikase. Funksionaliteti i saj i plotë pritet pasi të filloj implementimi i saj i plotë meqë tashmë sipas kësaj data baze do të kenë qasje edhe trajnuesit, mentorët, kryetarët e gjykatave etj., veçanërisht në rastet e listave të pjesëmarrjes në trajnime meqë duhet aprovimi dhe aspekte tjera me rëndësi për ecurinë dhe mbarëvajtjen e trajnimeve. Data baza ka adresuar edhe shkëmbimin e të dhënave me Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës të cilat mbeten për tu trajtuar sipas protokollit.

7. AVANCIMI DHE ZGJERIMI I BASHKËPUNIMIT DHE KOORDINIMIT ME PARTNERËT VENDOR, PARTNERËT NDËRKOMBËTARË, DONATORËT DHE INSTITUCIONET RELEVANTE TRAJNUESE NDËRKOMBËTARE

Bashkëpunimi si në rrafshin vendor ashtu edhe ndërkombëtarë është vlerësuar si i domosdoshëm për zbatimin e veprimtarisë së AD-së dhe për funksionimin më të mirë të saj. Prandaj ka vazhduar të jetë prioritet edhe në periudhën raportuese duke mbajtur takime të rregullta me të gjithë krerët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe partnerët tjerë strategjik dhe aktivisht e angazhuar në politikën rreth trajnimeve dhe aspekteve tjera që lidhen me mandatin e saj. Si rezultat i kësaj ka përfituar mbështetje në realizim të trajnimeve, punëtorive dhe tryezave të shumta si dhe pjesëmarrje në konferenca dhe forume të ndryshme ndërkombëtare.

Në vijim për secilën nga këto bashkëpunime jepen detaje të hollësishme për numrin e aktiviteve dhe të dhëna tjera të rëndësishme.

7.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës

KGJK, KPK duke përfshirë edhe Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës janë partnerët kryesor dhe strategjik të Akademisë së Drejtësisë përderisa me mandat ka rritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve prokurorë dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Në periudhën raportuese Akademia e Drejtësisë është angazhuar intenzivisht në bashkëpunimin dhe koordinimin me KGJK dhe KPK për vlerësimin e nevojave trajnuese përmes punëtorive të përbashkëta, për zhvillimin dhe zbatimin e programeve trajnuese dhe për aspekte tjera me interes të përbashkët. Me Gjykatën Supreme edhe në fushën e botimeve veçanërisht në botimin e dy përmbledhjeve të praktikës gjyqësore të cilat u shpërndanë për gjithë gjyqtarë në kuadrin e ditëve të gjyqësorit. Edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi dhe koordinimi për vijueshmërinë në trajnime.

7.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë

Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë, përkatësisht grupin përgjegjës për zbatueshmërinë e Strategjisë për sundimin e ligjit dhe me koordinatorin nacional për Strategjinë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunën ndaj grave. Vëmendje të veçantë i ka kushtuar edhe arritjes së memorandumeve të bashkëpunimit me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, Odën e Ndërmjetësuesve, Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar dhe në zbatimin e aktiviteteve sipas marrëveshjeve paraprake me institucionet tjera të sistemit të drejtësisë.

7.3 Zbatimi i trajnimeve me donatorë

Aktivitetet e realizuara me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-së OPDAT dhe Ambasadën Amerikane

Gjatë vitit 2023, si rezultat i bashkëpunimit me Departamentin Amerikan të Drejtësisë/OPDAT, dhe Ambasadën Amerikane janë realizuar tridhjetë e katër (34) aktivitete trajnuese. Këto aktivitete trajnuese ishin për risitë e kodit të Procedurës Penale, pesë (5) prej tyre ishin edhe në bashkëpunim me OSBE-në, aktivitete trajnuese në luftimin e formave të ndryshme të korrupsionit me theks në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit, korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër korrupsionit, pastrimit të parave, prokuroimit publik, në rritjen e kapaciteteve të trajnuesve për ndërmjetësimin si dhe të ndërmjetësuesve në fushën e dhunës në familje, vlerësimit të rrezikshmërisë dhe për politikën ndëshkimore.

Aktivitetet e realizuara me Ambasadën Franceze

Në sajë të bashkëpunimit me Ambasadën Franceze janë realizuar dy (2) trajnime shumë specifike siq janë: Përdorimi i provës balistike si dhe Trafikimi me pasuritë kulturore si një nga bizneset kriminale fitim prurëse. Të dy trajnimet janë dedikuar gjyqtarëve dhe prokurorëve me qëllim të interpretimit dhe zbatimit të drejtë të provave balistike si dhe vendosjes meritore të rasteve të trafikimit me pasuritë kulturore ku bizneset, përkatësisht kryesit përfitojnë nga ky aktivitet kriminal.

Aktivitetet e realizuara me Projektin për Drejtësi Komerçiale të mbështetura nga USAID

AD në bashkëpunim me Projektin për Drejtësi Komerçiale– ka realizuar nëntë (9) aktivitete të cilat po ashtu ishin në fushën e ndërmjetësimin. Prej tyre tri (3) tjera në fushën e drejtësisë komerciale me theks njohuritë financiare dhe një (1) Programi i Trajnimit mbi Lidërshtipin dhe Menaxhmentin për Gjykatën Komerçiale.

Aktivitetet e realizuara me zyrën e Bashkimit Evropian dhe projektet e saj

Me projektin EUKOJUST janë realizuar gjashtë (6) aktivitete trajnuese të cilat ishin të orientuara në trajtimin e çështjeve ligjore sa i përket akuzimit dhe dënimit të rasteve të dhunës në familje, për bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë në çështje civile, për përkthyes dhe interpret gjyqësor mbi përdorimin e koncepteve ligjore dhe doracakun për punën e përkthyesve në gjykata si dhe një trajnim për stafin e AD-së për Ndjeshmëria gjinore dhe Kodi i Sjelljes në vendin e punës

Me projektin e IRZ-së janë realizuar dy (2) aktivitete trajnuese me fokus te - Pastrimi i parave dhe hetimi financiar-SesioninII dhe III. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe profesionistëve tjerë ligjor lidhur çështjet ligjore përkatëse. Përveq aktiviteteve trajnuese si rezultat i mbështetjes së IRZ është realizuar edhe një vizitë studimore për gjyqtarët e gjeneratës së VIII në PTF në Trier dhe Koblenz të Gjermanisë.

Aktivitetet e realizuara me zyrën e Këshillit të Evropës dhe projektet e saj

Me projektin **I PROCEEDS** është realizuar trajnimi i specializuar për gjyqtarët dhe prokurorët për Provat Elektronike. Qëllimi kryesor i trajnimit ishte rritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, dhe zyrtarëve policor në sigurimin e nëpërmjet përdorimit të sistemeve kompjuterike.

Me projektin **PRO-FREX** është realizuar një (1) aktivitete trajnues për Mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve i cili i është dedikuar gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Me projektin **Forcimi i institucioneve të sistemit të Kosovës në luftën kundër torturës, keqtrajtimit dhe trajtimeve tjera degraduese** janë realizuar dy (2) aktivitete trajnuese në rritjen e kapaciteteve trajnuese. Prej tyre një në fushën e arsytimit të vendimeve gjyqësore dhe një për metodologjinë HELP.

Me projektin **PECK III** është realizuar një (1) aktivitete trajnues i cili ishte i fokusuar në rritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe zbatuesve tjerë të ligjit për Kripto Asetet dhe përdorimin e tyre në veprën penale të pastrimit të parave.

Me projektin **CEPEJ** janë realizuar dy (2) aktivitete trajnuese të cilat kishin qëllim ngritjen e efikasitetit të gjykatave përmes instrumenteve dhe indikatorëve të CEPEJ-it për performancë duke i përdorë raportet statistikore të SMIL-it.

Me projektin **FORCIMI I VEPRIMEVE ANTI-TRAFIKIM** janë realizuar tri (3) aktivitete trajnuese me ç'rast një ishte për ndryshimet e KPP-së në fushën e trafikimit me qenje njerëzore dhe dy tjera për Sfidat në identifikimin/hetimin e trafikimit me njerëz në mesin e fëmijëve në situatë rruge.

Aktivitetet e realizuara me Inicativën e Chemonics për Sundim të Ligjit në Ballkanin Perëndimor (WBROLI), financuar nga Mbretëria e Bashkuar

Në bashkëpunim me projektin “Chemonics” janë realizuar 7 aktivitete trajnuese. Prej tyre dy (2) për gjyqtarë dhe prokurorë në fushën e krimit të organizuar, tri (3) për bashkëpunëtorë profesional për rolin e prokurorit, detyrimet publike, shkathtësitë në hartimin e akteve akuzuese si dhe për procedurën paraprake. Përmes këtij projekti janë realizuar edhe dy (2) punëtori për Komisionet e vlerësimit të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që veprojnë në kuadër të KGJK-së dhe KPK-së të cilat kishin si qëllim avancimin e njohurive të anëtarëve të Komisoneve lidhur me detyrat dhe përgjegjësit gjatë ushtrimit të funksioneve përkatëse.

Aktivitetet e realizuara me OSBE-në

Në mbështetje të OSBE-së janë realizuar dhjetë (10) aktivitete trajnuese, në të cilat kanë përfituar gjyqtarë, prokurorë si dhe profesionistë tjerë ligjor nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial. Fushat në të cilat janë përqendruar aktivitetet përkatëse ishin për KEDNJ dhe Jurisprudencën e Gjykatës

Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi dhe raporti i tij me Ligjin e punës dhe Ligjin për procedurën kontestimore si dhe për risitë e Kodit të Procedurës Penale.

Aktivitetet e realizuara me GIZ

Në mbështetje të GIZ janë realizuar tetë (8) aktivitete trajnuese të cilat i janë dedikuar gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor. Në kuadër të këtyre aktiviteteve trajnuese janë trajtuar aspekte të rëndësishme në procedurën e konfliktit administrativ, nga procedura kontestimore, përmbartimore, për mbrojtjen gjyqësore në rastet e pengim posedimit dhe servituteve, në fushën e drejtësisë për fëmijë, përkatësisht mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdese prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre, në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë në çështje civile si dhe për viktimat e dhunës seksuale. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të përfituesve sipas ligjit që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, të ngriten kapacitetet profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor për zgjidhjen e drejtë të rasteve ligjore përkatëse.

Aktivitetet e realizuara me UNDP/SAEK

Në mbështetje të UNDP dhe SAEK janë realizuar tridhjetë e nëntë (39) aktivitete trajnuese për ngritje të kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor. Prej tyre katër (4) trajnime me temë Hetimi Financiar dhe rikuperimi i aseteve, një (1) për dhunën në familje, një (1) për ambientin si dhe tridhjetë e tri (33) aktivitete për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor.

Aktivitetet e realizuara me UNCHR-Zyra e Misionit në Kosovë

Gjatë vitit 2023 në saje të bashkëpunimit të vazhdueshëm me UNCHR, janë realizuar tri (3) trajnime për gjyqtarët e departementit administrativ në fushën e azilit me theks te statusi i të huajve dhe atij ndërkombëtarë dhe për personat pa shtetësi. Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e aftësive të gjyqtarëve në zbatimin e legjislacionit vendor në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të azilkërkuesve, refugjateve edhe personave me pa shtetësi.

Aktivitetet e realizuara me Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë

Në periudhën raportuese Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës së Shqipërisë ka realizuar dy aktivitete trajnuese. Aktiviteti i parë i është dedikuar prokurorëve nga të dy vendet, ndërkaq aktiviteti i dytë i është dedikuar gjyqtarëve. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte shkëmbimi i përvojave dhe perspektivave të dy vendeve sa i përket përfaqësimit në gjykatë nga ana e prokurorit si dhe për krimet mjedisore. Trajnimi për krimet mjedisore ishte edhe si rezultat i mbështetjes nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian.

Aktivitetet e realizuara me EULEX

Në periudhën raportuese, AD në bashkëpunim me EULEX ka realizuar gjashtëmbëdhjetë (16) aktivitete trajnuese. Prej tyre katërmëdhjetë (14) ishin nga drejtësia për fëmijë duke përfshirë, legjislacioni i zbatueshëm në rastet e keqpërdorimit të fëmijëve, dhunës seksuale dhe aspekte tjera me rëndësi si dhe dy (2) punëtori për qasjen në dokumentet publike dhe për mbrojtjen e të dhënave personale. Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte fuqizimi i kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjykimin e drejtë të rasteve duke zbatuar legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.

Aktivitetet e realizuara me CEELI Institut

Në sajë të bashkëpunimit me këtë institut, Akademia e Drejtësisë ka rritur kapacitetet trajnuese nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve në fushën e korrupsionit. Janë realizuar dy (2) trajnime për trajnues për gjykimin e rasteve të korrupsionit.

Aktivitetet e realizuara me Humanitarian Law Center

Krimet e luftës kanë vazhduar të jenë pjesë integrale e programit trajnues për shkak të specifikave të këtyre veprave dhe mungesës së përvojës në trajtimin e këtyre rasteve. Në mbështetje të këtij institucioni janë realizuar dy (2) aktivitete trajnuese në të cilat kanë përfituar veçanërisht gjyqtarët nga departamenti special dhe prokurorët e PRSK-së.

Aktivitetet e realizuara me CLARD –Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional

Në periudhën raportuese AD në bashkëpunim me CLARD ka realizuar katër (4) aktivitete trajnuese në fushë e dhunës në familje. Tri (3) prej tyre ishin me temë: Trajnim i avancuar për parandalimin e dhunës në familje- Konventa e Stambollit ndërkaq një (1) edhe në konkestin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këto trajnime kanë qenë të dizajnuara për avokatë dhe të njëjtit kanë qenë përfitues të këtyre trajnimeve.

Programet praktike dhe shkëmbimi i përvojave me vendet ne rajon

Programi praktik për kandidatet e Shkollës së Magjistraturës së Francës në institucionet gjyqësore në Kosovë

Në vazhden e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës së Francës, përmes Ambasadës Franceze në Kosovë gjatë vitit 2023, përkatësisht nga data 06-24 mars 2023 për dy candidate për gjyqtare nga kjo shkollë është organizuar programi praktik tre javor në institucionet gjyqësore në Kosovë. Kandidatet për gjyqtare gjatë programit praktik paten mundësinë e njohjes me funksionimin e AD-së dhe njëherit vijimin e një sesioni të trajnimit fillestar bashkë me prokurorët e gjeneratës së IX të cilët aktualisht ishin duke vijuar sesionet e trajnimit teorik nga moduli i Kodit të Procedurës Penale. Në vijim të këtij programi praktik ato janë njoftuar për së afërmi me punën në prokurori dhe gjykata përmes vëzhgimit praktik dhe veçanërisht në Prokurorinë Speciale të

Kosovës, pasi fokusi ishte tek krimet e luftës.

Programi praktik i gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Kosovës në Bon

Në mbështetje të IRZ-së për gjyqtarët dhe prokurorët e gjeneratës së VIII që kanë përfunduar trajnimin fillestarë në Akademi të Drejtësisë gjatë vitit 2020-2021 është realizuar një vizitë sudimore në Bon të Gjermanisë. Për shkak të numrit të madhë të gjyqtarëve dhe prokurorëve të kësaj gjenerate vizita është mundësuar në dy grupe. Grupi i I ka realizuar vizitën në fund të vitit 2022 ndërkaq grupi II prej 19 gjyqtarëve këtë vizitë e ka realizuar në gjashtëmuorin e parë të vitit 2023.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vëzhgimi praktik i metodave të punës në Gjykatat dhe Prokuroritë e Shtetit Federal të Gjermanisë si dhe shkëmbimi i përvojave dhe fuqizimi i kontakteve ndërmjet institucioneve të dy vendeve. Për tri ditë me radhë gjyqtarët dhe prokurorët pjesëmarrës patën mundësinë e njohjes me rregullimin e sistemit gjyqësor në Gjermani dhe veçanërisht për drejtësinë penale, civile, familjare si dhe për mundësinë e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve në Gjermani. Në kuadër të këtij programi janë njoftuar për së afërmi organizimin dhe funksionimin e gjykatave dhe prokurorive, kryesisht të shkallës së parë si dhe ndjekjen e dy seancave gjyqësore.

Aktivitetet me Rrjetin Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN)

Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të bashkëpunoj me Rrjetin Evropian të Trajnimit gjyqësor si rezultat i projektit për Ballkanin Perëndimor Ky projekt sipas udhëzimeve ka lehtësuar pjesëmarrjen në aktivitetet e EJTN-së kryetarëve të gjykatave, kryeprokurorëve, trajnuesve gjyqësorë dhe anëtarët e tjerë të gjyqësorit, të cilët mund të forcojnë me sukses lidhjet institucionale midis organizatës së tyre dhe kolegëve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.

Në periudhën raportuese një gjyqtari dhe një zyrtari të njësisë së trajnimeve nga KPK i është mundësuar pjesëmarrja në Programin e Shkëmbimit 2023 që kishte në fokus trajnimin gjyqësor dhe metodat e trajnimit gjyqësor. Aktiviteti në të cilin ka marrë pjesë gjyqtari nga Kosova është realizuar në Qendrën për Studime Gjyqësore në Lisbonë të Portugalisë, ndërkaq aktiviteti në të cilin ka marrë pjesë zyrtarja nga KPK është mbajtur në Talin të Estonisë. Përveq kësaj Akademia përmes përfaqësuesit të saj ka marrë pjesë në në Kuvendin e përgjithshëm të EJTN e cila është mbajtur në Akademinë e Trajnimit Gjyqësor në Stokholm të Suedisë.

Në Programin e Shkëmbimit të Kryetarëve të Gjykatave, Akademia e Drejtësisë në konsultim me përfituesit dhe sipas interesimit e ka emëruar një nga Kryetarët e Gjykatave të Republikës së Kosovës që do të jetë në Gjykatën e Dortmundit në Gjermani.

Për vitin 2024, Akademia e Drejtësisë ka pranuar Kalendarin e aktiviteteve për vitin 2024 të cilin e ka ndarë me gjyqtarë dhe prokurorë sipas të cilit janë shtatë vende të rezervuara për pjesëmarrje të përfaqësuesve të Kosovës në vitin 2024 me financim nga Projekti i Ballkanit Perëndimor II.

8. TRANSPARENÇË DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Akademia ka vazhduar punën e saj duke bërë transparente veprimtarinë dhe aktivitetet e saj përmes portalit dhe web faqes. Në periudhën raportuese, AD është angazhuar në ridizajnimin e faqes së AD-së me të vetmin qëllim që gjitha njoftimet dhe publikimet në faqen e saj duke filluar nga shpalljet dhe thirrjet për aktivitete të ndryshme, programet trajnuese, kalendarin e trajnimeve, njoftimet për realizimin e trajnimeve të jenë më lehtë të qasshme për komunitetin ligjor dhe publikun në përgjithësi. Përveq kësaj është angazhuar edhe në zhvillimin e publikimitin e platformave tjera si linkelid dhe facebook. Etj

9. NGRITJA E CILËSISË SË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE DHE NË FINANCA

Departamenti i Administratës dhe Financave (më tej DAF) është udhëhequr nga Ushtruesi i Detyrës -Drejtori për Administratë dhe Financa, i cili është nivel drejtues dhe ka përfshinë sektorë të cilët janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të përgjithshme, financiare, të prokurimit, teknologjisë informative, personelit dhe logjistikes, në funksion të realizimit të objektivave programore të Akademisë.

Shërbimet e përgjithshme dhe financat sipas kompetencës ligjore janë fokusuar në realizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara sipas Planit të punës dhe Planit të Performances për vitin 2023, me theks në fushën e trajnimeve në kuadër të veprimtarisë hulumtuese dhe botuese dhe aktivitet tjera mbështetëse.

9.1 Shërbimet e përgjithshme

Në kuadrin e shërbimeve të përgjithshme, në periudhën raportuese në aspektin administrativ, teknik dhe të logjistikes janë mbështetur të gjitha aktivitetet e organizuar nga AD. Varësisht nga aktivitetet trajnuese është bërë arkivimi i materialit trajnues për qëllime studimi. Gjithashu përfunduar auditimi nga ZKA për vitin 2022 dhe është publikuar raporti i auditimit si dhe përgatitur plani për zbatimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2022.

9.2 Rishikimi i akteve nënligjore

Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë është angazhuar në rishikimin e akteve nënligjore si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura. Lidhur me këtë ka themeluar grupin punues i cili ka shqyrtuar aktet ligjore që kanë nevojë për harmonizim me këtë ligj dhe ka rishikuar dhe nxjerrë pesë aktet si në vijim:

- Rregulloren Nr. 01/2023 - për Plotësim dhe Ndryshimin e Rregullores Nr 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.

- Rregulloren Nr. 02/2023 - për Plotësim dhe Ndryshmin e Rregullores Nr 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë
- Rregulloren Nr. 03/2023 - për Plotësim dhe Ndryshmin e Rregullores Nr 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë
- Rregulloren Nr. 04/2023 - Për Pranimin dhe Emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë si dhe
- Rregulloren Nr. 05/2023 - Për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Akademinë e Drejtësisë

Aktet e nxjerra kanë qenë në koordinim dhe bashkëpunim me MPB, veçanërisht rregullorja për organizim të brendshëm. Me sukses janë përfunduar të gjitha proceset e punës së grupit punues deri te finalizimi dhe konfirmimi me këtë institucion.

9.3 Zhvillimi, menaxhimi dhe ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore

Të punësuarit në Akademi të Drejtësisë janë shërbyes civil dhe i nënshtrohen ligjeve dhe rregullave për shërbimin civil në Kosovë. Në pajtim me këto rregulla të punësuarit në Akademi janë në marrëdhënie pune me akt emërimi prej kur ka filluar të zbatohet ky sistem.

Stafi i AD-së është i angazhuar me zbatimin e programeve trajnuese, në analiza hulumtime dhe veprimtari botuese si dhe me shërbime tjera të cilat janë në funksion të ngritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistë tjerë ligjor.

Numri i aprovuar i stafit me buxhetin e vitit 2023, ka qenë 32 pozita, ndërsa numri i stafit deri në fund të vitit ka qenë 25 zyrtar. Pozitat e lira nuk kanë mundur të plotësohen për shkak se fillimisht është fokusuar në harmonizimin e akteve nënligjore me Ligjin Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e vijave Llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura¹⁶. Aktualisht, Akademia e Drejtësisë ka 32 pozita të miratuara prej të cilave 25 janë të plotësuara dhe 7 pozita të tjera janë të lira dhe të pa plotësuara.

Ndërsa me miratimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës, me organogram janë parapare gjithsejtë 36 pozita të nevojshme për AD, që në vitin vijues do të kërkohet mbështetje për financimin edhe të 4 pozitave tjera si të paraparë në këtë rregullore.

9.4 Të punësuarit dhe nevojat për punëtorë të rinj

Në periudhën raportuese, numri i përgjithshëm i pozitave të miratuara sipas Ligjit Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023 ka qenë 32 pozita të karrierës. Me qëllim të zbatimit të mandatit ligjor të Akademisë dhe zbatimit të legjislacionit në fuqi, gjatë planifikimit buxhetor për vitin 2023-2025 është ri përsëritur kërkesa për plotësimin e 11 pozitave të nevojshme për vitin 2024 si në vijim:

- Zyrtar (1) për Marrëdhënie me Publikun;

¹⁶ Potencuar te Zhvillimi i bazës ligjore si dhe te Rishikimi i akteve nënligjore në këtë raport

- Një (1) Udhëheqës për trajnime të stafit administrativ;
- Dy (2) Zyrtar të trajnimeve;
- Tre (3) Zyrtar për publikime dhe hulumtime ;
- Një (1) Zyrtar për shpenzime;
- Një (1) zyrtar për mësim në distancë (e-learning) si dhe
- Dy (2) zyrtar ligjor

Ndersa pas riorganizimit dhe sistematizimit pozitat si të kerkura janë fuzionuar në strukturën e re të AD, respektivisht konform Rregullores mbi organizmin dhe sistematizimin e vendeve të punës në AD si të miratur nga Keshilli Drejtues, janë mbete të pa buxhetura 4 pozita dhe atë 2 pozita udhëheqëse niveli i ulte drejtues dhe 2 pozita profesionale.

9.5 Trajnimet e stafit

Trajnimet janë një aspekt i rëndësishëm për zhvillimin profesional të çdo zyrtari publik prandaj në periudhën raportuese AD ka vazhduar bashkëpunimin me IKAP dhe varësisht nga programi i ofruar ka përcaktuar stafin përfitues të cilët kanë marrë pjesë në këto trajnime.

Përveq kësaj janë realizuar edhe dy trajnime për stafin e AD-së të cilat ishin si rezultat i bashkëpunimit të AD-së me EKOJUST dhe me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik në Kosovë. Trajnimi në mbështetje të projektit EKOJUST për stafin e Akademisë së Drejtësisë ishte me temë: “Ndjeshmëria gjinore dhe Kodi i sjelljes në vendin e punës”. Përfitues të këtij trajnimi ishin 22 pjestarë nga stafi i të cilët në fund morën certifikatat për pjesëmarrje në trajnimin përkatës.

Trajnimi në mbështetje të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik në Kosovë ishte me temë: “Menaxhimi i kontratës dhe vlerësimi i performances së kontraktorëve përmes sistemit të e-prokurimit”. Ky trajnim iu dedikua stafit që ishin zyrtarë të prokurimit, zyrtarë përgjegjës dhe të ngarkuar për menaxhim të kontratave të cilët në fund të trajnimit u pajisën me certifikata të pjesëmarrjes.

9.6 Avancimi i teknologjisë informative

Në periudhën raportuese teknologjia informative ka qenë prioritet për Akademinë duke u fokusuar në avancimin, përmirësimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve informatike dhe digjitalizimit të shërbimeve, avancimin e teknologjisë informative për zbatim të programeve trajnuese dhe aktiviteteve tjera. Divizioni i TI me sukses ka udhëhequr aktivitetet në zhvillimin dhe avancimin e bazës së të dhënëve për sistemin e aktiviteteve trajnuese. Në koordinim dhe mbështetje të stafit të AD dhe në bashkëpunim me operatorin ekonomik të kontraktuar për zhvillimin dhe përditësimin e data bazës dhe web faqes se AD, me sukses është realizuar ky projekt madhore për AD. Krahas aktiviteteve të theksuara, Divizioni i TI ka qenë i fokusuar edhe në aktivitetet si në vijim:

- Mirëmbajtja dhe administrim i vazhdueshëm i pajisjeve të teknologjisë informative si kompjuterë, llaptop, server, telefonia fikse dhe pajisjeve tjera.

- Është mbështetur vazhdimisht stafi në procese të punës me çështjet që kanë të bëjnë me teknologji informative.
- Gjatë këtij viti është zhvilluar sistemi për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese si dhe ueb faqja e Akademisë.
- Gjatë këtij viti janë blerë 64 laptop dhe 10 UPS.
- Ueb faqja zyrtare dhe rrjetet tjera sociale të Akademisë vazhdimisht janë freskuar me informata të reja.
- Është zhvilluar kursi trajnues në platformën e mësimit në distancë: Hetime Financiare dhe Rikuperimin e Aseteve dhe Mbajtja e Shënimeve.

9.7 Prokurimi

Akademia e Drejtësisë ka hartuar planifikimin e prokurimit për vitin 2023 sipas ligjislacionit në fuqi si dhe në baze të kërkesave dhe nevojave vjetore nga të gjitha departamente e AD. Planifikimi i prokurimit ka përfshinë përshkrimin e punëve/furnizimeve dhe shërbimeve së bashku me vlerën e parashikuar.

Sipas ndryshimeve ligjore në fushën e prokurimit, AD si institucion me më pak se 50 nëpunës nuk ka të drejtë të zhvillojë procedurë të prokurimit prandaj edhe të gjitha aktivitetet e prokurimit i ka realizuar përmes AQP-së. Në periudhën raportuese janë realizuar furnizimet si rezultat i aktiviteteve të prokurimit si në vijim:

- Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative-furnizim me laptop, pajisje të përkthimit dhe transkriptimit dhe UPS
- Furnizim me ushqim të gatshëm dhe pije për pjesëmarrësit në Akademi
- Furnizim me naftë për vetura/ngrohje dhe gjenerator
- Furnizim me materiale të shtypura dhe dizajn (botime dhe publikime)
- Furnizim me letër dhe material zyrtar
- Furnizim me ujë të pijes
- Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor-furnizim me produkte për kafiteri
- Furnizim me inventar-furnizim me karrige statike për sallat e trajnimeve
- Furnizim me automjete
- Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese dhe ueb faqes së AD-së
- Servisimi i klimave
- Shërbime të përkthimit dhe lektorimit
- Larja e automjeteve
- Sigurimi i veturës
- Shfrytëzimi i veturave me qira

Aktivitete të prokurimit për të cilat janë nënshkruar kontrata:

- Furnizim me karburante për vetura-lot 2
- Furnizim me karburante për ngrohje dhe gjenerator-lot 4
- Furnizim me materiale të shtypura-botime dhe publikime

- Furnizim me material shpenzues për zyre
- Furnizim me letër për kopje
- Furnizim me ujë te pijes
- Shërbime te përkthimit dhe lektorimit
- Furnizim me ushqim te gatshëm dhe pije për pjesëmarrësit ne trajnime ne Akademi
- Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese dhe ueb faqes se AD-se
- Larja e automjeteve
- Furnizim me automjete
- Shërbime te transporti ajror
- Sigurimi i veturës

9.8 Financat

Në kuadrin e financave janë realizuar aktivitetet si në vijim:

- Janë përgatitur pasqyrat vjetore financiare për vitin 2022;
- Është përgatitur pyetëtori për vetëvlerësim për vitin 2022;
- Është përgatitur rrjedha e parasë së gatshme për vitin 2023;
- Është përgatitur Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe Buxheti për periudhën 2024-2026;
- Janë bërë barazimet periodike të shpenzimeve me thesar;
- Janë përgatitur raporte të ndryshme periodike financiare;
- Shpenzimet e proceduara për këtë periudhë janë regjistruar në databazën e brendshme të financave dhe në SIMFK.

Shpenzimet e krijuara gjatë kësaj periudhe janë mbuluar nga Buxheti i Republikës së Kosovës si burim kryesor financiar si dhe nga mbështetja e granteve të donatorëve.

Shpenzimet e buxhetit përfshihen në këto kategori kryesore ekonomike: pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet komunale. Tabela në vijim pasqyron buxhetin fillestar dhe buxhetin përfundimtar për vitin 2023 duke përfshirë kategoritë ekonomike.

Buxheti dhe Shpenzimet 2023				
Kategoria	Buxheti fillestar	Reduktimet dhe kursimet buxhetore	Buxheti përfundimtar	Shpenzimet 2022
Pagat dhe Mëditjet	244,866.99	(15,751.69)	229,115.30	229,115.30
Mallrat dhe Shërbimet	435,000.00	-	435,000.00	398,457.03
Shpenzimet Komunale	16,500.00	-	16,500.00	9,470.74
Shpenzime Kpaitale	196,000.00	-	196,000.00	95,815.00
Donacionet	-	-	17,128.00	17,084.40
Totali	892,366.99	(15,751.69)	893,743.30	749,942.47

Tabela nr. 22: Raporti i Buxheti për vitin 2023

Buxheti fillestar për mallra dhe shërbime, ka qenë 435,000.00euro, ndryshimet në mes të buxhetit fillestar dhe buxhetit përfundimtarë në kuadër të kësaj kategorie janë si rrjedhojë e donacioneve.

Buxheti në këtë kategori ekonomike në fund të vitit 2022, ka pasur ndryshime dhe është 452,128.00 euro, prej të cilave 435,000.00 euro janë nga buxheti dhe 17,128.00 euro, nga UNDP donacion janë 17,128.00 euro nga të cilat 2,400.00 janë bartje nga viti i 2022.


Kategoria e mallrave dhe shërbimeve është kategori e cila përfshinë një pjesë të madhe të alokimit dhe shpenzimit të mjeteve në kuadër të buxhetit të AD.

Me qe nëse AD merret me trajnime profesionale për gjyqtarë, prokurorë, dhe profesionist tjerë të identifikuar nga AD, në kuadër të kësaj kategori shpenzimet e trajnimit kanë qenë shpenzimet kryesore dhe më të mëdha të AD.

AD ende vazhdon veprimtarinë në objekt me qira dhe shpenzimet e qirasë janë ndër shpenzimet tjera më të mëdha për këtë periudhë, ndërsa shpenzimet tjera kryesisht janë në shuma më të vogla.


Kategoria	Buxheti	Shpenzimet	Shpenzimet në % në raport me buxhetin total	Mbetja	Përqindja	Shpërndarja e buxhetit në %
Pagat dhe Meditjet	229,115.30	229,115.30	31.26%	-	100.00	26.14
Mallrat dhe Shërbimet	435,000.00	398,457.03	54.37%	36,543	91.60	49.62
Shpenzimet Komunale	16,500.00	9,470.74	1.29%	7,029	57.40	1.88
Shpenzime Kapitale	196,000.00	95,815.00	13.07%	100,185	48.89	22.36
Totali	876,615.30	732,858.07	98.71%	143,757	83.60	98.12

Tabela nr. 23: Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2023




Grafikoni nr. 14: Ekzekutimi i Buxhetit për vitin 2023

Nga buxheti përfundimtar janë shpenzuar 732,858.07 euro apo 83.60 % e buxhetit.



Grafikoni nr. 15: Shpërndarja e buxhetit

Sipas këtij grafikoni shihet se 26% e buxhetit përfundimtar është ndarë për paga dhe mëditje 50% për mallra dhe shërbime, 2% për shpenzimet komunale dhe 22% për shpenzime kapitale.



Grafikoni nr. 16: Shpenzimi i buxhetit

Në raport me shumën totale të buxhetit të shpenzuar: pagat dhe mëditjet me 31.26%, mallrat dhe shërbimet përfshihen me 54.37%, dhe shpenzimet komunale me 1.29%

Në tabelën në vazhdim përveç kategorive ekonomike shpenzimet prezantohen edhe për nënkategoritë ekonomike duke krahasuar me buxhetin e vitit për secilën nënkategori.

Buxheti dhe shpenzimet sipas kategorive dhe nënkategorive për vitin 2023					
Kategoria	Nënkategoria	Shpenzimet	Buxheti	Ndryshimi	Përqindja
Paga					
11110	Pagat neto përmes listës	193,682.57	193,682.57	-	100.00
11500	Tatimi i ndalur në të ardhura	13,611.35	13,611.35	-	100.00
11600	Kontributi i punëtorit	10,910.69	10,910.69	-	100.00
11700	Kontributi i punëdhënësit	10,910.69	10,910.69	-	100.00
Shuma		229,115.30	229,115.30	-	100.00
Mallra dhe Shërbime					
13132	Akomodimi udhëtime zyrtre brenda vendit	-	2,000.00	2,000.00	-
13141	Meditjet për udhëtime zyrtre jashtë vendit	5,502.83	8,000.00	2,497.17	68.79
13142	Akomodimi udhëtime zyrtre jashtë vendit	100.00	4,000.00	3,900.00	2.50
13143	Shpenzime tjera udhëtime zyrtre jashtë vendit	85.00	1,000.00	915.00	8.50
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	2,137.27	3,360.00	1,222.73	63.61
13330	Shpenzimet postare	-	200.00	200.00	-
13410	Shërbimet e arsimit trajnimit	188,762.74	190,933.00	2,170.26	98.86
13430	Shërbime të ndryshme shëndetsore	-	200.00	200.00	-
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënës	3,804.75	6,216.00	2,411.25	61.21
13450	Shërbime shtypje-jo marketing	-	300.00	300.00	-
13460	Shërbime kontraktuese tjera	24,871.80	25,000.00	128.20	99.49
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)	800.00	1,000.00	200.00	80.00
13509	Pajisje tjera	-	3,000.00	3,000.00	-
13610	Furnizime per zyre	8,053.51	11,000.00	2,946.49	73.21
13620	Furnizim me ushqim, pije (jo dreka zyrtare)	4,421.86	5,000.00	578.14	88.44
13640	Furnizime pastrimi	-	-	-	-
13720	Nafte per ngrohje qendrore	20,015.40	21,600.00	1,584.60	92.66
13770	Derivate per gjenerator	-	1,500.00	1,500.00	-
13780	Karburant per vetura	1,815.03	5,000.00	3,184.97	36.30
13950	Regjistrim i automjeteve	235.50	300.00	64.50	78.50
13951	Sigurimi i automjeteve	1,111.73	1,175.00	63.27	94.62
13952	Taksat Komunale e Regjistrimi te automjeteve	-	50.00	50.00	-
13953	Sigurim i ndertesave dhe tjera	11,696.40	11,696.40	-	100.00
14010	Mirembajtje dhe riparim i automjeteve	115.50	2,000.00	1,884.50	5.78
14020	Mirembajtje e ndertesave	7,434.00	7,434.00	-	100.00
14040	Mirembajtje e teknologjise informative	-	1,200.00	1,200.00	-
14050	Mirembajtje e mobiljeve dhe pajisjeve	95.00	620.00	525.00	15.32
14110	Qiraja e ndertesave	90,000.00	90,000.00	-	100.00
14130	Qiraja per pajisjet	3,453.11	4,000.00	546.89	86.33
14140	Qiraja per makineri	12,215.60	12,215.60	-	100.00
14210	Reklammat dhe konkurset	-	1,000.00	1,000.00	-
14220	Botimet e publikimeve	11,200.90	13,000.00	1,799.10	86.16
14310	Dreka zyrtare	529.10	1,000.00	470.90	52.91
Shuma		398,457.03	435,000.00	36,542.97	91.60
Komunali					
13210	Rryma	7,354.16	8,000.00	645.84	91.93
13220	Uji	267.30	2,000.00	1,732.70	13.37
13230	Mbeturinat	231.44	2,300.00	2,068.56	10.06
13250	Shpenzimet e telefonit	1,617.84	4,200.00	2,582.16	38.52
Shuma		9,470.74	16,500.00	7,029.26	57.40
Kapitale					
31610	Pajisje të teknologjisë informative	39,820.00	56,000.00	16,180.00	71.11
31680	Softwer	24,200.00	50,000.00	25,800.00	48.40
31710	Vetura zyrtare	31,795.00	90,000.00	58,205.00	35.33
Shuma		95,815.00	196,000.00	100,185.00	48.89
Totali		732,858.07	876,615.30	143,757.23	83.60

Tabela nr. 24: Shpenzimet për kategori dhe nën kategori ekonomik

Buxheti përfundimtar për vitet 2021 – 2023			
Kategoria	2021	2022	2023
Pagat dhe Meditjet	212,350.58	243,649.00	229,115.30
Mallrat dhe Shërbimet	312,017.69	400,000.00	435,000.00
Shpenzimet Komunale	7,180.89	16,500.00	16,500.00
Shpenzime Kpaitale	-	-	196,000.00
Totali	531,549.16	660,149.00	876,615.30

Tabela nr. 25: Krahasimi i buxhetit për vitet 2021 – 2023

Mbështetja financiare nga donatorët

Donacionet e menaxhuara nga AD

Donatorët				
Shpenzimet janar - dhjetor 2023				
Viti	Emri i Donatorit	Shpenzimet	Alokimi	Mbetja
2023	UNDP	17,084.40	17,128.00	43.60
Shuma		17,084.40	17,128.00	43.60

Tabela nr. 26: Donacionet e menaxhuara nga AD

Shpenzimet e prezantuara në kuadër të tabelës nr.26 janë shpenzimet e krijuara me rastin e implementimit të projektit me UNDP. Totali i donacioneve të realizuara për vitin 2023 ka qenë 17,128.00 euro, nga të cilat 2,400.00 janë bartje nga viti i 2022

			2023
Emri donatorit	Nr.i projektit	Emri i projektit	Euro
Council of Europe			4,000.00
IRZ			42,586.03
SAEK/UNDP			20,950.00
WBROLI			110,000.00
EUKOJUST			5,199.82
EULEX			56,068.67
GIZ			13,000.00
OSBE			13,332.00
USAID			32,552.00
Totali i Granteve në euro			293,688.52

Tabela nr. 27.: Donacionet e menaxhuara nga donatorët

Në tabelën 27 shpalosen donacionet e menaxhuara nga vet donatorët që do të thotë se këto mjete nuk kanë rrjedhë përmes llogarisë së Thesarit.

Sipas informatave të ofruar nga përfaqësuesit e projekteve me donator në këtë tabelë bëhet shpalosja e mbështetjes financiare nga donatorët vetëm në totalin e shpenzimeve ashtu siç janë pranuar, pa pasur mundësi të shpalosen në detaje.

Prezantimi dhe shpalosja e donacioneve në këtë rast tregon qartë se AD edhe në këtë vit ka realizuar aktivitetet trajnuese në mbështetje të donatorëve të ndryshëm. Edhe pse nuk janë të specifikuar dhe të detajuara, shpenzimet e mbuluara kanë qenë kryesisht shpenzimet për shërbimet e trajnimit, shpenzimet e botimeve dhe publikimeve, shpenzimet për vizita studimore, vlera totale e këtyre shpenzimeve është 293,668.52 euro.

9.10 Asetet

Akademia mban në mënyrë të rregullt regjistrat e pasurisë. Regjistrimi i aseteve/pasurisë jo financiare bëhet në sistemin E-pasuri dhe SIMFK-së, varësisht nga blerjet e aseteve brenda vitit.

9.10.1 Asetet e Akademisë

Në kuadër të regjistratit të aseteve përfshihen pasuritë mbi 1,000 euro dhe pasuritë nën 1,000 euro. Në kuadër të regjistratit të pasurive mbi 1,000 euro janë të regjistruara automjetet, fotokopjet, pajisjet e teknologjisë informative dhe pajisjet e zërimit në vlerën neto prej 62,411.70 euro.

Ndërsa, pasuritë nën vlerën 1,000 euro bëjnë me pasuritë që kanë jetëgjatësi më shumë se një vit dhe përfshijnë kryesisht pajisje të teknologjisë informative, mobilie dhe inventar të ndryshëm, librat e bibliotekës etj.

Pasuritë jo financiare të Akademisë janë të gjitha pasuritë jo kapitale të regjistruara në E-pasuri. Në vlerën totale të pajisjeve përfshihet vlera e pajisjeve që disponon Akademia me 31 dhjetor 2023, vlera neto e aseteve nën 1,000 euro është 45,756.03 euro.

9.10.2 Planifikimi për asete të reja dhe ndërtesën e Akademisë

Një ndër kërkesat më me rëndësi edhe për këtë vit iishte ndërtesa e Akademisë. Akademia që nga Dhjetori i vitit 2006 është e vendosur në një ndërtesë për të cilin është detyruar të paguaj qira, në mënyrë që të vazhdoj realizimin e funksioneve ligjore.

Hapësirat e ndërtesës së Akademisë, ku është tani janë rreth **2,000.00 m²**. Zbatimi i të gjitha programeve trajnuese, nevojat në rritje për trajnime të specializuara, nevojat për gjithë përfshirje në trajnime, trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve fillestar, trajnimi i profesionistëve tjerë të përcaktuar me ligj, krijimi i njësisë për hulumtime dhe bibliotekës, organizimi i konferencave dhe aktiviteteve tjera të ndryshme ka ndikuar që nevoja për hapësira të rritet.

9.11 Auditimi nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Gjatë vitit 2023 ka përfunduar auditimi nga ZKA për vitin 2022 dhe është publikuar raporti i auditimit. Raporti Final i Auditimit të pasqyrave financiare të AD-së për vitin 2022 ka rezultuar pozitiv dhe pasqyrat vjetore financiare në të gjitha aspektet kanë prezantuar një pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të dala nga ky raport është përgatitur dhe zbatuar plani për rekomandimin e dhënë në lidhje me çështjet e gjetura gjatë vitit 2022.

Rekomandimet dhe plani i zbatimit për implementim të rekomandimeve

Nr	Gjetja	Veprimi i ndërmarrë	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit	Vlerësimi i rrezikut
1	Çështja A1 - Prezantim jo i drejtë i pasurive nën 1,000 € në PFV	Komunikimet e me MPB për çështjen e zhvlerësimit të pasurive.	Qershor - Dhjetor 2023		
2	Çështja A2 - Funkionimi i pozitivave të larta udhëheqëse me ushtrues detyre	Gjatë kësaj periudhe është punuar në rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës për AD-në, dhe në fund të vitit është miratuar rregullorja.	Qershor - Dhjetor 2023		

Tabela nr. 28: Plan i zbatimit të rekomandimeve

10. Sfidat dhe rekomandimet

Gjatë vitit 2023, Akademia e Drejtësisë është përballë me sfida të shumta si në vijim:

1. Koncepti i dokumentit për Ligjin për Akademinë e Drejtësisë dhe zhvillimet sa i përket këtij ligji
2. Buxheti jo i mjaftueshëm sipas planifikimeve të përcaktuara për realizimin e të gjitha aktiviteteve në programet e trajnimit, me shume se 60% e aktiviteteve trajnuese në PTV financohen nga donatorët
3. Staf i jo i mjaftueshëm në raport me kërkesat për programe trajnuese dhe aktivitete tjera sipas ligjit dhe strategjive;
4. Zbatimi i efektit trajnimeve në punë;
5. Hapsira e pamjaftueshme e objektit për të përmbushur aktivitetet trajnuese sipas programit
6. Mungesa e trajnuesve të profilizuar;
7. Hartimi i Doracakut për trajnues;
8. Pjesëmarrja e ulte në trajnime veçanërisht të atyre që hyjnë jashtë programit vjetor trajnues si rezultat i projekteve me partnerë ndërkombëtarë
9. Zbatimi i trajnimeve fillestare në periudha të caktuara paralelisht me nga dy gjenerata dhe dy profile jëkohësisht

Për tejkalimin e sfidave të lartpërmendura, Akademia e Drejtësisë jep këto rekomandime:

1. Ligji i ri për AD të sigurojë pavarësinë institucionale dhe të adresojë mangësitë dhe pengesat ligjore që i ka ligji aktual në fuqi;

2. Rritja e buxhetit sipas nevojave dhe kërkesës buxhetore të AD-së dorëzuar në Ministrinë e Financave;
3. Rritja e numrit të punësuarve dhe plotësimi i pozitave të lira;
4. Zbatimi i sistemit të monitorimit të trajnimeve dhe efektit të tyre në punë;
5. Vënia në funksion e ndërtesës së re të AD-së e cila më pastaj ka impakt në buxhetin e AD-së.
6. Zbatimi i certifikimit të trajnuesve dhe trajnimi i trajnuesve
7. Zbatimi i doracakut për trajnues
8. Bashkëpunimi me kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorë të prokurorive
9. Planifikimi i përbashkët me KGJK dhe KPK me rastin e rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj;

11. Tabela me indikatorët dhe performancën e AD-së për vitin 2023

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
1. Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar të gjeneratës së IX si dhe Hartimi dhe zbatimi i programeve për gjyqtarët dhe prokurorët e gjeneratës së X	Zbatimi i trajnimit fillestar për 48 gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së IX (trajnimi teorik në AD dhe trajnimi praktik në gjykata nën mbikëqyrjen e mentorit gjyqtarë).	Organizimi i trajnimeve dhe monitorimi i përmbushjes së trajnimit praktik	Nga 48 gjyqtarë të kësaj gjenerate, janë trajnuar 45 meqë 3 prej tyre nga komuniteti serb janë dorëhequr si rezultat i zhvillimeve në veri. Është është realizuar testi përfundimtar dhe në fund është hartuar Raporti përfundimtar për 45 gjyqtarët e kësaj gjenerate cilët kanë përmbushë gjatë këtij viti edhe trajnimin praktik. Raporti i është dërguar KGJK, përkatësisht Komisionit për vlerësimin e performancës
	Zbatimi i trajnimit fillestar për 6 prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së IX (trajnimi teorik në Akademi të Drejtësisë dhe trajnimi praktik në prokuroritë përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit prokurorë)	Organizimi i trajnimeve dhe monitorimi i përmbushjes së trajnimit teorik dhe praktik	Nga 6 prokurorë të kësaj gjenerate janë trajnuar 4 prokurorë meqë dy nga prokurorët kanë ndërprerë trajnimin për shkak të pushimit të lehonisë. Është është realizuar testi përfundimtar për prokuror Raporti përfundimtar për këtë gjenerate të cilët kanë përmbushë gjatë këtij viti paralel trajnimin teorik dhe praktik. Raporti i është dërguar KPK-së përkatësisht Komisionit për vlerësimin e performancës
	Zhvillimi dhe zbatimi i programeve trajnuese për gjeneratën e X të gjyqtarëve prokurorëve rinj, gjegjësisht 37 gjyqtarëve dhe 22 prokurorëve të rinjë	Organizimi i trajnimeve dhe monitorimi i përmbushjes së trajnimit teorik dhe praktik	Trajnimi ka filluar së zbatuari nga muaji prill për dy profilet. Numri i gjyqtarëve në trajnim ishte 29 ndërkaq për prokurorë 22. Për gjyqtarët janë realizuar 116 ditë trajnimi teorik apo 232 sesione apo 696 orë dhe 41 ditë trajnim praktik në gjykata, duke përfshirë edhe 8 vizita në institucione jo gjyqësore. Për prokurorët në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar 63 ditë trajnimi apo 126 sesione apo 378 orë trajnimi dhe 92 ditë trajnim praktik në prokurorit përkatëse ku janë emëruar.
2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesionistëve tjerë ligjor	Zhvillimi dhe zbatimi trajnimeve dhe aktiviteteve tjera që janë rezultat i kërkesave nga dokumentet strategjike	Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve tjera në përmbushje të masave	Nga Strategjia për sundimin e Ligjit janë realizuar 138 aktivitete trajnuese, pasurim i burimeve online, 3 memorandume bashkëpunimi. Si rezultat i Strategjisë për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave janë realizuar rreth 30 aktivitete trajnuese duke përfshirë aspektin penal dhe aspektin civil të dhunës në familje. Nga Programi Kombëtar për të Drejtat e Njeriut e me theks të veçantë për praktikën dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë realizuar 9 aktivitete trajnuese. Si rezultat i PKZMSA-së dhe Agjendes Evropiane janë realizuar 9 aktivitete trajnuese në fushën e hetimit financiar dhe pastrimit të parave dhe 8 tjera për konfiskimin dhe sekuatrimin në kuadër të risive të KPPK-së
	Zbatimi i trajnimeve nga lëmia penale	Organizimi i trajnimeve për luftimin e krimeve të luftës, formave të korrupsionit dhe krimin	64 aktivitete trajnuese nga lëmia penale materiale dhe procedurale me 1364 pjesëmarrës.

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
		të organizuar, krimin kibernetik si dhe dhunës në familje sipas metodave dhe standardeve më bashkëkohore	
	Trajnime nga Programet e Specializuara në fushën Penale	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve profesionale sipas fushave	9 aktivitete trajnuese me 351 pjesëmarrës nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve, bashkëpunëtorëve profesional, zyrtarëve ligjor, zyrtarëve policor, njësisë së intelgjencës financiare, ekspert të PRSK-së, shërbimit korrektues dhe profesionistë tjerë ligjor
	Trajnimet nga lëmia civile	Organizimi dhe realizimi i tryezave	15 aktivitete trajnuese të realizuara me 519 pjesëmarrës.
	Trajnimet nga lëmia e Drejtësisë për fëmijë	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve nga drejtësia për fëmijë aspekti penal dhe civil	17 aktivitete trajnuese me gjithsej 313 pjesëmarrës
	Trajnimet nga lëmia komerciale	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	9 aktivitete trajnuese me gjithsej 106 pjesëmarrës.
	Trajnimet nga drejtësia kushtetuese, administrative kundërvajtëse	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	2 aktivitete trajnuese nga drejtësia kushtetuese, 7 nga lëmia administrative, 4 në kundërvajtje me 161 pjesëmarrës
	Trajnimet për KEDNJ	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	9 aktivitete trajnuese me 182 pjesëmarrës.
	Trajnimet nga e Drejta e BE-së dhe e drejta ndërkombëtare	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	2 aktivitete trajnuese me 27 pjesëmarrës
	Trajnimet nga kompetenca interdisciplinare	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	5 aktivitete trajnuese me 82 pjesëmarrës
	Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme sipas kërkesave nga KGJK dhe KPK	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	6 trajnime për risite e KPPK-së me 166 pjesëmarrës. 1 trajnim për etikën për prokurorë si dhe 1 prokurorë i trajnuar në trajnimin e detyrueshëm si rezultat i vlerësimit të performances. Trajnimi është realizuar në pajtim me protokolin me KPK për trajnime të detyrueshme dhe sipas kërkesës në 5 module trajnuese.
	Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorëve	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	Nga 55 trajnime të realizuara me 1169 pjesëmarrës, të trajnuar 279

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
	Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	Nga 6 trajnime të realizuara me 124 pjesëmarrës, të trajnuar 122
	Ofrimi dhe zbatimi i trajnimeve sipas kërkesave të institucioneve të profesioneve të lira	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	Nga 4 trajnime të realizuara për ndërmjetësimin janë trajnuar 11 ndërmjetësues Nga 4 trajnime të realizuara për avokatë për dhunnë në Familje dhe dhunën ndaj grave janë trajnuar 27 avokatë
	Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë	Organizimi dhe realizimi i trajnimeve	1 aktivitet në platformën Help dhe 2 sesione trajnuese në platformën MOODLE (kombinim online dhe fizikisht)
Rritja e kapaciteteve analitike dhe hulumtuese si dhe veprimtarisë botuese	Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese për vitin 2024	Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga mekanizmat e zhvilluar	Është hartuar Raporti me analizën dhe vlerësimin e nevojave trajnuese për vitin 2024 i cili i ka paraprirë hartimit të programit trajnues për vitin 2024
	Hulumtimi i praktikës gjyqësore	Identifikimi i praktikës gjyqësore jo unike në çështje penale dhe civile	2 hulumtime të praktikës gjyqësore në çështje penale dhe civile
	Zhvillimi i veprimtarisë botuese	Organizimi dhe mbikqyrja e procesit të hartimit dhe përmbledhja e materialeve ligjore	2 përmbledhje të praktikës gjyqësore të hartuara dhe të publikuara Konkluzionet e tryezës në çështje civile dhe penale të hartuara dhe të publikuara Buletini informativ i hartuar dhe i publikuar në baza periodike
	Planifikimin institucional në zbatim të masave dhe politikave euro integruese	Hartimi i raporteve në baza periodike për zbatimin e masave të përcaktuara në Strategjinë për sundimin e Ligjit, Strategjinë për mbrojtjen nga Dhuna në Familje, CEPEJ dhe mekanizmat tjerë euro integrues	Raportet e hartuara dhe dërguar brenda afateve të përcaktuara nga autoritetet përkatëse.
Avancimi i mëtejshëm i metodologjisë trajnuese	Zhvillimi i Programit të përhershëm për trajnues dhe mentorë		.Ky indikator është në proces të realizimit me projektin OPDAT. Është realizuar një aktivitet për certifikimin e trajnuesve dhe do të vazhdojë edhe në vijim me trajnuesit e tjerë sipas listës. Gjatë vitit 2023 janë certifikuar 24 gjyqtarë dhe prokurorë të cilët përfunduan me sukses Trajnimin e Trajnuesve sipas metodologjisë trajnuese të AD-së.
	Zbatimi i trajnimit për trajnues		Nga 7 trajnime të realizuara për TIT nga 97 pjesëmarrës të trajnuar janë 25 gjyqtarë, 17 prokurorë, 10 avokatë, 13 ndërmjetësues, 1përmbarues privat, 3 Këshilltar Juridik nga GJK, 1 zyrtar nga KRTC, 1 zyrtare e lartë për mundësi të barabarta nga Qeveria e Kosovës si dhe 1 trajnues I përhershëm nga AD

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
Ngritja e transparencës dhe marrëdhënia	Ofrimi i qasjes për palët e interesit		Rreth 40 postime në linkedin, 120 në facebook si dhe në njoftimet dhe raportet në web sipas aktiviteteve të planifikuara qoftë në Programin trajnues ashtu edhe në aktivitete tjera në funksion të procesit të punës në AD
Rishikimi i akteve nënligjore dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve administrative dhe financa	Zhvillimi dhe amandamenti i akteve të brendshme	Hartimi i akteve nënligjore	6Aktet nënligjore të hartuara dhe të miratuara
	Zhvillimin, menaxhimin dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore	Zbatimi i procesit të rekrutimit për pozitat e lira ndjekja e trajnimeve të ndryshme për zhvillim profesional të stafit të AD-së	Nuk është realizuar për shkak se është dashur fillimisht organizmi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës në Akademinë Drejtësisë. AD gjatë këtij viti ka plotësuar dhe ndryshuar 5 rregullore dhe në koordinim dhe bashkëpunim me MPB ka zhvilluar dhe nxjerrë Rregulloren e re për Organizmin dhe Sistematizimin e Vendeve të punës. Ka themeluar Komisionin për klasifikimin e vendeve të punës, dhe në fundvit ka themeluar Komisionin për sistematizim ku me sukses ka përfunduar të gjitha këto procese. Miratimi i Rregullores së re për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në AD, në vitin vijues do të hapë rrugën për zhvillimin e procesit të rekrutimit për të gjitha pozitat e lejuara dhe sipas buxhetit të lejuar edhe të 4 pozitave tjera si të paraparë ne Rregulloren për Organizim të Brendshëm.
	Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit	Përgatitja e kërkesave buxhetore për vitin 2024-2026 për të gjitha aktivitetet e përfshira në buxhetim.	KASH 2024-2026 është hartuar sipas nevojave të AD dhe është dërguar në MFTP, ndërsa buxheti për vitin 2023 shtë realizuar rreth 83.60 %.
	Planifikimin e prokurimit dhe realizimi i suksesshëm me AQP	Hartimi i kërkesave, përcaktimi i fondeve ne dispozicion dhe specifikacione teknike të dërguara në AQP për zhvillimin e procedurave të prokurimit Përcaktimi i menaxhereve dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë për menaxhimin e kontratave	Nga tri vetura të planifikuara është blerë vetëm një për shkak të ankesave në OSHP Është realizuar blerja e llap topëve dhe UPS Nuk është realizuar blerja e e pajisjeve të përkthimit dhe të transkriptimit për shkak se kontraktuesi nuk ka mundur ta realizoj kontratën sipas kërkesës së AD-se Është bërë zhvillimi i data bazës sipas kontratës Janë realizuar të gjitha furnizimet dhe shërbimet tjera si Blerja e karrigeve për sallat e trajnimeve, furnizimet me material zyrtar shpenzues, furnizimet me naftë, shfrytëzimi i veturave me qira, furnizim me ushqim të gatshëm dhe pije për pjesëmarrësit ne Akademi, furnizim me materiale të shtypura dhe dizajn-botime

Objektivi i përgjithshëm	Nën objektivi	Veprimi	Indikatori/Rezultati
		Hartimi i planit për menaxhimin e kontratave dhe menaxhimi i kontratave	dhe publikime si dhe furnizimet dhe shërbimet tjera janë pranuar gjate tërë viti...
